

Maj 2020  
Numri: 146  
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - [www.revistaetika.com](http://www.revistaetika.com)

# ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë  
Kosovë: 1.5 Euro  
Maqedoni: 90 Den  
Evropë: 7 Euro

## SEKRETI i LUTJES




revistaetika



progresibotime

E çfarë mund të jetë tjetër  
qëndrimi indiferent,  
pandjenja dhe injorant përballë  
mrekullive të pafundme  
madhështore, që prej  
grimcës më të vogël, e deri tek  
trupi më i madh, prej botës  
mikro, e deri në atë makro,  
të cilat ndriçojnë më së miri  
mendjen dhe zemrën,  
përveçse një çoroditje  
dhe falimentim i mendjes!?



Profeti (a.s.), thotë:

“Ditën e Kiametit asnjë rob  
nuk do të bëjë qoftë edhe një hap  
pa u pyetur se ku e ka kaluar jetën  
e tij, se çfarë ka bërë me dijen e  
tij, se ku e ka (tuar dhe shpenzuar  
pasurinë e tij dhe se ku e ka  
konsumuar trupin e tij.” (Tirmidhi,

Kiamet, 1/2417)

“Allahu i Madhëruar e do të riun e  
pjekur, që nuk sillet si fëmijë, që  
është drejtuar kah e mira dhe ka  
braktisur dëshirat e kënaqësitë (e  
ulëta të egos).” (Ahmed, IV, 151.)



Të gjitha fetë hyjnore janë organizuar rreth “njohjes së Allahut”.

Edhe njeriu edhe fetë kanë ardhur prej Tij.

Edhe njeriu edhe fetë ekzistojnë falë Tij.

Në jetë vijmë pa vullnetin tonë dhe udhëtimin e fillojmë në mënyrë të detyruar. Askush nuk na pyet: “A dëshiron të vish në jetë, ta vazhdosh jetën apo të zvarritesh në jetë.” Vetën e kemi gjetur të mbështjellë nëpër djepa. Ja, që nga kjo pikë, fillon udhëtimi ynë drejt pafundësisë. Këtij udhëtimi i themi jetë. Sikur të vinim në këtë botë me vullnetin tonë, duhej ta pyesnim njëri-tjetrin për qëllimin e kësaj ardhjeje. Duke qenë se nuk bëhet fjalë për diçka të tillë, atëherë jemi të detyruar të pyesim Fuqinë e Lartë krijuese: “Cili është qëllimi për të cilin jemi dërguar në këtë botë?”

...

Për besimtarët, mbështetja tek Allahu është shumë e rëndësishme. Rruzulli tokësor, sot po ekspozon fotografitë e lotëve të nevojës. Në ditët e sotme, kjo nevojë është e pandotur dhe e dëlirë, sepse nuk ka mbetur asgjë tjetër veç saj. Ndaj, të bësh atë që kërkon Krijuesi për krijesat. Kërkesa e Allahut që robërit e Tij të përmbushin këtë dëshirë të shenjtë, është që ata të drejtohen për mbështetje tek Ai. Edhe sikur të jetonim në pasuri dhe bollëk, sikur të mos ishim emigrantë, edhe sikur të mos kishim humbur shtëpitë, familjet, plaçkat tona, do i drejtoheshim Samedit Një (Allahut). Le të mendojmë sikur të ishim vërtet ashtu, jetimë, të papërkrahur, emigrantë! Le të kuptojmë nevojën që kemi për Të dhe t'i japim formë jetës sipas saj! Nëse do të bëjmë kështu, gjithçka do të zgjidhet dhe do të arrijmë prehjen shpirtërore që të jep ajeti: **“Ata janë të kënaqur me Të dhe Ai është i kënaqur me ta.”** Le t'i lutemi Zotit të na shtojë nevojën për Të dhe të jetojmë të lidhur me Të!

...

Fitimi te i Pasuri është gjithnjë i sigurt dhe larg Tij, humbja po ashtu është e sigurt. Larg Tij jemi në duart e Egos që luan me ne si me një kukull, na çon drejt dëshirave egoiste duke na konsumuar e lodhur, ndërsa kush afrohet te Zoti, ndjen sërish jetën që i vlon, zemra e tij është e gjallë, gjithçka merr kuptim dhe ai fillon t'ua njohë haqet gjërave dhe kupton se duhet të jetë mirënjohës ndaj Atij që e ka krijuar dhe i vjen turp, sepse një ditë do të dalë para Tij, prandaj me lot në sy kërkon falje ditën e natën.

Allahu na kujton: **«Thuaj: “Kush ju ushqen nga qielli dhe Toka? Kush mundëson të dëgjuarit dhe të parit? Kush mund të nxjerrë të gjallën nga e vdekura dhe të vdekurën nga e gjalla? Kush i drejton gjërat?” Ata do të thonë “Allahu”. E ti (o Muhamed) thuaj: “Atëherë, përse nuk e keni frikë Atë?” Ky është Allahu, Zoti juaj i vërtetë. E çfarë ka pas së vërtetës, përveç humbjes? Atëherë, përse largoheni?»** (Junus, 31)

“Shkatërrimi i çdo populli vjen prej një të keqeje. Ndërsa shkak i shkatërrimit të popullit tim do të jetë pasuria e dynjasë.” (Muslim)

“Ari dhe argjendi shkatërroi popullin që ishte para jush. Nëse nuk ruheni nga koprancia, ambicia dhe mburrja, do të jetë edhe shkak i shkatërrimit tuaj.” (Muslim)

“Të parët e këtij umeti gjetën devotshmërinë, dijen, besimin dhe shpëtimin. Kurse të pasmit e umetit tim do të shkatërrohen prej koprancisë dhe dëshirave të pafundme.” (Ramuz)

**Maj 2020**

VITI: XIV

NUMRI: 146

**BOTUESI**

Shtëpia botuese "Progresi"

**DREJTOR**

Albert Halili

**KRYEREDAKTOR**

Alban Kali

**REDAKTOR**

Zija Vukaj

**PËRKTHYES**

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

**DIZAJN**

Bledar Xama

**ADRESA**

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

**MOBILE**

+355 67 340 6182

**E-MAIL**

rev.etika@gmail.com

**WEBSITE**

www.progresibotime.com

**KOSOVË**

Rr: Ardi Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

**MAQEDONI**

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7145 6003

**ABONIMI VJETOR**

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

# Përmbajtja



10

Vetëdija ndaj mirësive  
Ali Riza Temel



Ndjeshmëria ndaj shpërdorimit  
ose etika e konsumit  
Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

14




20

34

Një Ramazan sa për të gjithë jetën  
Osman Nuri Topbash



- 5 Pa e njohur Allahun  
Ahmet Tashgetiren
- 8 Lartësimi i jetës gradë-gradë  
Idris Arpat
- 13 Të blesh lumturinë  
A. Jasin Demirxhi
- 20 Bëhu Kuran i gjallë  
Doç. dr. Kerim Bulladë
- 23 Sekretet e lutjes  
Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz
- 26 Infaku në Ramazan  
Shesedin Kërësh
- 28 Fjala dhe dëgjimi  
Merva Capo
- 30 Një Ajet
- 32 Një Hadith



40

- Fshehtësia e Itikafit 40  
Rabia Christine Brodbeck
- Ramazani nga gjuha e Profetit (a.s.) 42  
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan
- Shehadet do të thotë Aksion 48  
Zubejir Jetik
- Modeli më i bukur njerëzor 50  
Ahmet Zijlan
- Kërko zotëruesin e Xhenetit 53  
M. Sami Ramazanollu

44



Veprat që të shpien  
në xhenet  
Dr. Murat Kaja

Porositë e Profetit (a.s.)  
Ferit Piku

54





# Pa e njohur Allahun

— Ahmet Tashgetiren —

Të gjitha fetë hyjnore janë organizuar rreth **“njohjes së Allahut”**.

Edhe njeriu edhe fetë kanë ardhur prej Tij.

Edhe njeriu edhe fetë ekzistojnë falë Tij.

Fetë përcaktojnë ligjet dhe kufijtë e njeriut mbi tokë. Kurse Ai që i ka shkruar këto ligje dhe ka vendosur këta kufij, është Krijuesi i njeriut.

Pa njohur Krijuesin, pa e kuptuar Atë në mënyrën më të mirë dhe pa u lidhur me Të, njeriu nuk mund të kuptojë as veten e tij dhe as **“përgjegjësitë e tij ndaj fesë”**.

Gjithësia qarkullon në sajë të marrëdhënieve ndër-

vepruese *Rububije*<sup>1</sup> – *Ubudije*<sup>2</sup>. Kjo është marrëdhënia midis Zotit dhe njeriut. Ekziston Ai dhe krijesat e Tij. Krijesat do të organizohen sipas vullnetit të Krijuesit. Ndërmjet të gjitha krijesave, vetëm njeriu i është dhënë e drejta për të zgjedhur. Për këtë arsye, fjala e Allahut i është drejtuar atij. Gjithashtu, edhe ligjet, edhe kufijtë hyjnorë janë dizajnuar në atë mënyrë, që njeriu të jetë i lirë të bëjë zgjedhjen që dëshiron, pra të qëndrojë brenda apo të dalë jashtë tyre.

1. Plotësimi i çdo nevoje të krijesave nga ana e Krijuesit

2. Bindje, devotshmëri e krijesës ndaj Krijuesit

Për ta vendosur në një bazament të sigurt marrëdhënien Rububijet-Ubudijet dhe për t'i dhënë asaj (marrëdhënies) formën e duhur, kërkohet që "Njohja e Allahut" të konsiderohet si një proces i domosdoshëm.

Profetët janë ngarkuar me detyrën e njoftimit të njerëzve me Krijuesin e tyre dhe përgjegjësitë e tyre ndaj Tij.

Librat hyjnorë janë fjala e Allahut dhe Ai personalisht me anë të fjalës së Vet ua ka prezantuar Vetën njerëzve.

Megjithëse në Kuran gjenden kriteret e jetës së njeriut mbi tokë, kjo fjalë hyjnore rrotullohet rreth boshtit të njoftimit të njeriut me Zotin e tij.

Surja "el-Ihlas" fillon me urdhrin "**Kul-Thuaj!**" dhe vazhdon me ajetet që njoftojnë në lidhje me Allahun:

**"Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amëshim. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!"**

Kjo sure është vlerësuar prej Rasulallahut (a.s.), si "**Zemra e Kuranit**". Kjo do të thotë se ai që e kupton plotësisht dhe ashtu siç duhet "**Rububijetin**" në suren el-Ihlas, në një farë kuptimi ka arritur në zemrën e Kuranit, pra ka arritur thelbin e mesazhit të fundit hyjnor.

Edhe ajetu'l-Kursi, është një prej ajeteve më të preferuara të Profetit tonë (a.s.). Gjithashtu edhe ky ajet fillon duke vënë në plan të parë teuhidin "**Allahu la il-laheil-la huue. .**" dhe më pas vazhdon duke

radhitur cilësitë e Allahut Teala. "**Allahu! Nuk ka zot tjetër përveç Tij, të Gjallit, të Përjetshmit. Mbajtësit të gjithçkaje! .**"

Këto janë ajete në të cilat Zoti ynë prezanton Vetën e Tij. Kjo do të thotë se Allahu Teala dëshiron kështu ta njohin robërit e Tij. Gdhendja e kësaj njohurie në mendjen e njeriut, është një kërkesë hyjnore. Nëse njeriu do ta arrinte këtë njohuri, ai do të kuptonte në mënyrë të plotë edhe Ubudijetin e tij. Ose e kundërta e kësaj, pra, nëse njeriu nuk do ta njihte ashtu siç duhet Zotin e tij, nuk do të mund të kuptonte dhe përjetonte ashtu siç duhet as bindjen dhe robërinë ndaj Tij.

Pa i kuptuar mirë shprehjet: "**Hajju / i Gjallë, ekziston gjithmonë, i Pafillim dhe i Pafund**" dhe "**Kajjum / Zotëruesi, Dominuesi dhe Drejtuesi i gjithçkaje**", pa e ditur se çfarë përfshijnë ato dhe pa bërë përpjekje të veçantë për t'i kuptuar, nuk është e mundur ta njohim Zotin tonë.

Në vazhdim të Ajetu'l-Kursi, njeriut i tregohen disa cilësi të tjera të Allahut:

**"...Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi! Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë. Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij? Ai di çdo gjë që ka ndodhur përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë pas njerëzve, kurse ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga Dituria e Tij, përveçse aq sa Ai dëshiron. Kursi-u i Tij shtrihet mbi qiejt dhe Tokën dhe Ai nuk e ka të rëndë t'i ruajë ato. Ai është i Larti, Madhështori!"** (el-Bekare, 255)

Janë edhe tre ajetet e fundit të sures el-Hashr, të cilat na njoftojnë për cilësitë e Allahut Teala:

**"Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër. Njohësi i së dukshmes dhe i së padukshmes, Ai është i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti!"**

**"Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër. Ai është Sunduesi, i Shenjti (i pastër nga çdo e metë), Paqedhënësi, Dhënësi i sigurisë, Mbi-këqyrësi mbi gjithçka, i Plotfuqishmi, Imponuesi, Madhështori. Qoftë i lartësuar Allahu mbi gjithçka që ia shoqërojnë Atij (në adhurim)!"**

**"Ai është Allahu, Krijuesi, Zanafillësi, Ai që i jep trajtë çdo gjëje. Atij i përkasin emrat më të bukur; Atë e përlëvdon gjithçka që ndodhet në qiej dhe në Tokë, Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urri."** (el-Hashr, 22-24)

Të gjitha cilësitë që zënë vend në këto ajete dhe që nga Vetë Allahu Teala janë cilësuar si "**esma-i husna / emrat më të bukur**", janë përmendur me qëllim që



njerëzit ta njohin sa më mirë Krijuesin e tyre.

Kjo do të thotë se Zoti ynë i Madhërishëm, dëshiron që ne të dimë se Ai është **“Një i Vetëm”**, **“Melik/ Sunduesi i vërtetë i gjithësisë”**, **“Kuddus / i Pastri, i Shenjti, larg prej çdo të mete”**, **“Selam / Paqedhënesi”**, **“Mu’min / Siguruesi, Mbajtësi i premtimit”** dhe **“Muhejmin / Mbrojtësi, Mbikëqyrësi”**.

Kjo do të thotë se Zoti mund të jetë vetëm një dhe vetëm kështu. E nëse pranoni me gjithë shpirt se Zoti mund të jetë vetëm kështu, nuk do t’u drejtoheni më zotave të rremë.

Sigurisht që ajetet me anë të të cilave Allahu na prezantohet, nuk janë të kufizuara me kaq. I gjithë Kurani, qoftë direkt, qoftë indirekt, e thërret njeriun në përpjekjen për të njohur Zotin e tij.

Në suren Fatiha, njeriu takohet me cilësitë Rrahman, Rrahim, Sunduesi i ditës së gjykimit dhe prej aty, dërgohet në **“besimin – dijen se Falënderimi duhet të bëhet vetëm ndaj Allahut, se vetëm Ai duhet të adhurohet, se vetëm prej Tij duhet kërkuar ndihmë dhe se shpëtimi prej devijimit, arritja e mirësive të Allahut, orientimi në rrugën e drejtë dhe qëndrimi në atë rrugë, mund të arrihen vetëm duke iu lutur Atij”**. Njeriu që i gjen këto, fjalën e tij do ta fillojë **“duke falënderuar Zotin e tij”**. Çështja është të kuptojmë Allahun Teala, i cili na e prezanton Vetën e Tij me cilësitë Rrahman, Rrahim dhe Sunduesi i ditës së gjykimit. Ai sikur dëshiron të na thotë: *“Njihe Allahun si Rrahman dhe Rrahim, sepse këto janë mirësitë që i janë dhuruar njeriut. Por ka edhe një ditë gjykimi, Sunduesi i së cilës është Allahu. Prandaj, mos harro se në ditën e gjykimit do të dalësh përpara Allahut.”*

Shumë ajete të Kuranit tregojnë për gjendjet e ndryshme të njeriut dhe popujve, duke filluar me **“Innallahe... / Me të vërtetë Allahut”** dhe mbarojnë më fjali që tregojnë gjykim të prerë, si **“Alimunhakim”** ose **“Azizundhu’ntikam”**.

Allahu Teala është Rrahman dhe Rrahim, por nëse njeriu është përzier në padrejtësi, ka shkelur të drejtat e dikujt, nëse fuqinë të cilën i ka dhënë Allahu e ka përdorur për të shkelur kufijtë e Allahut dhe, nëse e ka tepruar, duhet të dijë se ka edhe një Krijues, i cili do ta dënojë për ato që ka bërë.

Cilësia e Allahut, e cila i njoftohet njeriut në raste të tilla, është me qëllim që njeriu të orientohet në vijën e drejtë të devotshmërisë. E shprehur ndryshe, mund të quhet edhe si paralajmërim: **“Mos e harro Zotin tënd”**.

**“Ai është me ju kudo që të gjendeni!”** (Hadid, 4)

**“Ai është më pranë tij se damari i qafës së vet.”** (Kaf, 16)

Edhe këto janë informacione të Kuranit, të cilat na njohin me Zotin tonë.

Në disa ajete zënë vend shprehjet: **“Allahu Teala i do ata që veprojnë kështu...”**. **“Allahu i do ata që pendohen, ata që bëjnë mirësi, ata që jetojnë sikur ta shihnin Allahun, ata që janë të pastër brenda dhe jashtë...”**

Është e qartë se Allahu Teala dëshiron që njeriu dhe shoqëritë njerëzore të arrijnë pjekurinë, në sajë të së cilës do të fitojnë dashurinë e Allahut. Këta janë kufijtë që vendos Ai përpara njeriut... (Shih. Maide, 54)

Përkundër kësaj, ekziston edhe mospëlqimi i Allahut... Madje edhe urrejtja... Madje edhe mallkimi...

Atëherë, njeriut i duhet të bëjë një kujdes të veçantë, për të mos shkaktuar urrejtjen dhe mallkimin e Allahut...

Kur shohim nga kjo pikëpamje, mund të themi se **“Marifetullah / Njohja e Allahut”**, është një disiplinë shpirtërore, e cila nuk është vetëm për sufitë. Përkundrazi, besimi arrin përsosmërinë vetëm duke e njohur me të vërtetë Allahun. Nga kjo pikëpamje, marifetullah, është shprehja e vërtetë e besimit.

Kur duam të përkufizojmë fenë, themi: **“Ta’dhim li emrillahue’sh-shefaktu li halkillah / Të kuptosh Madhështinë e Allahut dhe të mëshirosh gjithçka që ka krijuar Allahu”**. Dhe kjo mund të arrihet vetëm nëse e njohim mirë Madhështinë e Allahut, nëse e dimë se njeriu dhe gjithësia doli në skenën e ekzistencës me urdhrin e Tij **“Kun!”** dhe se për këtë arsye, është e pakuptimtë të mburremi para krijesave të tjera.

Prandaj, nuk është gabim nëse themi: **“Feja është e barabartë me marifetullah / njohjen e Allahut”**.

**“Ai është Allahu, Krijuesi, Zanafillësi, Ai që i jep trajtë çdo gjëje. Atij i përkasin emrat më të bukur; Atë e përlëvdon gjithçka që ndodhet në qiej dhe në Tokë, Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti.”**

(Hashr, 22-24)

# Lartësimi i Jetës gradë - gradë

— Idris Arpat —

Jeta është një udhëtim pa kthim dhe një ujë që rrjedh. Ajo është një hark i hapur ndërmjet kon-dakut dhe qefinit, ndërmjet djepit dhe varrit.

Në jetë vijmë pa vullnetin tonë dhe udhëtimin e fillojmë në mënyrë të detyruar. Askush nuk na pyet: “A dëshiron të vish në jetë, ta vazhdosësh jetën apo të zvarritesh në jetë?” Veten e kemi gjetur të mbështjellë në djepa. Ja, që nga kjo pikë, fillon udhëtimi ynë drejt pafundësisë. Këtij udhëtimi i themi jetë.

Sikur të vinim në këtë botë me vullnetin tonë, do duhej ta pyesnim njëri-tjetrin për qëllimin e kësaj ardhjeje. Duke qenë se nuk bëhet fjalë për diçka të tillë, atëherë jemi të detyruar të pyesim Fuqinë e Lartë krijuese: “Cili është qëllimi për të cilin jemi dërguar në këtë botë?”

Përgjigjja është kjo: “Li ja’budun, që të më adhuroni Mua.”

Në këtë çështje përfshihen edhe aspektet e njohjes, gjetjes dhe admirimit.

Nga kam ardhur? Ku po shkoj? Cila është detyra ime kryesore në këtë botë? Cilat janë rregullat me të cilat jetohet në këtë mysafirhane? Çfarë është kjo botë? Çfarë është ajo që vjen pas saj? Çfarë lidhjeje kanë me njëra-tjetrën? Çfarë pozite kam kundrejt Allahut të Madhëruar, njerëzve, vetes sime dhe natyrës?

Këto janë pyetje me rëndësi jetike. Ne e kemi të pamundur të jemi të qetë dhe të lumtur pa u gjetur përgjigje të saktë këtyre pyetjeve dhe pa u përpjekur

për të jetuar sipas këtyre përgjigjeve. Ata që thonë se është e mundur, do të shohin se llogaria e gabuar nuk përputhet me natyrshmërinë e tyre.

E vetmja përgjigje e drejtë që mund të thotë mendja e pavarur nga shpallja hyjnore, kundrejt këtyre pyetjeve bazë dhe shumë serioze, është “nuk e di”. Dihet se mendja shpjegon “si-të” dhe jo “përse-të”.

Kurani Fisnik dhe Suneti i lartë profetik janë burimi i vetëm me të cilin mund ta konceptojmë drejt kuptimin e jetës. Mendja mund të japë shpjegime të rëndësishme vetëm nën dritën e shpalljes hyjnore, sepse “mendja është sy, ndërsa shpallja është dritë”. Çfarë të bëjë syri pa diellin?! Destinacioni ku arrin njeriu që i kthen shpinën shpalljes, është hutimi, depresioni dhe agresiviteti. Njeriu i një bote që e ka shkëputur lidhjen me botën tjetër, vetëvritet ose revoltohet. Nuk ka sukses të rastësishëm. Nuk ka lumturi të befasishme. “Lumturia e jetës” mund të arrihet duke mësuar, kërkuar, duke ndjekur natyrshmërinë njerëzore dhe duke ua vënë veshin gjërave të përhershme.

Mirëpo, çfarë është natyrshmëria? Kush e njeh këtë enigmë që quhet njeri? Mjeshtrit e kësaj pune thonë: “Ne nuk mund ta shpjegojmë njeriun. Pyetni Allahun për të.”

Ja, jemi ballë për ballë me një çështje të madhe. Nuk mund të kuptojmë as natyrshmërinë njerëzore dhe as Kurandin Fisnik. Duke heshtur kundrejt pyetjeve të jetës dhe duke e bërë hatme Kurandin Fisnik, i cili ka zbritur “li kaumin jakilun / për një popull



që mendon”, dy miliardë myslimanë në këtë botë, po bëhen rutinë. Puna jonë nuk është punë dhe përparimi ynë nuk është përparim.

A thoni: “Na mjafton aq sa kuptojmë?” Edhe të tjerët para nesh kanë thënë kështu, miku im i dashur. Nëse nuk u gjejmë përgjigje pyetjeve të jetës dhe zgjidhje problemeve, jeta nuk na pranon si “ekzistues” dhe na shtyp.

Edhe perëndimi, që është një “shoqëri e mendjes”, nuk ka ndonjë fjalë për të thënë në çështjen e kuptimit të jetës. Ai është i preokupuar për t’i vënë në gjumë individët me ninullat “e shpejtësisë e të kënaqësisë”. Nëse nuk i vë dot në gjumë, i bën të mos ndjejnë gjë. “Në perëndim nuk ka ndonjë gjë të re.” Ai e konsideron njeriun budalla dhe i vë përpara shumë lodra. Kjo është e gjitha.

Të jetosh, nuk do të thotë të marrësh e të japësh frymë. Të jetosh, është bukuria e ndjenjave dhe mendimeve. Është përpjekje për ta kaluar këtë bukuri në jetë. Është lumturia që buron nga kjo përpjekje.

Thonë se puna që bëhet me dashuri, është më e lehtë. Thonë, gruaja është bashkëshortja e burrit, është dielli i shtëpisë”. Njeriu që paska gjetur bashkëshorten dhe punën që do, paska hyrë në xhenet, ndërsa ai që punon duke mos dashur, u përpëlitka.

Bota pa probleme është thjesht një imagjinatë. “Njeriu është i vdekshëm dhe dita ka mbrëmje”. Nëse kërkojmë një botë për të jetuar larg brengave dhe problemeve, atëherë paskemi për të kërkuar deri në kiamet.

Të mos shqetësohesh kur kërkon një rrugëzgjdhje nga brengat dhe vështirësitë për të jetuar, do të thotë se dora nuk është në harmoni me këmbën.

“Det pa dallgë dhe njeri pa brenga, nuk ka.” Nëse nuk inatosemi, nëse nuk na kap paniku dhe nëse nuk zemërohem me njerëzit, kur përpiqemi për t’i zgjidhur dhe kapërcyer ngjarjet brengosëse, gjërat negative dhe problemet, ky është një sukses i madh.

Kam lexuar një shënim që ia kishte lënë birit të vet një major, që kishte vrarë veten para disa vitesh:

“Bir! Unë nuk munda t’ia dal me këta njerëz. Ti gjej një mënyrë për t’ia dalë mbanë!”

Ajo që unë kuptova nga kjo këshillë, është: “Edhe pse nuk kam gjetur një mënyrë për të jetuar në paqe me këtë botë, ti gjej një mënyrë për të mos hyrë në tension kundrejt atyre që ndodhin. Meqë je i detyruar të jetosh me këta njerëz, atëherë tensioni nuk ka dobi. Ti mundohu të jesh i qetë, nganjëherë duke bërë sikur nuk shikon, nganjëherë duke bërë sikur

nuk dëgjon dhe nganjëherë duke bërë si budalla.

Sipas meje, kjo është një këshillë e drejtë. Ne nuk mund të presim që çdo njeri të mendojë si ne apo të jetë si ne. Rrugëzgjdhja e kësaj, është t’i pranojmë njerëzit ashtu si janë.

Ajo që po përpiqem të shpjegoj, nuk është në kuptimin: “Ai që vjen është agai, ai që shkon është pashai”. Unë dua të them që ta arrijmë vazhdimisht lumturinë në jetë, kur jetojmë ndershmërisht dhe kur përpiqemi për të drejtën.

Të jetosh, është një namaz që falet me frikërespekt ndaj Zotit, një fatiha që lexohet nga thellësia e zemrës dhe një lutje e ngrohtë. Produktiviteti është i lodhshëm, por në fund sjell lumturinë e xhenetit. Edhe pse dembelizmi sjell një rehati fizike, shpirtërisht sjell lodhje dhe vështirësi në varr.

Produktiviteti është gjendja e të qenit i kënaqur, por, nëse kjo nuk e kalon vijën e interesit dhe nuk e arrin kufirin e kënaqësisë hyjnore, kënaqësia shpirtërore nuk mund të jetë e vazhdueshme dhe tërhiqet nga qëllimi i lartë që ka. Të arrish në gradën: “In exhrije illa alallah / Shpërblimi im është vetëm te Allahu”, është një kusht i madh. Domethënë, njeriu duhet të vijë në një gjendje që, çfarëdo të presë, ta presë nga Allahu i Madhëruar.

Të jetosh, është kënaqësi e botës shpirtërore.

Të jetosh, është lumturi familjare. Lumturia është dielli i dashurisë që lind nga gjuha. Ajo e ndriçon dhe e ngroh jetën tonë.

Të jetosh, është një emocion i lartë, që sjell lidhja e formuar me Allahun (xh. xh). Ajo është zgjerim i botës dhe zgjatje e imagjinatës sonë në botën e përtejme, si rezultat i kësaj lidhjeje. Në këtë kontekst, Allah, do të thotë, Ai që na jep jetë.

Të jetosh, do të thotë të përdorim vullnetin tonë dhe të kufizojmë veten tonë. Të mjaftohemi dhe të gëzohemi me atë që kemi. Të pakësojmë pasionet, nëse nuk shtojmë dot mundësitë tona.

Të jetosh është diçka si “vrapimi i pikës për në det”.

Të jetosh, është dashuri për të ecur pa ndalur e pa pushuar dhe arritje nga një gradë në gradën tjetër.

Të jetosh, është një luftë dhe përpjekje e gjatë që mund të bëhet me vetëdije dhe durim për të mos lindur në haram dhe vdekur në vend ku gjenden idhuj.

Të jetosh, do të thotë të lahesh në ujërat e të mjaftuarit me pasurinë që ke dhe të arrish pasurinë shpirtërore. Do të thotë, t’i lartësosh dhe t’i zbukurosh gradë-gradë ditët e kësaj bote, për t’u zgjuar duke buzëqeshur në mahsher.



# Vetëdija ndaj Mirësive

— Ali Riza Temel —

Askush nuk mund ta dijë vlerën e mirësive për të cilat nuk është i vetëdijshëm. Vlera e tyre kuptohet vetëm atëherë kur ato mirësi dalin prej duarve. Por kur ndodh kjo, atëherë në dorë ngelet vetëm keqardhja. Ajo që i ka hije çdo myslimani, është të jetë i vetëdijshëm ndaj mirësive të panumërta që i janë falur dhe në radhë të parë, të përkujtojë e të falënderojë Atë që ia ka falur këto mirësi dhe së dyti, t'i konsiderojë ato mirësi si amanete e t'i ruajë me shumë kujdes.

Të jesh i krijuar si njeri, të jesh krijesa më fisnike, të jesh i nderuar me Islam dhe të konsiderohesh halifi, (mëkëmbësi) i Allahut në tokë, janë disa nga mirësitë më të mëdha ndër të gjitha mirësitë e panumërta që na janë falur. Allahu Teala, në shumë ajete të Kuranit Kerim, u kujton njerëzve mirësitë që u ka dhënë, por vë në pah edhe qëndrimin mosfalënderues dhe mosmirënjohës të tyre:

*“Allahu është Ai që ka krijuar qiejt dhe Tokën. Ai lëshon ujë nga qielli e nëpërmjet tij, nxjerr fruta si ushqim për ju. Ai i ka vënë në shërbimin tuaj anijet, që me lejen e Tij, ju të lundroni me to nëpër dete. Ai i ka krijuar lumenjtë për dobinë tuaj e po ashtu edhe Diellin dhe Hënë, që lëvizin vazhdimisht. Ai ka vënë në shërbimin tuaj natën dhe ditën. Ai ju jep gjithçka që i kërkon. Edhe nëse përpigëni t'i numëroni dhuntitë e Allahut, nuk do të mund t'i numëroni dot. Njeriu është vërtet i padrejtë dhe mosmirënjohës.”* (Ibrahim, 32-34)

*“A nuk shihni se si Allahu jua ka bërë të mundur t'i shfrytëzoni të gjitha ato që gjenden në qiejt dhe në Tokë dhe ju ka mbuluar me dhuntitë e Tij të dukshme e të padukshme? E megjithatë, disa njerëz polemizojnë për Allahun pa kurrfarë dijenie, pa kurrfarë rrëfyese dhe pa libër ndriçues.”* (Lukman, 20)

Çdo gjë që kemi, është pronë e Allahut. Madje, ne nuk jemi as pronarët e vetes sonë. Ne nuk mund të veprojme si të duam me trupin tonë. Pra, jemi të detyruar që trupin tonë ta përdorim sipas udhëzimeve të Allahut Teala, i Cili edhe na e ka dhënë atë. Jemi të detyruar që organet tona të mos i përdorim për të bërë gjynahe dhe në kundërshtim me natyrshmërinë e tyre. Askush nuk ka të drejtë të thotë: “Kjo është jeta ime.” Nëse dua, vetëvritem dhe i jap fund asaj, sepse edhe shpirti edhe trupi janë të Allahut. Dhe askush nuk mund të veprojë në kundërshtim me urdhrat e Allahut në pronën e Tij.

Ashtu si peshqit që nuk janë të vetëdijshëm për detin, ashtu edhe disa njerëz nuk janë të vetëdijshëm për mirësitë në të cilat notojnë. Të marrësh frymë, të shohësh, të dëgjosh, të mendosh, të ndjesh, të hash, të pish, të flesh, të ecësh, të flasësh dhe shumë cilësi të tjera si këto, janë mirësi të mëdha e të paçmueshme.

Një njeri, i cili nuk ishte i vetëdijshëm për mirësitë që kishte, shkoi te një njeri i mençur dhe iu ankua për varfërinë duke i thënë se s’kishte asgjë. Pasi e dëgjoi, njeriu i mençur i tha:

- A dëshiron dhjetë mijë dirhem në këmbim të dy syve?

- Jo, tha ai.

- Po sikur të jesh memec, por të kesh dhjetë mijë dirhem?

- Jo.

- Po sikur të mos kesh as duar dhe as këmbë, por të kesh njëzet mijë dirhem?

- Jo.

- Po sikur të jesh i çmendur, por të kesh dhjetë mijë dirhem?

- Jo.

- Atëherë, a nuk të vjen turp? Megjithëse zotëron të gjitha këto të mira të Allahut me vlerë pesëdhjetë mijë dirhem, përsëri ankohesh.

Sipas një transmetimi, profetit Ejub (a.s.), i është thënë:

“O Ejub! Lutju Allahut të të lehtësojë sëmundenjen!”

Ejubi (a.s.), tha: “Shtatëdhjetë vjet kam gëzuar shëndet të mirë. Kurse koha e sëmundjes sime është më e shkurtër. Prandaj më duhet të duroj shtatëdhjetë vjet për hir të Allahut.”

Sigurisht që ne mund të lutemi e të kërkojmë shërim e kurim, por nuk duhet të ankohe mi. Ajo që i takon njeriut, është të falënderojë për mirësinë dhe të durojë ndaj fatkeqësisë. Ky është durimi, të qëndrosh në këmbë e i palëkundur.

Nëse shohim veten tonë dhe përreth nesh, do të vëmë re se ka aq shumë gjëra për të cilat duhet të falënderojmë, sa që kur i mendojmë, nuk do të gjejmë asnjë arsye për t’u ankuar.

Një prej sahabëve, Urve bin Zubejr, u godit me dy fatkeqësi në një ditë. Për shkak të shkelmimit të kalit, i vdiq djali dhe për shkak të sëmundjes së rëndë, e cila i kishte mbuluar të gjithë trupin, doktori i preu njëren këmbë. Megjithatë, ai nuk u ankua, por falënderoi Allahun. Në fillim pa djalin e vdekur, pastaj atë që kishte gjallë dhe tha: “O Allah! Megjithëse ma more njërin, ma ke falur tjetrin”. Pastaj pa këmbën e prerë dhe këmbën e shëndoshë dhe tha: “O Allah! Megjithëse më sprovove me një-

rën, ma ke falur tjetrën.” Ky pra, është vlerësimi i duhur.

Nëse njeriu shikon vetëm anën negative, nuk mund të shohë asgjë pozitive.

Por, nëse sheh anën pozitive, do të kuptojë se në çdo gjë ka mirësi dhe urtësi. Në shumë gjëra që mund të duken si fatkeqësi, në vetvete mund të jenë edhe mirësi.

Ato mund të jenë edhe paralajmërime, me qëllim që njeriu të mos bjerë në gjendje edhe më të këqija.

Pra, shuplaka mëshiruese. Një fatkeqësi është më e vlefshme se njëmijë këshilla. Fatkeqësia nuk lypet, por kur të bie në kokë, analizohen arsyet, shikohen gabimet dhe merret mësim prej saj.

Transmetohet se Omeri (r.a.), ka thënë: “Kur më ka goditur një fatkeqësi, kam vënë re se në këtë fatkeqësi, Allahu më ka dhënë katër mirësi”:

1- Që kjo fatkeqësi nuk është në lidhje me fenë time.

2- Që nuk është fatkeqësia më e madhe.

3- Që nuk më pengon të jem i kënaqur prej Allahut.

4- Bëhet shkak që të shpresoj shpërblim prej Allahut.

Nëse shihet në mënyrë pozitive, mund të korrësh mirësi edhe prej fatkeqësisë. Por nëse shihet në mënyrë negative edhe mirësitë kthehen në fatkeqësi.



**“NË DITËN E GJYKIMIT, ASNJË ROB NUK DO TË LËVIZË PREJ VENDIT PA DHËNË LLOGARI PËR KËTO GJËRA: SI E KA HARXHUAR JETËN, ÇFARË PUNOI ME DITURINË, KU E KA FITUAR DHE SHPENZUAR PASURINË DHE KU E KA KONSUMUAR TRUPIN?” (TIRMIDHI, 2417)**

Vetëdija ndaj mirësive është shkak lumturie. Ndërsa njerëzit mosmirënjohës nuk janë asnjëherë të lumtur, sepse ata gjithmonë ndihen të privuar nga diçka. Ata vuajnë skamjen edhe kur janë të kamur. Dhe për shkak se nuk i shohin mirësitë e panumërta që kanë përpara syve, e harxhojnë jetën duke rëndur pas të mirave imagjinare. Ata që nuk dinë çfarë kërkojnë, nuk dinë as se çfarë kanë gjetur.

Mosvetëdija ndaj asaj që zotërohet vjen ose nga injoranca, ose nga ambicia. Të dyja këto e verbojnë njeriun. Të varfrit, që janë të kënaqur me atë që kanë, gëzohen edhe me diçka të vogël. Kurse të pasurit tamahqarë nuk lumturohen as me pasuritë më të mëdha. Kthimi i mirësive nga përfitimi në humbje dhe Nemrudizimi e Faraonizimi i njeriut, vjen për shkak të mosfalënderimit dhe mosmirënjohjes. Ata që e përdorin mirësinë e sundimit për të shtypur njerëzit dhe ata që e përdorin mirësinë e pasurisë si mjet urrejtjeje, në vend që ta përdorin si mjet mëshire, janë ata të cilët kanë harruar pronarin e vërtetë të këtyre mirësive dhe që e vënë veten në vend të Zotit.

Adhurimet janë falënderim ndaj Allahut për mirësitë e pafundme që na ka dhuruar. Të ndash të mirat që të ka dhënë Allahu me krijesat e tjera të Allahut, është mënyra më e bukur e falënderimit. Ata që falënderojnë Allahun, meritojnë edhe falënderimin. Ata fitojnë edhe kënaqësinë e Allahut edhe duatë e njerëzve të tjerë. Ky është fitimi më i madh që mund të arrihet me anë të mirësive. Falënderimi është shkak begatie. **(Kujtoje) kur Zoti juaj kumtoi: “Nëse tregoheni mirënjohës, Unë do t’juaj shtoj edhe më shumë begatitë e Mia...”** (Ibrahim, 7) Fatkeqësitë prej të cilave vuan bota, vijnë gjithmonë për shkak të mosmirënjohësve. Ata gjithmonë bëhen shkak i dënimit të ashpër të Allahut.

Të gjithë do të japim llogari tek pronari i mirësive për mirësitë që na ka falur, qofshim apo jo të vetëdijshëm për to. **“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!”** (Tekathur, 8) Kur u zbrit ky ajet, një i varfër u çua në këmbë dhe tha: “Po unë s’kam asnjë shenjë prej mirësive! Kurse Profeti ynë (a.s.), ia ktheu: **“Ke këpucët, pi ujë të ftohtë dhe freskohesh në hije”.**

Sa mirësi të madhe gëzon dikush që s’ka këpucë,

në krahasim me atë që nuk ka këmbë! Një gram shëndet vlen sa të gjitha pasuritë e botës. Dëshira më e madhe e dikujt që i kanë rënë flokët dhe dhëmbët, është të gëzojë flokë të dendur dhe dhëmbë të bukur si rruaza. Mirëpo, kur kishte flokë dhe dhëmbë, ai nuk i konsideronte këto si mirësi. Vlera e mirësive, si rinia, shëndeti, pasuria, pozita, respekti dhe shumë mirësi të tjera njihet më mirë në kohë të pleqërisë, sëmundjes, varfërisë, dobësisë dhe braktisjes.

Askush nuk ka të drejtë të protestojë ndaj Allahut Teala. Dhe mbi të gjitha, nuk mund të pretendojë të marrë gjë prej Tij, sepse Ai çdo gjë na e ka dhënë. Dhe ai që jep, ka të drejtë edhe të marrë. Ne prej Tij vijmë dhe tek Ai do të shkojmë.

Për shkak se pandehim që çdo gjë është e jona, harrojmë të falënderojmë, por kur dikush na dhuron diçka, menjëherë e falënderojmë. Pra, ne nuk i konsiderojmë si dhuratë mirësitë e Allahut. Mirëpo, në fakt edhe dhuratat që na bëjnë të tjerët, janë në sajë të Allahut. Pra, sido që të jetë, në fund të fundit çdo falënderim dhe mirënjohje kthehet tek Allahu. Nëse Ai nuk lëshon shiun nga qielli, e nëse nuk e bën të mundur mbirjen e bimëve, si do të vejë halli ynë!?

Vetëdijësimi ndaj mirësive të Zotit tonë, shfaqja e falënderimit dhe mirënjohjes për ato mirësi dhe përdorimi i tyre pa i shpërdoruar, duke menduar se ato janë amanet për ne, i jep rregull dhe kuptim, si jetës individuale, ashtu edhe asaj shoqërore. Dhe kjo është detyra e çdo myslimani të devotshëm, sepse sido që të jetë, do të vijë një ditë kur ne do të japim llogari për to. Profeti (a.s.), në lidhje me këtë gjendje shprehet:

**“Në ditën e gjykimit, asnjë rob nuk do të lëvizë prej vendit pa dhënë llogari për këto gjëra: Si e ka harxhuar jetën, çfarë punoi me diturinë, ku e ka fituar dhe shpenzuar pasurinë dhe ku e ka konsumuar trupin?”** (Tirmidhi, 2417)

Për çdo gjë që na është falur, na është ngarkuar edhe një përgjegjësi. Në fakt, bartja e përgjegjësisë, është edhe cilësia themelore, e cila e dallon njeriun nga krijesat e tjera. Dhe në krye të këtyre përgjegjësisë, qëndron vetëdija ndaj mirësive dhe Pronarit të tyre të vërtetë dhe falënderimi për to.



— A. Jasin Demirxhi

### La tahzen

#### Mos u brengos

Në një dërrasë të nxirë nuk mund të shkruhet. Nëse Allahu Teala të jep ndonjë fatkeqësi apo të bën të qash, dije se me këtë Ai dëshiron të pastrojë tabelën e zemrës, për të gdhendur mëshirën e Tij.

### La tahzen

#### Mos u brengos

Frika, uria, pakësimi i pasurisë dhe sëmundja, nxjerrin në pah thesarin e shpirtit.

### La tahzen

#### Mos u brengos

Junusi u poq në bark-un e peshkut. Junusi doli në tokë, ngaqë madhëroi Allahun. Të durosh, është tesbih e shpirtit. Durimi është urë. Kështu që, mos u anko kur të kalosh, sepse rruga jote, sidoqoftë, do të të shpjerë në xhenet.

### La tahzen

#### Mos u brengos

Nëse halli bëhet shkak për të përkujtuar fshehtazi Allahun (xh. xh), atëherë ai është më i mirë se e gjithë pasuria e kësaj bote. Lutja pa halle është e ftohë. Duaja me shqetësime vjen nga zemra dhe dashuria. Durimi është çelësi i halleve dhe shqetësimeve.

# Të blesh lumturinë

Një studim i bërë në perëndim, nxori në pah se njerëzit që e kanë bërë zakon dhënien e lëmshës të varfërve (edhe nëse është e vogël si 1 apo 2 dollarë), e ndjejnë veten shumë më të lumtur. Përsëri, një studim tjetër në perëndim, vërtetoi se humanizmi është njëri prej faktorëve më kryesorë që shton lumturinë. Po ashtu, është zbuluar se këta lloj njerëzish, jo vetëm që flenë rehat, por në të njëjtën kohë, jetojnë edhe më gjatë.

Studimi që psikologët e Universitetit Michigam bënë mbi 423 çifte të mos-huara, përgjatë pesë viteve, dha rezultat pro barmirësve me një ndryshim të qartë. Përgjatë këtij studimi, kishin vdekur 134 prej këtyre të moshuarve. Pastaj doli në pah se numri i të vdekurve bamirës, pothuajse ishte sa gjysma e të vdekurve që nuk kishin ndihmuar asnjëherë...

Sigurisht, ne nuk kemi nevojë për referencat perëndimore rreth urtësisë, virtutit dhe rezultateve pozitive shpirtërore e materiale të infakut (dhënies për hir të Allahut) dhe humanizmit, sepse të gjitha këto, besimtarët i kanë ditur shumë më parë. Ata mësuan nga i Dërguari i Allahut, (a.s.), që para 1400 vjetësh se infaku, bujaria dhe humanizmi janë çelësi i dynjasë, ahiretit dhe prehjes shpirtërore.

Sahabët e nderuar, që ishin nxënësit e Hz. Pejgamberit (a.s.), mësuan prej tij aq shumë gjëra, saqë për hir të Allahut të Madhëruar dhe për qetësinë e tyre shpirtërore në këtë botë, arritën të hiqnin dorë nga çdo gjë që kishin. Ata shfaqën shembujt më të bukur të infakut. Në një kuptim, blenë me infak lumturinë dhe qetësinë shpirtërore të dy botëve. Ejani t'i vëmë veshin ngjarjes që tregon përpikërinë që kishin sahabët e nderuar në çështjen e bamirësisë, për të cilin edhe shkencërisht është vërtetuar se jep qetësi shpirtërore.

Një ditë të nxehtë, biri i Xhafer b. Ebu Talibit, Abdullahu, i cili ishte vëllai i madh i Hz. Aliut (r.a.), hyri në vreshtin e hurmave të një fisi. Ndërkohë që Abdullahu po pushonte aty, pa se robit që punonte në vreshtë, i erdhën për ushqim të vaktit tri copa bukë.

Kur robi po fuste në gojë njëren prej copave të bukës, përpara tij u shfaq një qen që dukej qartë se ishte i uritur. Ai ia dha qenit bukën që kishte në dorë. Qeni e hëngri bukën menjëherë. Robi ia dha qenit edhe copën e dytë. Qeni e hëngri edhe atë me një kafshatë. Pastaj ia dha qenit edhe copën e tretë. Ndërkohë që po ngrihej për t'u kthyer në punën e tij, Abdullahu (r.a.), që e pa çdo gjë nga larg, iu afrua dhe e pyeti:

-O rob! Sa ushqim kishe për sot?

Robi iu përgjigj duke hezituar:

-Ja, këto tri copa bukë.

-Atëherë, përse nuk le asgjë për veten tënde?

-Pashë se qeni ishte shumë i uritur dhe nuk desha ta lija në atë gjendje.

-Po ti, çfarë do të hash tani?

-Do të agjëroj.


Abdullah b. Xhaferi (r.a.), e pyeti robin për shtëpinë e zotërisë së tij. Pastaj shkoi dhe bleu vreshtën e hurmave bashkë me robin. U kthye dhe i tha robit se e kishte blerë vreshtën bashkë me të nga zotëria i tij. Pastaj shtoi:

-Po të jap lirinë. Edhe këtë vreshtë po ta dhuroj ty.

Kur Abdullah b. Xhaferin (r.a.), i cili njihej për bujarinë e tij, e pyesnin se njihite apo jo dikë më bujar se veten, tregonte këtë ngjarje. Ndërsa, kur i thoshin:

-Por ai i dha qenit thjesht tri copa bukë, ndërsa ti i dha atij një vreshtë të madhe dhe lirinë:

-Ai dha çdo gjë që kishte, ndërsa unë vetëm një pjesë...



# NDJESHMËRIA NDAJ SHPËRDORIMIT OSE ETIKA E KONSUMIT

— Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz —

Shpërdorimi (israf) është një koncept kuranor, që ka kuptimin e të tejkaluarit të asaj çfarë konsiderohet e mesme, pra teprimi në përdorimin e diçkaje. Edhe nëse përdoret për mundësitë dhe vlerat materiale, si pasuria dhe trashëgimia, ky koncept përfshin çdo gjë që tejkalohet në përdorim. Shpërdorimi, ashtu sikurse mund të përdoret në raste konsumi ushqimor apo veshjesh, mund të përdoret edhe për kohën, shëndetin dhe ambjentin. Shkalla më e ulët e konsumit është koprracia, kurse ai që ndodhet në skajin e kundërt të koprracisë është shpërdorimi. Në këto dy ajete, kjo temë përmendet në këtë mënyrë: **“Dhe ata që, kur shpenzojnë nuk janë as dorëshpuar, as dorështrënguar, por i përmbahen së mesmes;”** (Furkan, 67) **“Mos e shtrëngo dorën,**

**as mos u bëj dorëshpuar e të mbetesh i qortuar dhe i mjerë.”** (Isra, 29)

Sipas Islamit, edhe koprracia edhe shpërdorimi janë ndjenja epshore. Për shkak të dobësisë që ka për nefsën, njeriu shpërdoron duke bërë shpenzime të pakontrollueshme. Njeriu, po ashtu, duke u bazuar në ndjenjën e të kursyerit, bën koprracin dhe i bën rojën pasurisë së vet. Zekati, që është një obligim hyjnor dhe fetar, në këtë rast është një spastrim; edukon ndjenjën egoiste që ka njeriu, e shpëton atë nga smira dhe koprracia. Kështu, e mëson atë të jetojë ekonomikisht, pa tejkaluar masën në përdorim. Obligimi i zekatit ka veçorinë e të ndarit të mundësive materiale që ka njeriu. Islami është një rrugë e mesme që urdhëron drejtësinë, që

**“HANI E PINI, POR MOS E  
TEPRONI, SE AI NUK I DO ATA  
QË E TEPROJNË.”**

(ARAF, 31)

**“ËSHTË AI QË KA KRIJUAR  
KOPSHTE VRESHTASH TË LARTA  
DHE TË SHTRUARA, HURMA DHE  
BIMË ME SHIJE TË NDRYSHME,  
ULLINJ E SHEGË, TË NGJASHME  
DHE TË NDRYSHME. HANI  
FRUTAT E TYRE KURDO QË TË  
PRODHOJNË DHE JEPNI ATË  
QË ËSHTË DETYRË NË DITËN E  
VJELJES SË TYRE! POR MOS E  
TEPRONI, SE ALLAHU NUK I DO  
ATA QË E TEPROJNË!”**

(ENAM, 141)



i kushton rëndësi ekuilibrit dhe këshillon të jemi etikë edhe kur konsumojmë. Ata që bëjnë koprracin në jetë, janë pikërisht ata që bëjnë shpërdorime të shfrenuara dhe adhurojnë nefsin e tyre, pasi koprraci, për arsye se mendon vetëm për veten e vet, nuk ndan gjë me të tjerët. Gjithashtu edhe shpërdoruesi, ngaqë mendon vetëm për dëshirat e veta, e përdor pak kontroll gjithçka ka në duar. Ndaj dhe shpenzimi i tepruar që bën njeriu për veten e vet, është quajtur shpërdorim. Kurse ajo çfarë shpenzon për tjetrin nuk hyn në këtë kallëp. Shpërdorim do të thotë të shpenzosh më shumë seç duhet dhe të qenit i papërmbajtur në konsum. Myslimanët përkufizohen në Kuran si një popull që ndjek rrugën e mesme. (shih. Bekare, 143) Gjithashtu, në Kuran gjenden plot ajete që ndalojnë shpërdorimin. Dy nga këto janë:

1. *“Hani e pini, por mos e teproni, se Ai nuk i do ata që e teprojnë.”* (Araf, 31)

2. *“Është Ai që ka krijuar kopshte vreshtash të larta dhe të shtruara, hurma dhe bimë me shije të ndryshme, ullinj e shegë, të ngjashme dhe të ndryshme. Hani frutat e tyre kurdo që të prodhojnë dhe jepni atë që është detyrë në ditën e vjeljes së tyre! Por mos e teproni, se Allahu nuk i do ata që e teprojnë!”* (Enam, 141)

Në Kuran gjendet edhe një tjetër koncept që ka kuptim të përafërt me shpërdorimin, ai është *tebzir*. (Isra, 26) Tebzir është në kuptimin “të derdhësh dhe të shpërndash”, “shpenzimi që bëhet në një vend të palejuar”. Është një përmasë më tej shpërdorimit. Shpërdorimi përfshin shkeljen e kufijve që ka

vendosur feja jonë e bukur dhe ekstremizimin e veprimeve. Ndaj dhe Allahu i Madhëruar na mëson që ne të bëjmë dua: *“O Zoti ynë! Na i fal gjynahet tona dhe teprimin në punën tonë, na i forco këmbët (në istikam) dhe na ndihmo kundër popullit jobesimtar!”* (Ali Imran, 147)

## **DËMET E SHPËRDORIMIT**

Shpërdorimi është një çmenduri e konsumit. Shpërdorimi ka dëme, si materiale ashtu edhe shpirtërore në planin personal dhe në atë shoqëror.

### **Dimensioni personal i dëmit të shpërdorimit**

Shpërdorimi në jetën e njeriut ka dëme si materiale, ashtu edhe shpirtërore. Ngaqë shpërdorimi është të konsumosh më tepër sesa prodhon ose të shpenzosh më shumë sesa ajo çfarë ka nevojë njeriu, fillimisht shkatërron buxhetin personal dhe atë familjar. Ndërsa, ata që përkufizojnë ekonominë thonë se “ekonomia është shkenca që përballon nevojat e pakufijshme përmes burimeve të kufijshme”. Pra ekonomia pranon që nevojat janë të pakufijshme dhe burimet të kufijshme. Ndaj dhe burimet duhen përdour shumë mirë, duhen kufizuar nevojat dhe konsumi duhet bërë sipas normave etike. Kjo gjë arrihet duke ndaluar shpërdorimin dhe duke ekuilibruar konsumin. Dëshirat dhe nevojat e njeriut nuk zënë të ndalen. Për të realizuar këto nuk mjafton një jetë e tërë. Kështu njeriu duhet të shpenzojë tërë jetën për nevojat e tij dhe nuk do mund të kishte kohë për nevoja shpirtërore, si, adhurim, art etj. Thonë se “Ai që nuk di çfarë kërkon, nuk e vëren atë që gjen.” Njeriu i sotëm

nxiton për dëshirat dhe shpenzimet e shfrenuara të tij, ngaqë ka humbur vlerat e larta dhe gjykimet e sakta. Po ashtu, i ka humbur interesi për ndjenjat e larta, si arti, letërsia, adhurimi dhe ndjesia e të shërbyerit, që i shkojnë njeriut.

Shpërdorimi ka edhe dëmet shpirtërore dhe etike, të cilat nuk janë më pak të rëndësishme sesa dëmi material dhe ekonomik i konsumit. Kjo dëshirë e drejton njeriun nga ndjenja për të pasur dhuntitë e dynjasë, që quhen *tul-i emel* (të vepruarit sikur nuk do të vdesësh kurrë) dhe ambicie. Konsumi i shfrenuar e bën njeriun egoist. Kështu, njeriu kap dhe gëlltit gjërat e dynjasë, sikurse toka që thith ujin. Vesi kryesor i njeriut është egoizmi. Njeriu, si pasojë e dashurisë dhe e lidhjes që ka me nefsin e vet, përpiket të plotësojë dëshirat e nefsit dhe të gjejë mënyra që ta realizojë këtë gjë. Pa pasur një edukim të nefsit dhe të dëshirave, është e vështirë, madje e pamundur të frenohen këto ndjenja. Kjo qasje edukative, që synon të parandalojë shpërdorimin, mund ta pengojë sado pak njeriun të sillet si pronari i vërtetë i pasurisë, duke përfutuar nga dhuntitë e botës.

Epërsia e ndjenjës së altruizmit lind solidaritetin e jo shpërdorimin. Shpërdorimi i ndaluar është shpenzimi që bën njeriu për vete, mbi nevojën që ka. Nuk është shpërdorim ajo çfarë shpenzon për të tjerët. Sipas qasjes “futuvvet”, që njihet si një normë etike, shpenzimi i tepruar që bën njeriu për vete, është shpërdorim, kurse shpenzimi që bën njeriu për të tjerët, sado shumë qoftë, nuk është shpërdorim. Shpërdorimi ushqen egoizmin dhe pragmatizmin. Egoizmi dhe pragmatizmi e largon njeriun nga sakrifica për tjetrin, duke menduar “jeto jetën tënde”, e frenon atë të jetë bujar. Në fakt, sjellja që del në kundërshtim me këtë është qasja “një kafshatë një triko”, sepse sipas këtij botëkuptimi, nuk është e rëndësishme pasuria e kësaj bote, por ndarja me të tjerët, të duash të tjerët më shumë se veten dhe të shpërndash gjithçka ke tjetër përveç një kafshate dhe një trikoje. Kjo nuk do të thotë të braktisë punën dhe të mos jesh produktiv, por duke punuar të mos shpenzosh për vete, por për tjetrin dhe të ndihmohesh vëllain që është në vështirësi, pra të bëhesh altruist. Vendi ku mund të ketë më shumë efekt dhe që mund të funksionojë më së miri botëkuptimi “një kafshatë një triko”, është fusha e konsumit. Veçanërisht sot, “ekonomia e shpërdorimit” përmes publiciteteve të ndryshme ka marrë përmasa të mëdha. Gjithçka bazohet në parimin e konsumit, ndaj dhe shpërdorimi është shtuar me hapa galopantë. Duke u bazuar në mendimin “një kafshatë një triko”, hyjnë nën kontroll nevojat e njeriut dhe vendin e ekonomisë së konsumit e zë ekonomia e nevojës. Kështu, njerëzit do të shpëtojnë së përdoruri në mënyrë të tepruar

mundësitë që ofron teknologjia, i pasuri nuk shtyp të varfrin, i varfri do të shpëtojë së shikuari me zili pasurinë e të pasurit dhe nuk do ta vuajë tërë kohën dhimbjen e skamjes. Shpërdorim quhet kur njeriu do të realizojë çdo dëshirë që i shkon në mendje dhe mospasja kufi në këtë pikë. Kufizimi që u bën njeriu dëshirave dhe nevojave, përbën thelbin e etikës së konsumit. Një ditë, Hz. Omeri e sheh të birin, Abdullahin, tek po hante mish dhe e pyet: “Ç’ne, mish po ha?”. “Po – i përgjigjet i biri, më vajti mendja për mish, prandaj”. Hz. Omeri u mërzi dhe i drejtohet të birit: “D.m.th. ti ha çfarë të shkon në mendje. A nuk e di ti se Profeti ynë ka thënë se të hash gjithçka të shkon në mendje është shpërdorim?” (Shih. Ibn Maxhe, Et’ime, 51.) Shpërdorimi e pengon njeriun të kontrollojë nefsin. Njeriun e bën që të bëhet skllav i nefsit dhe nefsin e bën perëndi të tij. Ajeti: **“A e ke parë ti atë që epshin e vet e ka marrë për zot? A do t’i bëhesh mbrojtës atij?”** (Furkan, 43), pikërisht këtë dëshmon. Njeriu zakonisht nuk e vëren që po bën shpenzime të tepruara, sepse **“Kështu, shpërdoruesve iu zbukurohet ajo që punojnë.”** (Junus, 12) Tejngopja nga dhuntitë e Zotit sjell në pah nevoja dhe skamje të reja. Në syrin e një njeriu që ushqehet, vishet apo konsumon në forma të tjera, zvogëlohet vlera e dhuntive. Njeriu që nuk bën shpërdorim dhe që frenon disa dëshira të tij, është i lumtur, sepse dhuntitë kanë më vlerë në syrin e tij.

### Dimensioni social i shpërdorimit

Shpërdorimi, ndoshta më shumë se një devijim që bën individi, është një devijim që bën shoqëria. Ai që mësohet me shpërdorimin, shkon në një gjendje që nuk mendon më për të tjerët. Në këtë mënyrë, rritet edhe ndarja klasore në shoqëri. Sjellja që bëjnë të pasurit si shpërdorues, shtyp të varfrit dhe hap disa plagë sociale tek ata, plagë të cilat mund t’i drejtojnë për në shpërdorim. Në fakt, njeriu, për sa kohë që di të ndajë me tjetrin, është i respektuar dhe i lumtur. Kushti kryesor i dashurisë është ndarja dhe sakrifica. Të ndash pasurinë me të tjerët. Ata që i ka zënë sëmundja e shpërdorimit, nuk ndajnë me të tjerët. Ndaj dhe që të mos mësohen njerëzit me shpërdorimin, Muhamedi (a.s.), u ka thënë: **“Ujin nuk duhet ta shpërdoroni, edhe sikur të merrni abdest në lumë.”** (Ibn Maxhe, Tahere, 48.) Çdo lloj shpërdorimi që bëhet sot në shtëpitë tona, është një plagë shoqërore, duke ia nisur nga uji që harxhohet kot nga rubinetet e shtëpisë sonë, deri tek ushqimi që hidhet në kosh. Thuhet se sasia vjetore e shpërdorimit që i bëjmë pasurisë dhe energjisë e ka kaluar në shifër debitin buxhetor. Lumturia e shoqërisë është e bazuar në dy shtylla të veçanta, njëra është materiale dhe tjetra shpirtërore. Fuqia ekonomike i përket asaj materiale, kurse besimi



dhe etika janë shpirtërore. Shoqëritë që i ka prekur shpërdorimi, nuk mund të arrijnë fuqinë e duhur ekonomike. Kjo shoqëri nuk mund të shpëtojë pa u bërë debitore. Huaja i bën ata skllevër edhe nga aspekti ekonomik edhe nga ai kulturor, ata mbesin të varur prej tyre. Çdo investim dhe shpenzim që bëhet në dobi të shoqërisë, është jashtë asaj çfarë quajmë shpërdorim.

### **Shkaqet që përgatisin shpërdorimin:**

Në krye të shkaqeve që përgatisin shpërdorimin është dëshira për të konsumuar, e cila është e natyrshme (fitri) tek njeriu. Për sa kohë që kjo dëshirë nuk edukohet që të frenohet ose për sa kohë që të ketë një klimë që e mban gjallë këtë ndjenjë, njeriu gjithnjë do ta teprojë në përdorim. Një nga shkaqet që paralizojnë shpërdorimin është rrethi shoqëror, ndikimi që bëjnë njerëzit tek njëri – tjetri. Sot kësaj i është shtuar edhe elementi “publicitet”. Mjetet reklamuese, që i drejtohen veçanërisht syrit dhe veshit, u bënë lokomotivat e ekonomisë së konsumit.


i shkaktojmë rrethit shoqëror apo fizik, është brenda shpërdorimit. Duhet të jemi të ndërgjegjshëm që, aq sa ne edhe të tjerët kanë të drejtë për të jetuar. Nuk duhet harruar që për gjithçka që shpërdoret, ka njerëz që kanë nevojë për të.

### **Në planin shoqëror**

Në jetën shoqërore parandaluesja kryesore është të mësosh të ndash. Duhet larguar nga ideja e shfrytëzimit të mallit të shtetit. Ne duhet të mbrojmë si të tonat vendet dhe mundësitë që përdorim në mënyrë të përbashkët. Duhet të botojmë gjëra që sensibilizojnë individin dhe shoqërinë lidhur me shëndetin dhe shfrytëzimin e kohës së lirë dhe ne na duhet të zhvillojmë zakonet e të lexuarit.

### **Në planin shtetëror**

Pa konsumuar nuk prodhohet, por detyrë e shtetit është t'i shpëtojë nga dhuna e publiciteteve, që vështirësojnë gjendjen ekonomike dhe shkallën sociale të njerëzve. Shteti duhet të ndërmarrë hapa parandalues për shpërdorimin e kohës, mundësive



**Edukimi është rruga e parë që shpëton të mos biesh pre e shpërdorimit. Njeriu duhet edukuar fillimisht në familje, pastaj në shkollë dhe në shoqëri, lidhur me shpërdorimin.**

### **RRUGËT E SHPËTIMIT NGA SHPËRDORIMI**

Për të parandaluar shpërdorimin dhe ekuilibruar konsumin, ka disa detyra dhe përgjegjësi që bien mbi shoqërinë:

#### **Në planin individual**

Edukimi është rruga e parë që shpëton të mos biesh pre e shpërdorimit. Njeriu duhet edukuar fillimisht në familje, pastaj në shkollë dhe në shoqëri, lidhur me shpërdorimin. Ata duhen edukuar që të mos bëjnë shpenzime të tepruara. Të rriturit duhet të jenë shembull për të vegjëlit lidhur me kujdesin që duhet bërë ndaj materialeve të shtëpisë dhe shkollës dhe ndaj pasurisë së shtetit. Duhet ta ngulisim mirë në mendje e zemër se çdo lloj dëmi që

dhe duhet ta shpëtojë popullin nga ambicia e luksit dhe shpërdorimit.

E kundërta e shpërdorimit është produktiviteti. Rritja e produktivitetit në punë, në industri, në prodhimtari, pikësëpari është detyrë e shtetit.

Përfundimisht, shpërdorimi është përdorimi pa ndërgjegje dhe në mënyrë të panevojshme i çdo lloj burimi dhe mundësie. Mënyra për të shpëtuar nga kjo gjë kalon përmes ndërgjegjësimit individual apo social, sensibilizimit të shtetit dhe bërjes së marrëveshjes mes shtetit dhe popullit. Nëse duam të jetojmë të lumtur në vendin tonë dhe t'u lëmë gjëra të bukura brezave që vijnë pas, atëherë le të bëjmë shpenzime më të ekuilibruara, brenda kornizës së etikës së konsumit, duhet të kërkojmë rrugë për të shpëtuar nga çdo lloj shpërdorimi.



# Nderimi i Kuranit

— Ahmet Hamdi Jëlldërëm —

***“Me të vërtetë, ky është një Kuran i nderuar në Librin e ruajtur. Atë (Kuranin) mund ta prekin vetëm të pastrit.”*** (el-Vakia 56/77-79.)

Në krye të detyrave që kemi kundrejt Kuranit fisnik, është respekti e nderimi ndaj tij dhe zbatimi i ligjeve të tij, sepse burimi i Kuranit fisnik, është Allahu Teala. Për këtë arsye, respekti ndaj Kuranit fisnik, është shenja më e dallueshme e adhurimit ndaj Allahut të madhëruar.

Edhe njëra prej shfaqjeve më të rëndësishme të respektit që duhet të kemi ndaj fjalës së Allahut, është leximi i Kuranit fisnik duke qenë i pastër. Pra, ne nuk duhet ta prekim Kuranin fisnik kur jemi pa abdest dhe nuk duhet ta lexojmë kur jemi xhunub apo kur gratë janë në periudhën specifike të tyre.

Në lidhje me këtë çështje, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

*“Dikush që është xhunub apo me menstruacione, nuk mund të lexojë asgjë nga Kurani fisnik.”*

Megjithëse ka prej atyre që e pranojnë si të dobët këtë hadith nga aspekti i letërsisë së hadithit, dijetarët e hadithit në kohët e fundit, si Shejh Ahmed Shakiri dhe Shejh Shuajb el-Arnauti, shprehen se hadithi është i saktë kur vlerësohet bashkë me transmetimet e tjera të tij (shevahid). Nga ana tjetër, dijetarët myslimanë kanë punuar me dispozitën e këtij hadithi dhe e kanë konsideruar haram leximin e Kuranit fisnik nga gruaja që është me menstruacione. Konsensusi (ixhma) në këtë çështje ka vazhduar përgjatë katërmbëdhjetë shekujve. Ky konsensus është prej argumenteve aslij.

Medhhebi Hanefi, Shafii, Hanbeli dhe disa dijetarë prej Malikive, duke e përmendur këtë hadith në përgjithësi, kanë thënë se nuk ka ndryshim ndërmjet gjendjes me menstruacione dhe gjendjes së xhunubllëkut. Në këtë mënyrë, janë shprehur se një mysliman/e në këto dy gjendje, e ka të ndaluar kategorikisht të lexojë Kuranin fisnik derisa të pastrohet.

Mbi të gjitha, kjo dispozitë nuk është dhënë duke u mbështetur vetëm në hadithin fisnik të mësipërm. Kur ta shtjellojmë temën deri në thellësi të saj, do të shohim se ka argumente të ndryshme e të fuqishme në lidhje me këtë dispozitë. Çdo besimtar i përgjegjshëm, është i detyruar ta pranojë si mendim të drejtë e të vetëm mendimin e shumicës së dijetarëve myslimanë përballë këtyre argumenteve.

Njëri prej këtyre argumenteve është ky hadith fisnik:

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

*“Dikush që është xhunub apo me menstruacione, nuk mund të lexojë Kuran.”*<sup>2</sup>

Ndërsa në një transmetim tjetër, njoftohet se i Dërguari i Allahut, (a.s.), nuk e pranoi selamin që i dha dikush kur po merrte abdest, por e pranoi atë pasi e përfundoi abdesin dhe tha:

*“Unë nuk ta pranova selamin, për shkak se nuk dëshiroja ta përmendja pa abdest emrin e Allahut, i cili është i Plotfuqishëm dhe i Lartësuar.”*<sup>3</sup>

Si mund të lejohet leximi i Kuranit fisnik nga një burrë xhunub apo grua me menstruacione, ndër-

kohë që është e papëlqyeshme të pranohet selami pa abdest!?

Imam Maverdi thotë kështu, në një shkrim që i kundërshton ata të cilët e pranojnë si të lejuar leximin e Kuranit fisnik nga një grua me menstruacione:

*“Ky mendim është i gabuar, sepse ka ajete dhe hadithe që e ndalojnë leximin e Kuranit fisnik nga një burrë xhunub dhe grua me menstruacione. Gjendja e menstruacioneve është më e rëndë se xhunubllëku... Edhe një argument tjetër është se ata që e pranojnë këtë mendim, e ndalojnë hyrjen e gruas me menstruacione në xhami. Ndërkohë, nderimi i Kuranit fisnik, është më i rëndësishëm se nderimi i xhamisë...”<sup>4</sup>*

Një çështje tjetër është lidhja e fortë që Kurani fisnik ka me namazin. Allahu i madhëruar e emërtonte namazin si Kuran, ku thotë:

**“...Me të vërtetë, Kurani/namazi i mëngjesit është i dëshmuar.”<sup>5</sup>**

Namazi është emërtuar si Kuran, për shkak se leximi i Kuranit është shtylla më e rëndësishme e namazit. Të gjithë dijetarët kanë rënë në konsensus se nuk mund të ketë namaz pa leximin e Kuranit fisnik. Nisur nga kjo, njëri prej imamëve të njohur Maliki, Kurtubiu ka thënë:

*“Sikur gruaja me menstruacione ta kishte të lejuar leximin e Kuranit fisnik, atëherë mund të falte edhe namaz.”<sup>6</sup>*

Edhe Imam Ibn Abdilberri, i cili ishte njëri prej imamëve më të mëdhenj të medhhebit Maliki, pasi përmend transmetimin që njofton se gruaja me menstruacione mund të kryejë çdo lloj ibadeti të haxhit përveç tavafit, thotë:

*“Në këtë transmetim dhe të tjerë si ky, gjendet argumenti që gruaja me menstruacione nuk mund të lexojë Kuranin fisnik. Ndërsa sipas kijasit, nuk mund të lexojë asgjë nga Kurani fisnik, sepse, po të ishte i lejuar leximi, mund të falte edhe namaz. Sikur të ishte e lejuar falja e namazit, atëherë do të ishte e lejuar edhe hyrja në Qabe për tavaf. Shumica e dijetarëve janë në këtë mendim. Ky është edhe transmetimi i Imam Esh’hebit nga Imam Maliku. Kjo është e vërteta.”<sup>7</sup>*

Nga ana tjetër, sipas një pjese të Malikive që e pranojnë si të lejuar leximin e Kuranit fisnik nga një grua me menstruacione, kjo mund të bëhet kur është e domosdoshme, ndërsa në raste të tjera, nuk është i lejueshëm. Kështu, ata japin rastin kur gruaja kalon një kohë të gjatë me menstruacione apo me

lehoni dhe mund të ketë frikë nga harrimi i Kuranit fisnik. Por frika e harresës nuk mund të jetë justifikim për të bërë një haram. Kjo çështje nuk ka ndonjë shembull në ndonjë vend tjetër.

Krahas së gjithash, një grua me menstruacione mund ta përsërisë Kuranin fisnik duke lexuar pa zë përmendsh, duke e parë ose duke e dëgjuar nga dikush që lexon. Ndërsa në ditët tona, Allahu Teala ka dhënë shumë mirësi të ndryshme. Për këtë arsye, gratë që mësojnë për t’u bërë hafize apo ato që japin mësim Kurani, kanë shumë mundësi të preokupohen me Kuranin fisnik pa e lexuar atë. Pra, duke filluar që nga mjetet incizuese e deri te kompjuterat.

Këtu ka edhe një çështje tjetër, që është e rëndësishme. Kuptimi i fjalës lexim te Malikitë është i ndryshëm nga kuptimi i fjalës lexim te dijetarët e medhhebeve të tjera. Nëse e shtjellojmë nga aspekti i medhhebit Hanefi, lexim do të thotë që njeriu ta realizojë veprën e të lexuarit me një zë që, të paktën, ta dëgjojë vetë. Nisur nga ky përkufizim, lexim nuk quhet murmurima, ajo që thuhet duke mos e dëgjuar as vetë dhe ajo që mendohet.

Leximi në namaz duhet të bëhet me një zë që, së paku, ta dëgjojë vetë lexuesi, në mënyrë që namazi të jetë i saktë. Kufiri më i vogël në namazet që falen pa zë, është leximi me një zë që të paktën ta dëgjojë vetë lexuesi. Ndërsa në namazet me zë, leximi duhet të bëhet me një zë që e dëgjojnë edhe të tjerët. Shumica dërmuese e dijetarëve tanë e kanë vënë si kusht këtë për leximin e Kuranit fisnik.

Ndërsa, sipas shumicës së dijetarëve të medhhebit Maliki, dëgjimi i zërit nga ana e lexuesit nuk është kusht për leximin. Pra, leximi me mendje, murmurima dhe leximi duke lëvizur buzët, aq sa nuk mund ta dëgjojë edhe lexuesi, është i lejuar sipas shumicës së dijetarëve Maliki. Kështu që, namazi lejohet të falet me një lexim të tillë. Pra, me një lexim pa zë.

Kur çështja shtjellohet në këtë mënyrë, atëherë nuk ngel vend më për kundërshtim. Edhe sipas dijetarëve tanë, që nuk e konsiderojnë të lejueshëm leximin e Kuranit fisnik nga një grua me menstruacione, një grua në këtë gjendje e ka të lejuar ta lexojë Kuranin fisnik me mendje, apo duke murmuritur, aq sa nuk i dëgjohet zëri, apo duke e lexuar përmendsh. Në këtë mënyrë, arrihet uniteti në mendim, për shkak se Malikitë, këtë lloj leximi e pranojnë si lexim.

■ **REFERENCAT:** 1) Tirmidhi, Taharet, 98; Ibni Maxhe, Taharet, 105. 2) Darimi, Vudu, 103. 3) Ebu Davud, Taharet, 8; Nesai, Taharet, 23; Ibni Maxhe, Taharet, 27. 4) *el-Havi'l-Kebir*, vëll. 1, fq. 147. 5) Isra, 78. 6) Ibni Abdilberri, *et-Temhid*, vëll. 1, fq. 149. 7) Istizkar, vëll. 11, fq. 190.

# Bëhu Kuran i gjallë

— Doç. dr. Kerim Bulladë —

Edukimi i fëmijëve dhe i të rinjve dhe përgatitja e tyre për jetën, është ideali më i rëndësishëm i çdo populli. Fëmijët dhe të rinjtë janë faktorët më kryesorë të së ardhmes dhe lirisë. Ata janë burimi më i rëndësishëm i fuqisë së një familjeje, shoqërie dhe shteti. Për këtë arsye, popujt që edukojnë rininë e tyre me cilësi të lartë, duke marrë parasysh kushtet e kohës, kanë korrur shumë sukses.

Nga aspekti islam, çështja më jetike në përgatitjen e fëmijëve dhe të rinjve, është edukimi i tyre me besnikërinë ndaj fesë, atdheut, traditës dhe zakoneve të tyre. Nëse nuk do të kenë edukim fetar, ata do ta kenë shumë të vështirë të ruajnë identitetin dhe të mësojnë të kaluarën e tyre historike. Edukimi fetar është ai që mund t'i bëjë ata të formojnë lidhje me këto vlera.

Në lidhje me këtë çështje, psikiatri i njohur Ord. Prof. Dr. Maz'har Osman Uzmani ka bërë këtë vlerësim:

“...Në të gjithë botën feja është edukimi më themelor për shoqërinë. Edhe nëse janë të forta, frymëzimet që u bëhen shoqërive, të cilat nuk mbështeten në përshtetshmëri dhe në edukimin fetar, nuk janë ndikuese. Çdo individ është i lidhur natyrshëm me traditën fetare ose përmes trashëgimisë . Edukimi familjar, që ka baza në fe është shumë më serioz. Sigurisht, edukimi shkollor është një edukim i fuqishëm, që meriton të respektohet, por nëse bazën e

tij e formojmë që në fillim, ka më shumë rezultat.

Edukimi fetar e mbron njeriun nga të këqijat dhe ligësitë që mund t'i bëjë vetes, familjes, atdheut, popullit dhe të gjithë botës. Në kohët tona është kuptuar tashmë se faktori i vështirësive që konsiderohen më materiale, ka burim shpirtëror dhe psikologjik. Sëmundjet dhe hidhërimet më të rënda, qetësohen dhe shuhen me ngushëllime fetare dhe me lartësimin e shpirtit. Të rinjtë që janë të lidhur me fenë, moralin, traditën dhe janë të edukuar në këtë mënyrë, bëhen njerëz fatlumë, sidomos nëse u jepet edhe edukimi kulturor e civil. Kudo që të shkoni nëpër botë, do të shihni se edhe njerëzit me kulturën më të lartë, janë të lidhur me fenë, popullin, familjen, nderin dhe traditën. Një njeri që nuk di të respektojë fenë dhe moralin, e ka shumë të vështirë të respektojë ligjin.”<sup>1</sup>

Çështjen bazë të edukimit fetar e formon mësimi i Kurani. Kurani Fisnik e mbron, e zhvillon dhe e forcon natyrshmërinë e pastër e të dëlirë të fëmijëve dhe të të rinjve. Myslimanët e dinë këtë të vërtetë dhe për këtë arsye, e kanë pranuar si detyrë themelore mësimin e Kurani fëmijëve të tyre që në moshë të vogël dhe janë përqendruar në këtë aspekt.

Kurani është një libër jete. Ky është parimi i parë

1. *Uyusturucu Kültürü ve Tedbirler Raporu*, Stamboll, 1992, fq. 181 (Revista e botuar nga Yesilay Cemiyeti Genel Merkezi).



që duhet t'ua bëjmë të qartë dhe t'ua theksojmë fëmijëve dhe të rinjve. I Dërguari i Allahut (a.s.) dhe shokët e tij të zgjedhur, u kapën fort pas Kuranit, duke e pranuar atë si një libër jete dhe zbatimin e urdhrave të tij e kishin parim themelor.

Aishja (r.a.), e pyeti kështu një sahab, i cili dëshironte të mësonte prej saj moralin e Pejgamberit (a.s.): “Ti e lexon Kuranin, apo jo?” Sahabi u përgjigj: “Po, e lexoj.” Pastaj Aishja, (r.a.), i tha: “Ja, morali i Profetit (a.s.), ishte Kurani.”<sup>2</sup>

Siç shprehet qartë edhe në hadithin fisnik, morali i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), ishte vetë Kurani Fisnik. Ai ishte dëshmitari i gjallë i Kuranit. Te Ai gjendeshin të gjitha atributet etike, për të cilat bëhet fjalë në Kuran. Ai, (a.s.), ka zbatuar çdo gjë që ka urdhëruar Kurani dhe është larguar nga të gjitha të këqijat e mëkatet që i ka ndaluar ai. I Dërguari i Allahut, (a.s.), nuk është ndarë kurrë nga rruga e drejtë e përkufizuar nga urdhri hyjnor:

**“Prandaj qëndro i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je i urdhëruar”.**<sup>3</sup>

Madje, Pejgamberi u ndikua aq shumë nga ky ajet, saqë tha: “Mua më ka mplantur surja Hud.”<sup>4</sup> Në këtë

2. Muslim, Musafirun, 139; Tirmidhi, Birr, 69; Ibn Maxhe, Ahkam, 14; Ahmed bin Hanbel, IV, 54, 91.

3. Surja Hud, 11/112.

4. Tirmidhi, Tefsir, Surja 57/6.

mënyrë, tregoi thellësinë dhe madhësinë e mesazhit që përfshin ajeti.<sup>5</sup> Pejgamberi ishte një Kuran i gjallë. Edhe sahabët e nderuar u bënë shembull për të gjithë umetin, duke ndjekur të njëjtën rrugë.

Ibn Mes'udi dhe Ubeji, (r.a.), transmetojnë se i Dërguari i Allahut (a.s.), u mësonte atyre nga dhjetë ajete. Ata nuk kalonin te dhjetë ajetet e tjera pa i zbatuar dispozitat që gjendeshin në dhjetë ajetet e para. Pejgamberi ua mësonte atyre Kuranin dhe të punuarit me Kuranin. Abdurrahman es-Sulemi tregon: “Kur mësonim dhjetë ajete nga Kurani, nuk mësonim ajete të tjera pa i mësuar mirë urdhrat, ndalesat, hallallin dhe haramin që përfshinin ato dhjetë ajete.”

Imam Maliku transmeton se Ibn Amri e ka mësuar suren Bekare për dymbëdhjetë vjet. Kur e kishte përfunduar, kishte prerë një deve. Ndërsa Abdullah bin Mes'udi, (r.a.), ka thënë: “Ne e kishim të vështirë të mësonim përmendsh Kuranin. Por e kishim të lehtë të punonim me të. Ndërsa, ata që vijnë pas nesh, do ta kenë të lehtë për ta mësuar Kuranin përmendsh, por do ta kenë të vështirë për të punuar me të.” Thuhet se edhe Umer bin Hattabi, (r.a.), e ka mësuar suren Bekare për dhjetë vjet dhe kur e ka përfunduar, ka prerë një deve për të falënderuar Allahun Teala.<sup>6</sup>

Ne duhet ta gdhendim në vetëdijen e fëmijëve se Kurani është një libër jete dhe se nuk është dërguar vetëm për ta lexuar e mësuar përmendsh. Po ashtu, duhet të theksojmë seriozisht se parimet e dispozitave të tij, duhet të zbatohen në jetë. Kurani i urdhëron kështu të gjithë besimtarët në lidhje me këtë çështje:


**“O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë! Dhe ta dini se Allahu ndërhyr midis njeriut dhe zemrës së tij dhe se tek Ai do të mbliidheni të gjithë!”** (Enfal, 24)

Gjërat që u japin jetë besimtarëve janë urdhrat dhe ndalesat e Allahut Teala dhe të të Dërguarit të Tij, (a.s.). Pa dyshim se në çdo urdhër të Allahut Teala, ka urtësi dhe jetë. Çdo urdhër që vjen nga Allahu (xh.xh.), duhet të pranohet dhe të zbatohet. Kur t'u mësojmë Kuranin fëmijëve dhe të rinjve, vetëdijen e nënshtrimit ndaj Allahut Teala që shprehet në ajetin e mëposhtëm, duhet t'ua japim me përkujdesjen më të madhe. Allahu i Madhëruar në Kuran thotë:

**“I Dërguari beson në atë (Kuranin) që i është**

5. Kerim Bulladë, *Pejgamber Gibi Yasamak*, Stamboll, 2007, fq. 10.

6. Kurtubi, Ebu Abdillahi Muhammed b. Ahmed, *el-Xhamiu li Ahkami'l-Kur'an*, Bejrut, 1993, I, 44-45.



## GJALLËRIMI I BREZAVE, LUMTURIA E TYRE NË KËTË BOTË E NË BOTËN TJETËR, JANË TË LIDHURA ME KUPTIMIN DHE ZBATIMIN E PARIMEVE QË U JEP JETË KURANI.

*shpallur nga Zoti i tij e po ashtu dhe besimtarët: të gjithë besojnë në Allahun, Engjëjt e Tij, Librat e Tij dhe të Dërguarit e Tij (duke thënë): ‘Ne nuk bëjmë dallim mes asnjërit prej të Dërguarve të Tij’. Ata thonë: ‘Ne dëgjojmë dhe bindemi. Faljen Tënde kërkojmë, o Zoti ynë dhe te Ti do të kthehemi!’ (El-Bekare, 285)*

Leximi, thellimi dhe mësimi përmendsh i Kuranit Fisnik, medoemos duhet të formohet mbi bazën e ajetit të mësipërm dhe kjo duhet të shpjegohet me insistim.

I ndjeri Alija Izetbegoviçi, që myslimanët e Bosnjës e quajnë “Mbreti i ditur”, thotë se myslimanët e sotëm i kanë dhënë më shumë rëndësi zbukurimit të Kuranit se sa përmbajtjes së tij, duke u shprehur se edhe fëmijët edukohen brenda kësaj kornize. Në lidhje me këtë çështje ai bën këtë koment të rëndësishëm:

“Gjendja e Kuranit në botë po shfaq një situatë shumë tragjike. Në çdo shtëpi, do ta gjeni atë në një vend të veçantë dhe të lartë. Ai pranohet si dhurata më e bukur, për këtë arsye, përdoret letra më cilësore në botimin e tij. Madje, njerëzit sot po garojnë për të përdorur kaligrafinë më të mirë dhe për të zbukuruar kopertinën e faqet e tij në mënyrën më fantastike. Gjëja e parë që lexon dhe mëson fëmija është Kurani, por krahas kësaj, pjesa dërrmuese e këtyre fëmijëve, do të rriten dhe plaken pa e mësuar përmbajtjen dhe rëndësinë e vërtetë të Kuranit Fisnik. Kurani është një simbol i padiskutueshëm, por e ka humbur të qenët ligj. Ndërkohë që duhet të ndodhte e kundërta.

Vini re, në vend që njerëzit të lexojnë Kuran, ata e zbukurojnë me zë të bukur dhe e komentojnë. As arabët dhe as joarabët, tashmë nuk mund ta kuptojnë Kuranin, për shkak të melodisë së tij të pashoqe. Askush nuk po i njeh më ligjet e tij në formë urdhri të prerë dhe absolut, nganjëherë paralajmërues, të ëmbël e ftues e nganjëherë kërcënues që kërkojnë

ndryshimin e plotë të jetës së njeriut.”<sup>7</sup>

Çështja më kryesore, të cilën duhet ta shtjellojmë kur t’i prezantojmë fëmijët dhe të rinjtë me Kuranin, është kjo: “Përse është dërguar Kurani? Duhet shpjeguar fakti se ai është një libër që e orienton jetën dhe ndërhyr në të. Synimi bazë që duhet t’u mësojmë fëmijëve, është se Kurani është zbritur për t’i udhëzuar njerëzit dhe për t’ua përmirësuar atyre jetën.

Ta respektosh Kuranin, të mos e krahasosh me librat e tjerë, ta mbash lart mbi kraharor, të mos e ulësh në tokë dhe të mos vendosësh mbi të libra apo ndonjë gjë tjetër, sigurisht janë gjëra të rëndësishme, por të mos u bëhet e qartë fëmijëve përmbajtja dhe qëllimi i dërgimit të Kuranit dhe t’u paraqitet Kurani vetëm si një simbol i padiskutueshëm, kur u mësohen parimet që thamë më lart, nuk përputhet me synimin e dërgimit të Librit të Lartë, i cili është zbritur nga Zoti i botëve.

Gjëja më e domosdoshme që duhet të bëjmë sot, është kapërcimi i mentalitetit që fëmijët ta lexojnë Kuranin vetëm si fjalë, të bëhen hafizë, të bëjnë hatme dhe ta lexojnë atë për shpirtin e prindërve apo të njerëzve në të kaluarën. Krahas leximit dhe mësimi përmendsh të Kuranit, vazhdimi i aktivitetit të kuptimit, shpjegimit dhe përjetimit serioz të tij, do t’ua hapë horizontin fëmijëve e të rinjve tanë, do t’ua forcojë besimin dhe do t’ua mbrojë e zhvillojë natyrshmërinë e tyre.

Gjallërimi i brezave, lumturia e tyre në këtë botë e në botën tjetër, janë të lidhura me kuptimin dhe zbatimin e parimeve që u jep jetë Kurani. Ata do ta njohin Zotin, veten e tyre dhe njerëzit me parimet universale të Kuranit fisnik. Krenarinë e njerëzimit, do ta përjetojnë me parimet gjallëruese të Kuranit.

7. Alija Izetbegovic, *islami Yeniden Dogusun Sorunlari ve islam De - larasyonu*, Përkth, Rahman Ademi, Stamboll, 2007, fq. 71.

# SEKRETI i Lutjes

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Që në zanafillën e vet në këtë botë, njeriu ka qenë në përpjekje të vazhdueshme për të kaluar nga gjendja e frikës në gjendjen e sigurisë, nga pesimizmi në optimizëm, nga dhimbja në kënaqësi, nga trazimi dhe pështjellimi në qetësi dhe qartësi. Ndoshta edhe qëllimi i vendosjes së Ademit në parajsë ka pasur për qëllim qetësimin dhe sigurinë e tij.

Gjëja që më së shumti i shkakton shqetësim dhe trondije njeriut është frika dhe telashet, të cilave nuk ua shpjegon dot shkakun. Prandaj Kurani thekson: **“Miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar dhe dëshpëruar.”** (Junus, 62), po ashtu u bën thirrje atyre që kanë qenë të vendosur në rrugën e drejtë se gjatë gjendjes së agonisë do të zbresin engjëjt për t’i qetësuar, duke u thënë: **“Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar.”** (Fussilet, 30)

Sekreti dhe mënyra e vetme për të shpëtuar nga dëshpërimi, brenga dhe frika është besimi, vepra e mirë, devotshmëria dhe lutja. Nga theksimi që ajetet i bëjnë lutjes dhe ibadetit, kuptohet lehtësisht rëndësia e një shpirti të pastër dhe një zemre të qetë e të kënaqur në marrëdhëniet e njeriut me Krijuesin. Lutja është dydimensionale: lutja për veten dhe lutja për të tjerët.

## LUTJA PËR VETEN

Lutja për veten është një thirrje e çiltër, një kërkesë e sinqertë dhe përgjërimit i plotë, drejtuar Allahut. Kjo thirrje e përzemërt ngjitet lart tek Krijuesi dhe Sunduesi i gjithësisë. Kjo thirrje arrin në botën e amëshuar,



ku takohet me mëshirën hyjnore, për të zbritur më pas në gjendje të pastër, të kulluar dhe plot begati në zemrën e njeriut. Arritja e lutjes te Krijuesi Fuqiplotë është e lidhur ngushtë me gjendjen e lutësit për të kalur përtej vetvetes, për të dëgjuar në vend të zërit të vet zërin e Allahut. Lutja e bërë në këtë mënyrë, është e destinuar të pranohet dhe plotësohet nga Krijuesi dhe Zotëruesi i gjithësisë.

Duart që i drejtohen Allahut, gjuha që kujton Atë dhe zemra që digjet nga dashuria për Të, fshin të gjithë mëkatet, djeg të gjitha papastërtitë tek njeriu, duke kultivuar në vend të tyre ndjenja të pastra. Sepse është e pamundur që gjendjet e kundërta të grumbullohen së bashku në një vend. Ashtu siç largohet errësira kur vjen agimi, largohen mëkatet nga njeriu, pastrohet zemra nga pikëllimi dhe brengat, kur aty mbërrin *dhikrullah*. Mjafton që personi të jetë i sinqertë, i çiltër dhe i përkushtuar në ibadetin, lutjen dhe përmendjen e Allahut.

Lutja është urdhëruar nga vetë Allahu, përndryshe nga do ta merrte guximin krijesa prej balte, për t'i kërkuar diçka Krijuesit! Allahu e pranon lutjen, nëse ajo plotëson kriteret e vendosura nga vetë Ai. Plotësimi i lutjes është diçka shumë e thjeshtë për Allahun, i Cili dheun e shndërron në ar dhe po nga dheu krijon njeriun e parë. Krijuesi i gjithësisë është gjithmonë në krijimin e diçkaje të re dhe në përmbushjen e mirësive dhe bujarisë së Tij ndaj krijesave. Kurse njeriu është i prirur të mëkatojë, duke harruar mirësitë dhe bujarinë e Allahut ndaj tij. Lutja drejtuar Allahut bën të mundur që hidhërimi i Allahut për gabimet dhe harresën e njeriut të shndërrohet në durim dhe butësi. Mjafton vullneti i Allahut, për ta shndërruar zjarrin në ujë dhe anasjelltas. Allahu është Ai që i ka dhënë njeriut dëshirën për t'u lutur dhe është po Ai që e pranon atë. Përderisa Allahu na ka urdhëruar për t'iu lutur, njeriut i bie për detyrë të kërkojë nga mirësitë e pafundme dhe të pashtershme të Allahut.

## LUTJA PËR TË TJERËT

Lutja është përpjekje e njeriut për të vënë në lëvizje Mëshirën Hyjnore. Prandaj, lutja reciproke për njëri-tjetrin është po aq e rëndësishme sa lutja për veten. Sekretet e lutjes qëndron në një gjuhë të pastër dhe në një zemër të sinqertë e pa interesa. Inkurajimin për t'u lutur për njëri-tjetrin e gjejmë shpesh në porositë e Pejgamberit (a.s.), si:

a. *“Lutja e një personi mysliman për vëllain e tij, jo të pranishëm, pranohet. Te koka e lutësit ndo-*

*dhet një engjëll i posaçëm, i cili, kur lutësi bën një lutje në dobi të vëllait të tij, ai lutet: ‘Pranoje o Zot! Dhuroja edhe lutësit të njëjtën gjë!’* (Muslim, Dhikër, 87,88)

b. *Kur të gjendeni pranë një të sëmuri apo të vdekuri, lutuni për të mirën e tyre, sepse melekët thonë: ‘Pranoje lutjen e tyre, o Zot’* (Muslim, Xhenaiz, 6)

c. *Dy lutje nuk refuzohen. Midis këtyre dhe Allahut nuk ka perde. Njëra është lutja e atij që i është bërë padrejtësi dhe tjetra lutja e fshehtë e besimtarit për vëllain besimtar.”* (Taberani, Muxhemul kebir, XI, 119)

Mevlana, duke u nisur nga hadithet e mësipërme, e shpjegon kështu sekretin dhe rëndësinë e lutjes përmes gojës së tjetrit: “Ngaqë ti nuk ke bërë mëkat me gojën e tjetrit, ajo gojë është e pastër dhe pa mëkate për ty. Njeriu duhet të kultivojë sjellje të atilla, që goja e të tjerëve të lutet për të natë-ditë.



Të fitosh lutjen e të tjerëve, është një përfitim i paçmuar. Sepse lutja e të tjerëve ushqen ndjenjat e qetësisë dhe gëzimit tek njerëzit dhe bëhet shkak për zbritjen e qetësisë shpirtërore. Ashtu si zekati pastron pasurinë e njerëzve edhe lutja, veçanërisht lutja e Pejgamberëve dhe evlijave u jep njerëzve qetësi shpirtërore, siç theksohet në ajetin: **“Merr nga pasuria e tyre lëmoshë, me të cilën t’i pastrosh ata dhe t’ua rrisësh veprat e mira! Lutu për ta, sepse lutja jote është vërtet qetësim për ta.”** (Teube, 103)

Përfitimi më i madh që sigurojnë ata që luten, është ndjenja e qetësisë dhe sigurisë shpirtërore dhe grada më e lartë e kësaj qetësie është “sekîna”, e cila sipas disa thënieve të Profetit Muhamed (a.s.), të regjistruara në librat e Buhariut dhe të Muslimit, shpreh një prani shpirtërore që zbret së bashku me engjëjt, për të sjellë qetësi në shpirtrat e besimtarëve të devotshëm. Ajeti kuranor thekson pikërisht këtë lloj qetësie: **“Ne të dhamë ty një fitore të qartë, për të t’i falur ty Allahu gabimet e mëparshme dhe të ardhshme, për ta plotësuar dhuntinë e Vet ndaj teje dhe për të të udhëzuar në rrugën e drejtë dhe që Allahu të të japë ndihmë të madhe. Është Ai, që zbriti qetësi në zemrat e besimtarëve, për t’ua forcuar besimin, krahas besimit që patën. Të Allahut janë ushtritë e qiejve dhe të Tokës; Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë.** (Feth, 1-4)

Është pikërisht qetësia që jep lutja, sekretet e sigurisë që krijohet midis njeriut dhe Krijuesit për t’u përhapur më tej midis njerëzve. Ky sekret i lutjes fiton një rëndësi tepër të veçantë në rolin e tij për



të kultivuar paqen e brendshme të njeriut dhe krijimin e një paqeje e sigurie sociale. Në sajë të këtij sekretit të lutjes, njerëzit që luten për njëri-tjetrin tejkalojnë frikën dhe pasigurinë, duke krijuar një shoqëri të mbështetur në dashuri dhe respekt për njëri-tjetrin.

**“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: ‘Paqe qoftë!’; dhe ata që e kalojnë natën duke iu falur Zotit të tyre në sexhde dhe në këmbë dhe ata që thonë: ‘O Zoti ynë, largoje prej nesh ndëshkimin e Xhehenemit, sepse, me të vërtetë, dënimi i tij është i përjetshëm.’”** (Furkan, 63-64)

Thelbësore në lutje janë sinqeriteti, mirësia dhe strehimi tek mirësitë dhe begatitë e Allahut me një zemër të brishtë. Sepse begatia dhe mirësia e Allahut është pranë zemrave të brishta dhe të buta. Për një lutje frytdhënëse, duhen pastruar të gjitha organet nga papastërtitë materiale dhe shpirtërore. Përndryshe, fjalët e lutjes nuk shprehin ndonjë rëndësi në vetvete pa pastrimin trupor dhe shpirtëror së bashku. Në lidhje me këtë, tregimi i Mevlanës, që flet për mënyrën e lutjes së një çobani në kohën e Musait (a.s.), është shumë domethënëse.

Kur Musai (a.s.), po kalonte një ditë në shkretëtirë, pa një çoban, i cili i lutej Zotit. Në lutjet e tij ky çoban përdorte një fjalor shumë të thjeshtë dhe popullor dhe Zotit i qe drejtuar me këto fjalë: “O Zot, ma trego vendin ku ndodhesh, sepse dua të të shoh. O Zot, dua të të ndihmoj në çastet e vështira dhe të jem ngushëlluesi yt. O Zot, gjithë pasurinë time e flijoj për Ty dhe të gjitha këngët që ua këndoj dhenve do t’i kushtoj Ty”. Kur Musai (a.s.), i dëgjoi këto fjalë, iu afrua dhe e pyeti se me kë po bisedonte në këtë mënyrë.

Çobani iu përgjigj se ishte duke folur me Krijuesin e tij. Me Krijuesin e çdo gjëje në këtë botë. Musai e qortoi çobanin në lidhje me këtë lutje dhe i tha se lutja e tij ishte blasfemi. E urdhëroi të mbyllte gojën dhe të mos lutej ashtu, sepse ato që thoshte ishin nevoja të njeriut, si ngrënia, pija, fjetja dhe Zoti ishte larg këtyre gjërave.

“Nëse ti nuk i ndalon këto lutje blasfemike, - iu drejtua ai çobanit, - atëherë Zoti do të zemërohet dhe do ta shkatërrojë këtë botë. Dhe mos harro se ti cilësitë e njeriut po ia atribuon Zotit të Madhërishtëm, në kohën kur Zoti është shumë më i lartë dhe më i mirë.”

Musai foli shumë fjalë të këtilla me çobanin dhe e poshtëroi shumë atë. Çobanit iu thye zemra dhe u pikëllua shumë, kurse po në atë moment kërkoi falje nga Musai dhe nga pikëllimi i madh shqeu këmi-shën e tij. Nga brendësia nxori një rënkim të madh dhe mori rrugën. Si i çmendur dhe i dashuruar u

sul në drejtim të shkretëtirës dhe, duke dënesur, humbi thellë në horizontin e saj. Në këtë moment, nga ana e Zotit të Madhërishtëm, Musait (a.s.), i zbriti shpallja:

“O Musa, pse e largove robin Tim nga adhurimi dhe e bëre atë të pashpresë nga mirësia dhe mëshira Ime. Unë nuk i marr parasysh gjërat e jashtme të robit, sepse për Mua, brendësia e tij e bazuar në sinqeritet dhe dashuri është shumë më e rëndësishme, sesa pamja e tij e jashtme. O Musa, njerëzit që më kërkojnë dhe më duan Mua janë të ndjeshëm dhe zemërbutë. Sikur brenda Qabes humb kuptimi i drejtimit nga Qabja, në cilindo drejtim, ata janë të kthyer nga Unë. Për robin e dashur dhe të devotshëm nuk ekzistojnë rregulla të caktuara. Adhurimi dhe përkujtimi i tij, në çfarëdo gjuhe dhe mënyre të bëhet, është i pranueshëm tek Unë”.

Kur Musai (a.s.), i dëgjoi këto fjalë të Zotit, filloi ta kërkonte çobanin e humbur dhe pasi e gjeti, ia tregoi çdo gjë që kishte ndodhur: “Zoti i ka dëgjuar lutjet dhe fjalët e tua dhe është i kënaqur nga dashuria dhe sinqeriteti yt. Prandaj falu dhe lutu si të dëshirosh. Zemra jote është e pastër dhe ka arritur të vërtetën.”

Besimi është bindje e plotë, kurse lutja është strehim tek kjo bindje. Lutja është një kërkesë e sinqertë e besimtarit, drejtuar Allahut Fuqiplotë. Lutja është mburoja e besimtarit dhe vendstrehimi i shpirttrave të trazuar e të brengosur. Prandaj, njerëzit e urtë në përgjithësi janë personat që më së shumti bëjnë dua. Ata i luten vetëm Allahut për largimin e vuajtjeve, fatkeqësive, problemeve dhe shqetësimeve.

Kurse një grup tjetër i njerëzve të arrirë, duke e konsideruar çdo gjë që vjen prej Allahut si të mirë, e presin me kënaqësi caktimin e Allahut në të gjitha format e shfaqjes së tij. Këta, duke qenë të kënaqur me çdo lloj caktimi të Allahut, nuk luten për largimin e caktimit hyjnor të shfaqur në formë vuajtjesh dhe mundimesh, por e mirëpresin me kënaqësi atë. Siç shprehet poeti: “O Zot! Më bëj prej tyre që i presin fatkeqësitë me dashuri”.

Mosinteresimi i tyre për lutjen dhe përjetimi i kënaqësisë nga vuajtjet dhe shqetësimet që i servir caktimi hyjnor, rrjedh nga bindja e plotë ndaj ajetit kuranor: “**Sigurisht që Ne do t’ju provojmë me pak frikë dhe uri, me pak dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të të lashtave! Prandaj, përgëzoji të duruarit.**” (Bekare, 155) Por kjo rrugë është e vështirë dhe e mundimshme dhe nuk mund ta kalojnë të gjithë. Lutja nuk është thjesht artikulimi i një sërë kërkesash, por një gjest sublim, që buron nga një zemër e sinqertë dhe sy i përplotur. Si përfundim, një jetë e qetë dhe e lumtur, si në planin individual, ashtu edhe në planin shoqëror arrihet përmes një jete të mbushur me lutje.

# Infaku në Ramazan

— Shemsedin Kërësh —

Tani po përjetojmë lumturinë e arritjes së muajit Ramazan në të cilin është zbritur Kurani Fisnik, që është burim udhëzimi për të gjithë njerëzit<sup>1</sup> dhe mëshirë e myzhde<sup>2</sup> për të gjithë besimtarët.

Sa mirësi e madhe është ardhja e muajit Ramazan, të cilin Allahu Teala ua ka bërë risk robërve të Tij në një mjedis, në të cilin janë shtuar streset e depresionet dhe janë ndryshkur zemrat për shkak të mëkateve që janë bërë mënyrë jetese.

Nuk është aspak e lehtë ta përkufizosh dhe ta shpjegosh begatinë e muajit Ramazan me agjërimin që mbahet, me Kuranin që lexohet, me zekatin që jepet, me infakun, dhikrin dhe tesbihatin që bëhet, me pendimet që shpien në kthim e ndryshim, me iftaret që forcojnë vëllazërinë dhe me salatet, selamet e aminët që jehojnë në qiell. Sepse begatia dhe bereqeti i këtij muaji të madhërisëm mund të perceptohet vetëm duke e përjetuar dhe duke hyrë në këtë atmosferë.

Fakti se Kurani Fisnik, që është recetë shpëtimi për të gjithë njerëzinë në çdo aspekt, ka filluar të zbresë në këtë muaj, mjafton për të shprehur vlerën e tij. Ai që i jep kuptim këtij muaji, është vetë Kurani Fisnik. Kjo përsosmëri është edhe shkaku, që muaji i Ramazanit quhet muaji i Kuranit Fisnik.

Çdo lloj adhurimi dhe bindjeje ndaj Allahut Teala në muajin e Ramazanit, krahas obligimit të mbajtjes së agjërimit, mbart rëndësi shumë të madhe në drejtim të fitimit të sevapeve dhe shpërblimit. Në këtë material të shkurtër do përpiqemi të shtjellojmë çështjen e infakut në muajin e Ramazanit.

Infaku do të thotë nxjerrje e pasurisë dhe harxhim i saj. Në aspektin fetar, infaku ka pjesët e tij si obligim, vaxhib dhe mendub. Infaku përfshin zekatin, sadakatë e tjera, dhuratat, ndihmat që u bëhen të varfërve, mirësitë e ndryshme, ndihma ndaj familjes dhe të gjitha ibadetet që bëhen me pasuri. Në një ajet fisnik thuhet:

**“Të pyesin se çfarë të japin (në rrugë të Allahut) si lëmoshë. Thuaj: ‘Çfarëdo mirësie që të bëni, le t’u takojë prindërve, të afërmve, jetimëve, të varfërve dhe udhëtarëve. Çfarëdo të mire që të bëni, Allahu e di atë.’”<sup>3</sup>**

Infaku përfshin edhe gjërat shpirtërore, si dijen, mësimin etj. Krahas kësaj, në krye të të gjitha këtyre qëndron zekati, i cili është një nga shtyllat e Islamit.<sup>4</sup>

1. Surja el-Bekare, 185.

2. Surja Jusuf, 111; surja en-Nahl, 102; surja en-Neml, 77; surja Lukman, 3.

3. Surja el-Bekare, 215.

4. Elmallëllë, Muhammed Hamdi Jazër, *Hak Dini Kur’ân Dili*, Sta -

Infaku nuk ka kohë të caktuar. Ai mund të bëhet në çdo kohë dhe vend ku shfaqet nevoja. Me anë të tij, nevojtarëve mund t'u plotësohet nevoja ose t'u lehtësohet ajo. Në ajete të ndryshme të Kuranit Fisnik, thuhet se besimtarët bëjnë infak (japin) në rrugë të Allahut dhe se atë e japin në vendet në të cilat Ai ka urdhëruar:

***“Ata i besojnë të fshehtës, e falin namazin dhe bëjnë infak (japin) në rrugë të Allahut prej atyre që u kemi dhënë.”***<sup>5</sup>

***“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata që u dridhen zemrat kur përmendet Allahu, u shtohet besimi kur u lexohen shpalljet e Tij dhe i besojnë e i mbështeten vetëm Zotit. Ata e falin namazin dhe bëjnë infak (japin në rrugë të Allahut) prej asaj me të cilën i kemi furnizuar.”***<sup>6</sup>

Ndërsa për ata që e bëjnë infak pasurinë e tyre natën dhe ditën, thuhet: ***“Shpërblimi i atyre që e bëjnë infak pasurinë e tyre natën e ditën, fshehurazi e haptazi, është te Allahu. Për ata nuk ka as frikë dhe as pikëllim.”***<sup>7</sup>

Siç u pa edhe më sipër, infaku nuk ka afat. Kurdo që të shfaqet nevoja, menjëherë veprohet dhe pa humbur kohë ndihmohen nevojtarët natën e ditën, fshehurazi dhe haptazi. Sepse nevojat mund të lindin befasisht dhe mund të bëhet fjalë për njerëz që vazhdimisht kanë nevojë për ndihmë.

Historikisht, është vënë re se zekati, lëmoshat vullnetare dhe ndihmat, më shumë janë dedikuar dhe realizuar në muajin e Ramazanit. Shkaku i kësaj mund të jetë shpresa për të marrë më shumë shpërblime nga Allahu Teala, ngaqë ibadetet dhe zbatimet e urdhëresave që bëhen në këtë muaj kanë më shumë sevape.

Për të dhënë zekatin e pasurisë, floririt dhe gjërat e tjera për të cilat zekati është obligim, mbi to duhet të kalojë një vit kohë. Kjo pjesë kohe dikujt mund t'i rastisë në muajin Ramazan dhe dikujt mund t'i rastisë në një muaj tjetër. Çështja për të cilën duhet të kemi kujdes në lidhje me këtë temë është që, zekati të jepet në kohë dhe pa u vonuar. Sipas Islamit, nuk ka ndonjë kohë të veçantë për ndarjen e zekatit në muajin e Ramazanit. Një gjë e tillë nuk është urdhëruar dhe nuk është sugjeruar nga i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem.

Shkaku i dytë që zekati dhe infaku aplikohen më

shumë në muajin e Ramazanit, mund të shpjegohet kështu:

I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, në Ramazanin e çdo viti ia lexonte engjëllit të shpalljes, Xhebrailit, alejhi's-selam, ajetet e Kuranit që i kishin zbritur deri atë kohë. Madje, në Ramazanin e vitit kur ndërroi jetë, kjo gjë ndodhi dy herë.

Transmetohet se i Dërguari i Allahut, alejhi's-salatu ve's-selam, përgjatë kësaj kohe ishte bujar si erërat shpërndarëse dhe bënte infak çfarëdo që të kishte. Ibn Abbasi (r.a.), tregon në lidhje me këtë çështje:

“I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ishte njeriu më bujar. Ndërsa në muajin e Ramazanit bujaria e tij arrinte kulmin. Xhebraili, alejhi's-selam, çdo vit takohej me Profetin (a.s.), në Ramazan dhe kjo zgjaste deri në fundin e këtij muaji. I Dërguari i Allahut, alejhi's-salatu ve's-selam, ia lexonte Kuranin atij. Kur i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, takohej me Xhebrailin, alejhi's-selam, në çështjen e mirësisë, ishte më bujar se erërat shpërndarëse.”<sup>8</sup>

Besimtarët janë më bujarët, garojnë me njëri-tjetrin dhe janë më entuziastët në dhënien e infakut përgjatë muajit të Ramazanit.

Kjo ndodh për shkak të bujarisë që i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka shfaqur në këtë muaj të bekuar. Sepse, përpjekja e besimtarëve sipas mundësisë së tyre për të marrë kënaqësi të thella nga muaji i Ramazanit, fillimi i të cilit është mëshirë, mes i është falje, kurse fundi çlirim nga zjarri i xhehnemit, është e natyrshme dhe detyrë e tyre. Askush nuk ka të drejtë ta hetojë, hulumtojë apo ta kritikojë këtë. Por ne duhet të shohim edhe anën tjetër të çështjes.

Për nevojtarët duhet të kujtohem edhe jashtë Ramazanit, duhet t'u plotësohen atyre nevojat dhe duhet të vazhdohen aktivitetet e infakut. Sepse nevojat shfaqen vazhdimisht. Njeriu vazhdimisht mund të ketë nevojë për ndihmë dhe mbështetje. Përderisa njeriu të jetojë, infaku do të vazhdojë dhe zekati, dhuratat e sadakatë do të jepen. Nuk duhet harruar kurrë se është i pasuri ai që ka më shumë nevojë të japë se sa ka nevojtarit të marrë, plotësimi i nevojave të nevojtarit është porta më e sigurt e xhenetit. Kështu ne themi, se çdo i pasur është nevojtar i çdo nevojtar...

boll, 1971, I, 192.

5. Sureja el-Bakara, 2/3.

6. Sureja el-Enfal, 8/2-3.

7. Sureja el-Bakara, 2/274.

8. Buhari, Bed'ul'-Vahj, 5, Suam, 7; Muslim, Fedail, 48; Tirmidhi, Xhihad, 15; Nesai, Sijam, 2; Ibn Maxhe, Xhihad, 9.

# Fjala dhe dëgjimi

— Osman Sëkëxhë —

Kohët moderne janë kohët, ku “sundimi” i takon shifrës dhe jo kuptimit. Janë kohët ku fizika sundon mbi metafizikën. Për këtë arsye, gjuha dhe sytë e zemrës janë lënë pas dore duke ua lënë përparësinë gjuhës së sjelljes dhe syve të mendjes. Qëllimi nuk është të zmadhohet zemra, por stomaku. Vetëm ato gjëra, që sytë e mendjes i konsiderojnë gjëra të mëdha, meritojnë interesimin e njerëzve. Çdo gjë ndërtohet mbi atë që syri e quan të madhe dhe jo mbi atë që zemra e quan të tillë. Më parë, faltoret bëheshin gjigante, ndërsa sot janë apartamentet dhe qendrat tregtare që bëhen të mëdha. Madje i quajnë edhe qiellgërvishtës, si shenjë mburrjeje ndaj Zotit të vërtetë të qiellit. Me pak fjalë, njeriu modern sikur thotë për ditë: “Kur flas unë, të tjerët duhet të më dëgjojnë, se çdo gjë është e imja.” A thua se botën e ka grabitur prej Zotëruesit të vërtetë të tokës dhe të qiejve. Vetëm se e Vërteta flet dhe buçet, do apo nuk do njeriu, e Zoti bën atë çka dëshiron, duke e lënë njeriun nën gërmadhat e prepotencës së tij.

Çdo gjë flet me gjuhën e Hakut (të Vërtetit), dhe nuk flet gjëra të kota dhe pa kuptim, siç mund të ndodhë të flasë njeriu. Njeriu mund të gënjejë, të fyejë dhe të shpifë... Sorrat nuk gënjejnë, milingonat nuk përgojnë, bimët nuk shpifin... Atëherë, çdo krijesë, me përjashtim të njeriut, thotë të vërtetën. Edhe njeriu është ftuar të flasë të vërtetën, por më parë duhet t’ia vërë veshin të Vërtetës Absolute. Kur i thuhet të meditojë, në të vërtetë prej tij kërkohet të

dëgjojë gjuhën e krijesave përreth tij. Njeriu mund të dëgjojë me veshë, por më shumë do ta kuptojë këtë gjuhë me veshët e zemrës. Pra, meditimi është në një kuptim zemra që flet.

Njeriu duhet të dëgjojë. Ai duhet të dëgjojë, që të gjejë rehatinë. Pra, fjalët që duhet të dëgjojë njeriu, duhet të jenë të tilla, që ai të gjejë paqen dhe të marrë frymë i lehtësuar nga ato që dëgjon. Por kë duhet të dëgjojë njeriu dhe pse duhet ta dëgjojë atë? Kjo pyetje është e rëndësishme. Njeriu dëgjon atë gjë që e konsideron me vlerë. Ai dëgjon atë që dëshiron të bëjë. Atëherë ai duhet të dëgjojë atë që i jep vlerë njeriut dhe të cilit i ka borxh ekzistencën.

Njeriu duhet të dëgjojë para së gjithash fjalën e madhe. Ai duhet të dëgjojë fjalën e më të Madhit dhe të Atij që flet i Pari. Pra, fjalën e Allahut. Ai foli fjalën më të madhe, kur tha: **“Bëhu!”** Dhe çdo gjë u krijua me këtë Fjalë. Prandaj edhe njeriu ka nevojë për fjalën **“Bëhu!”** të Allahut. Në mënyrë që të ekzistojë, duhet që para së gjithash ta dëgjojë fjalën e të Gjithëdijshmit. Në bashkëbisedimin e parë mes nesh dhe Allahut ne thamë fjalën **“Po”**. Pra kemi një pohim që kemi bërë në lidhje me borxhin që kemi për të shlyer. Të qenët rob i Zotit arrihet duke përmbushur siç duhet këtë pohim që kemi bërë, sepse fjala më e madhe është fjala që i jepet më të Madhit. **Ata e mbajnë fjalën që i kanë dhënë Allahut dhe nuk e shkelin atë.** (Rad, 20.)

Ai që nuk e mban fjalën, është gati të tradhtojë në çdo situatë. Madje shkon deri aty, sa të mohojë edhe vetveten. Pra, tradhtia ndaj fjalës, në një kuptim do të thotë tradhti ndaj vetvetes, pasi ishte fjala **“Bëhu!”**, që të solli në ekzistencë. Po të mos kishte thënë Krijuesi **“Bëhu!”**, ti nuk do të kishe dalë në skenën e krijesave. Atëherë, të pasosh një fjalë, do të thotë *të ekzistosh*. Ata që duan të ekzistojnë, e mbajnë fjalën.

Zoti foli me njeriun në *elest bezmi*<sup>1</sup> dhe pas këtij bashkëbisedimi, njeriu u krijua me mish dhe me kocka. Zoti e pyeti njeriun rreth emrave të sendeve dhe pastaj e vendosi atë në xhenet. Pastaj ngjau ajo që ngjau. Nisi udhëtimi në vendin e provës, që quhet ndryshe dynja. Zoti foli sërish me njeriun nëpërmjet të dërguarve që zgjidhte nga mesi i njerëzve. Ai i foli njeriut edhe nëpërmjet shenjave të tjera, nëpërmjet bletës, vesës, reve, flokëve të borës... pra Zoti bashkëbisedon me ne në çdo moment. Mjafton që njeriu t'ua vërë veshin shenjave të Zotit dhe t'i dëgjojë ato pa bërë zë. Zoti ynë na urdhëron të dëgjojmë dhe të heshtim kur Ai flet, sepse vetëm ata që dëgjojnë dhe nuk bëjnë zë, kanë për t'u mëshiruar prej Zotit. **“Kur të lexohet Kurani, dëgjojeni dhe ndërprisni çdo bisedë! Vetëm kështu mund të fitoni mëshirën e Zotit!”** (Araf, 204.) Siç shihet, më parë njeriu ftohet të dëgjojë dhe më pas të heshtë, sepse vetëm ata që dëshirojnë të dëgjojnë për të mësuar diçka, nuk flasin. Njeriu nuk mundet që, në të njëjtën kohë edhe të dëgjojë edhe të flasë. Nëse ai e bën këtë gjë, atëherë nuk bën tjetër përveç se bie në kundërshtim me vetveten. Të mos harrojmë se edhe mushrikët flisnin dhe bënin zhurmë, sepse nuk dëshironin të dëgjonin fjalët e Profetit.

Edhe njeriu modern bën shumë zhurmë, sepse beson në hegemoninë dhe pushtetin e zhurmës. Ai përpiqet të qëndrojë larg fjalës së Zotit në shtëpi, në shkollë, në treg..., duke thënë fjalë pas fjale. Ai pandeh se gënjeshtria do të konsiderohet e vërtetë, sa më shumë zhurmë të krijohet rreth saj dhe mendon se do të arrijë hegemoninë e zhurmës që krijon. Porse “e gabuara nuk bëhet e saktë” me forcë. *“Ajo që e bën fjalën të fortë dhe të saktë, nuk është fakti se sa i lartë është zëri, por cilësia e saj.”* E vërteta nuk zhduket dhe nuk humbet për shkak të mospërfilljes së saj. Mosmbajtja e fjalës së dhënë nuk është në dëm të fjalës, por të njeriut që e ka dhënë atë fjalë. Njeriu i edukuar në mësonjëtoaren e sekularizmit nuk ka braktisur vetëm të ardhmen duke braktisur fjalën, por ka braktisur edhe të kaluarën.

Njeriu mund të veshë çdo lloj petku. Kur ballafaqohemi me njerëz të ndryshëm në një dhomë të mbushur me njerëz, ne nuk e dimë se me kë kemi të bëjmë. Ata mund të jenë evlija, katilë apo qafirë. Vetëm **“Fjala”** e vesh njeriun me petkun e njerzillëkut përpara Zotit të tij. Fjala e Zotit i jep njeriut vendin që meriton dhe i takon në Ahiret. Prandaj, braktisja e fjalës të shpie në fundosje brenda baltovinës së *“esfeli safilin”*<sup>2</sup>. Mysliman është njeriu që i vlerëson fjalët e Zotit të tij kur gjendet në shtëpi, në arë, në fshat, në qytet..., mysliman është njeriu tek i cili **“fjala”** gjen përjetimin e saj. A nuk është Fjala e Allahut ajo që e ka bërë njeriun mëkëmbësin e Zotit në tokë?

Njeriu është një udhëtar mes dy xheneteve. Qëllimi është të shkohet tek ndërprerja e këtyre dy skajeve. **“Siratul mustekim”**, në fakt është një urë mes këtyre dy xheneteve. Problemi për njeriun është nëse ai do të arrijë ta përfundojë në xhenet udhëtimin e tij, që ka filluar prej xhenetit, sepse në këtë udhëtim njeriu do të ndeshet me një sërë rrugicash të shtrembëra që i mbulon hija e dynjasë, fundi i të cilave është xhehenemi në vend të xhenetit. Zoti na bëftë nga ata që e mbajnë fjalën dhe ecin në rrugën e drejtë!

Amin!

1. Bota ku Zoti i pyeti njerëzit: A nuk jam Unë Zoti juaj?

2. Në gjendjen më të ulët.



“I lavdëruar qoftë Ai që e mbarti robin e Tij (Muhamedin) natën nga Xhamia e Shenjtë (në Mekë) në Xhaminë e Largët (të Jeruzalemit), rrethinën e së cilës e kemi bekuar, për t’i treguar atij disa nga mrekullitë Tona. Ai, me të vërtetë, dëgjon çdo gjë dhe sheh çdo gjë.”

(Isra, 1)

Sexhdja, është një shprehje e respektit dhe nderimit që prej krijimit të njeriut të parë.<sup>1</sup> Ndërsa vendet ku kryhen sexhdet dhe madhërimet, quhen mesxhide (shumësi mesaxhid). Një fjalë tjetër që përdoret për këto vende, është “faltore”, që do të thotë vend ku kryhen adhurime. Në Kuranin Fisnik janë përmendur vendadhurimet e tri feve qiellore dhe është theksuar qartë se ato duhen respektuar dhe mbrojtur: “...**Sikur Allahu të mos u kishte dhënë njerëzve mundësinë për t’u mbrojtur nga njëri-tjetri, do të shkatërroheshin manastiret, kishat, sinagogat dhe xhamitë, në të cilat përmendet shumë emri i Allahut...**” (Haxh, 40)

Mirëpo, qoftë në Kuran, e qoftë në fjalët e Profetit tonë (a.s.), midis gjithë vendadhurimeve, tre prej tyre u është dhënë një rëndësi e veçantë. Këto janë, Mesxhidi Haram (Qabeja), Mesxhidi Aksa (Bejti-i Makdis) dhe Mesxhidi Nebeui (Xhamia e Profetit).

Dihet se Qaben e ka ndërtuar Ibrahim (a.s.) me të birin Ismailin (a.s.), Bejti Makdisin e ka ndërtuar Sulejmani (a.s.), ndërsa në Mesxhidin Nebeui, ka punuar personalisht edhe Profeti ynë (a.s.). Për rrjedhojë, që të tre këto mesxhide janë një trashëgimi profetike. Në një hadith, Profeti ynë (a.s.), ka thënë: “Udhëtimi (pelegrinazhi) bëhet vetëm në tre mesxhide. Në Mesxhidin tim, në Mesxhidin Haram dhe në Mesxhidin Aksa.” (Muslim, Kitabu’l- Haxh, 15/415, 511, 512.)

Në periudhën e injorancës, disa persona udhëtonin për të vizituar vendet që i konsideronin të shenjta, për t’i respektuar dhe nderuar, duke shpresuar begati dhe mirësi prej atyre vendeve. Në periudhën pas ardhjes së Islamit, kishte njëfarë ngatërrese në lidhje me disa vende që feja u jepte vlerë dhe kuptim simbolik. Ja pra, edhe ky hadith është thënë për ata persona që përveç këtyre tre mesxhideve shkonin

edhe në vende të tjera për t’i vizituar dhe për të falur namaz me këto ndjenja.<sup>2</sup>

Mesxhidi Aksa, është emri i xhamisë që gjendet në Kuds, e cila njihet edhe me ermin Bejti’l-Makdis dhe që është mesxhidi i dytë i ndërtuar mbi tokë.<sup>3</sup> Ky vend që sot njihet si Mesxhidi Aksa, është një kompleks i madh, brenda të cilit ndodhet tempulli i Sulejmanit, ndërtimi i të cilit u fillua prej Daudit (a.s.) dhe u përfundua nga i biri, Suljemani (a.s.). Ky mesxhid, që është përmendur edhe në Kuran, për shkak se atë kohë ishte një muaj larg prej zonës së Hixhazit, është cilësuar me emrin “Aksa”, që do të thotë “i largët”.

Mesxhidi Aksa dhe zona ku ndodhet ai përmendet në disa ajete të Kurani Fisnik. Për shembull, në një ajet ku flitet për Ibrahimin (a.s.) dhe nipin e tij Lutin (a.s.), thuhet: “**Ne e shpëtuam atë dhe Lutin (dhe i çuam) në tokën, të cilën e kemi bekuar për njerëzit.**” (Enbija, 71) Ky vend i bekuar për të cilin bëhet fjalë në Kuran, është zona e Palestinës dhe Damaskut ku ndodhet edhe Kuds. Ndërsa në një ajet tjetër, Musai (a.s.), i drejtohet popullit duke u thënë: “**O populli im! Hyni në Tokën e shenjtë që Allahu e ka caktuar për ju dhe mos u ktheni prapa, se atëherë do të ktheheni të humbur!**”<sup>4</sup>. Toka e shenjtë, “el- arda’l-mukaddes”, që përmendet në këtë ajet, sipas shpjegimeve të komentuesve të Kuranit, është po kjo zonë midis Palestinës dhe Damaskut. Më vonë në këtë tempull, ka jetuar edhe Zekerijai (a.s.) dhe djali i tij Jahjai (a.s.). Edhe Merjemja, nëna e Isait (a.s.), këtu e ka kaluar fëmijërinë e saj. Lidhur me këtë, në Kuran thuhet: “**Zoti e pranoi atë me kënaqësi, e bëri që të rritet mirë, duke e lënë nën kujdestarinë e**

2. shih. Abadi Ebu’t-Tajjib, Avnu’l-Ma’búd, Daru’l-Kutubu’l-Ilmijje, Beyrut, VI. 12; Sahih-i Buhari Texhrid-i Sarih Tercemesi ve Sherhi, Ankara, 1976, IV, 168.

3. shih. Buhari, Enbija, 40.

4. Maide, 21.

1. shih. Bekare, 34.

**Zekerijait. Sa herë që hynte Zekerijai në dhomën e saj, gjente pranë saj ushqim dhe e pyeste: “O Merjeme! Nga të vjen ky ushqim?” Ajo përgjigjej: “Ky është nga Allahu, se Allahu e furnizon kë të dojë, pa kufi”.**” (Al-i Imran, 37) Në këtë ajet përdoret fjala “mihrab”, e cila ishte një pjesë e vogël si dhomë brenda kompleksit të Mesxhidit Aksa që përdorej për adhurim ose nevoja të tjera. Nga ky ajet, kuptohet se ky ka qenë një vend ku shkonte shpesh Zekerijai (a.s.), i cili merrej me edukimin e Merjemes. Po në të njëjtin vend, Zekerija (a.s.), iu lut Allahut t’i japë një fëmijë, duke iu drejtuar me këto fjalë: **“...Zoti im! Dhuroni nga ana Jote një pasardhës të mirë! Se Ti, me të vërtetë, je Dëgjues i lutjes!”** (Al-i Imran, 38.) Më pas, Zekerijait i vjen përgjigja e lutjes: **“E ndërsa lutej në këmbë, në faltore, melekët e thirrën (Zekerijain): “Allahu të jep lajmin e mirë për Jahjain, i cili do të vërtetojë Fjalën e Allahut (Isain a.s.), do të jetë një fisnik, i dëlirë dhe profet, një prej të mirëve”.**” (Al-i Imran, 39)

Siç kuptohet edhe nga ajetet e mësipërme, kibla e parë e besimtarëve, Mesxhidi Aksa, është përkujtuar me respekt dhe nder. Madje, Profeti ynë (a.s.), në një hadith, ka thënë se namazet e falura në këtë mesxhid, janë më të çmuar se namazet e falur në mesxhide të tjerë: **“... Një namaz i falur në Mesxhidin Aksa, ka një mijë herë më shumë shpërblime se namazet e falur në mesxhidet e tjera (përveç Mesxhidit Haram dhe Mesxhidit Nebeui)...”** (Ibn Maxhe, Ikametu’s-Salah, 196.)

Mesxhidi Aksa ka qenë vendi i shumë profetëve, ai është kibla e hebrejve dhe të krishterëve dhe, për njëfarë periudhe ka qenë edhe kibla e myslimanëve. Pra, ai është një vend i shenjtë për pjesëtarët e tri feve. Përveç këtyre, ai është edhe vendi ku Profeti ynë (a.s.), është takuar me të gjithë profetët e tjerë në udhëtimin e Isras dhe Miraxhit.

Gjatë historisë, Kudsi ka ndërruar disa herë

qeverisje. Megjithëse ka përjetuar një periudhë të gjatë kur myslimanët kujdeseshin për të, sot, ai është i privuar nga vlera e vërtetë që ka dhe nuk ndodhet nën administrimin që meriton. Madje, ai po përjeton periudhën e skllavërisë dhe robërisë. Kjo pjesë e jona e vuajtur dhe e hidhëruar, që përmban në historinë dhe rrënjët e saj gjurmë të thella për ne besimtarët, pret më shumë interesim dhe kujdes prej pjesëtarëve të fesë së fundit.

Në një hadith të Profetit (a.s.), thuhet: **“Shkoni në Bejt-i Makdis! Nëse nuk mund të shkoni e të falni namaz në të, atëherë dërgoni vaj ulliri për të ndezur kandilat e saj.”** (Ebu Daud, Kitabu’s-Salat, 14.) Ky është një mesazh shumë i rëndësishëm i cili është thënë që në kohën kur ato vende ende nuk ishin çliruar. Ky vend i shenjtë ku gjenden kujtimet e shumë profetëve që përmenden në Kuran dhe ku mendohet se gjenden të varrosur profetët e mëdhenj si Ibrahim (a.s.) me familjen e vet, Zekerija (a.s.) dhe Daudi (a.s.), pret më shumë interes dhe kujdes prej nesh.

Shkrimin tonë po e përfundojmë me transmetimin e një hadithi të Profetit tonë (a.s.), në lidhje me Mesxhidin Aksa, që i atribuohet Sulejmanit (a.s.): **“Kur Sulejmani (a.s.), e mbaroi ndërtimin e Mesxhidit Aksas, bëri një dua ku kërkoi tri gjëra prej Allahut: Aftësinë për të gjykuar në përputhje me gjykimin e Allahut. Një sundim dhe pasuri që nuk i është dhënë askujt para tij dhe nuk do t’i jepet askujt pas tij. Të gjithë ata që do të hyjnë në atë mesxhidin që ka ndërtuar, me qëllim që të kryejë adhurime, të dalin prej tij të pastruar prej gjynaheve siç kanë lindur prej nënës...”** Më pas, Profeti (a.s.), shton: **“Dy dëshirat e para të Sulejmanit (a.s.), janë plotësuar. Shpresojmë që edhe dëshira e tretë t’i jetë plotësuar.”** (Ibn Maxhe, Ikame, 196; Ahmed, Musned, II, 176.)



Ebu Hurejre (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Udhëtimi (me qëllim adhurimi) mund të bëhet vetëm për të shkuar në tre mesxhide. Këto janë ky Mesxhidi im (Mesxhidi Nebevi), Mesxhidi Haram dhe Mesxhidi Aksa.” (Muslim, Haxh, 511)

Forma më e bukur e takimit të robit me Zotin e vet në këtë botë, është namazi. Dhe çasti kur robi është më afër Zotit të vet në këtë takim, është sexhdja.<sup>1</sup> Çdo pjesë e namazit ka kuptimin e vetë të veçantë, por pjesa që e shpreh më bukur devotshmërinë ndaj Allahut, dorëzimin dhe përlulesinë ndaj Tij, është sexhdja. Ndërsa emri i vendit që është caktuar për këtë çast takimi të veçantë, është “mesxhid”, që rrjedh nga emri sexhde.

Mesxhidet janë simbolet më të rëndësishme të Islamit. Ato kanë luajtur rol të rëndësishëm gjatë gjithë historisë, qoftë në adhurimet e myslimanëve, qoftë në jetën e tyre shoqërore. Puna e parë që bëri Profeti (a.s.), pasi emigroi në Medinë, ka qenë ndërtimi i një mesxhidi. Për këtë arsye, ai thotë se mesxhidet janë vendet më të çmuara tek Zoti<sup>2</sup> dhe janë shtëpitë e Allahut.<sup>3</sup>

Në Kuran urdhërohet: **“Mesxhidet e Allahut i vizitojnë dhe i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, që falin namazin dhe japin zekatin e që nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut...”** (Teube, 18.) Në këtë ajet fisnik, besimtarët motivohen të marrin përsipër ndërtimin dhe mirëmbajtjen e mesxhideve, qoftë në aspektin material duke i ndërtuar, qoftë në aspektin shpirtëror, duke i frekuentuar shpesh ato.

Secili prej mesxhideve ku besimtarët vendosin ballin në sexhde dhe u falin atyre vetëdijen e bashkimit dhe unitetit janë shumë të rëndësishëm. Mirëpo, i

Dërguari i Allahut i fton myslimanët të jenë më të vetëdijshëm ndaj këtyre tri mesxhideve.

“Udhëtimi (me qëllim adhurimi) mund të bëhet vetëm për të shkuar në tri mesxhide. Këto janë ky Mesxhidi im (Mesxhidi Nebeui), Mesxhidi Haram dhe Mesxhidi Aksa.” (Muslim, Haxh, 511.)

Mesxhidi Nebeui, guri i themelit të të cilit është vendosur nga vetë Profeti (a.s.), është një vend shumë i veçantë, që e ka kthyer Jethribin në Medinë dhe e ka takuar atë me qytetërimin. Ky mesxhid që është ngritur mbi devotshmërinë<sup>4</sup>, i ka shërbyer myslimanëve që ditën e parë të tij si një qendër diturie dhe kulture në mes të Medinës. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka bërë të ditur se namazi i falur në Mesxhdin e tij, është më i vlefshëm se njëmijë namaze të falur në cilindo mesxhid tjetër, përveç Mesxhidit Haram (Qabes).<sup>5</sup>

Për këtë arsye, besimtarët garojnë me njëri-tjetrin për të falur namaz në hapësirën midis minberit dhe shtëpisë së tij, të cilën ai e ka cilësuar si “një kopsht prej kopshteve të xhenetit”<sup>6</sup>. Përveç kësaj, udhëtimi që bëhet për në Mesxhidin Nebeui dhe vizita e varrit të Profetit (a.s.), është një mënyrë ngushëllimi për brezat e mëvonshëm që nuk e kanë parë atë.

Mesxhidi më i vjetër që njihet mbi tokë<sup>7</sup>, është Mesxhidi Haram (Qabeja), që është edhe kibla e myslimanëve. Prej shekujsh ky është edhe mesxhidi më i mirë që vizitohet nga besimtarët me një interes që sa

4. shih. Teube, 108.

5. shih. Tirmidhi, Salat, 126.

6. shih. Muuatta, Kible, 5.


7. shih. Al-i Imran, 96.

1. shih. Muslim, Salat, 215.

2. shih. Muslim, Mesaxhid, 288.

3. shih. Muslim, Mesaxhid, 282.





vjen dhe shtohet. Vizita e tij për të kryer adhurimin e detyrueshëm të Haxhit nga ana e besimtarëve që kanë mundësi udhëtimi, është një e drejtë e Allahut të Madhëruar mbi besimtarët.<sup>8</sup> Ndërsa pengimi nga vizita e këtij mesxhidi, është e ndaluar/haram.<sup>9</sup>

Tradita e vizitës së Mesxhidi Haram, të cilin Allahu e ka bërë një vend të sigurt dhe të nderuar, është trashëgimia më e bukur që u ka mbetur brezave të mëvonshëm prej Ibrahimit (a.s.), i cili e ndërtoi këtë mesxhid së bashku me djalin e tij Ismailin (a.s.). Prej shekujsh me radhë, myslimanët tregojnë përpjekjet e tyre për t'u bërë robër të merituar të Allahut, duke u munduar të përfitojnë prej frymëzimit shpirtëror të Mesxhidi Haramit në çdo orë të ditës dhe të natës. Besimtarët prej çdo race, gjuhe dhe ngjyre, të cilët vijnë nga çdo vend i botës për të kryer adhurimin e haxhit, përjetojnë së bashku emocionet dhe lumturinë e devotshmërisë ndaj Allahut.

Mesxhidi i fundit që Profeti (a.s.), ka porositur të vizitohet, është Mesxhidi Aksa, Bejtu'l Makdis. Ky mesxhid është një trashëgimi e shenjtë që ka mbetur prej Sulejmanit (a.s.) dhe kibla e parë e myslimanëve.

Para se të ngrihej në Miraxh, Profeti ynë (a.s.), është sjellë në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit, në Mesxhidin Aksa, rrethina e së cilës është e bekuar.<sup>10</sup> Aty u ka prirë në namaz profetëve të mëparshëm, mes të cilëve gjendeshin edhe Ibrahim, Musai dhe Isai (alejhimu's-selam).<sup>11</sup>

8. shih. Bekare, 203.

9. shih. Bekare, 217.

10. shih. Isra, 1.

11. shih. Muslim, Iman, 259.

Mesxhidi Aksa, i cili ka qenë kibla e popujve të mëhershëm dhe që në kulturën Islame ka një pozitë të lartë, sot është pothuajse e braktisur nga myslimanët. Ky është një amanet i shenjtë, në të cilin në kohën e Omerit (r.a.), Salahuddin Ejjubit dhe Osmanëve adhurimet kryheshin në paqe dhe vizitohej prej të gjithë atyre që shkonin në haxh dhe në umre. Por për fat të keq, sot askush nuk po i del zot këtij amaneti i cili ka mbetur larg vlerësimit që meriton.

Lotët që njëherë e një kohë derdreshin në namazet që faleshin me përkushtim brenda tij, sot po derdhen prej dhimbjes dhe hidhërimit që po shkaktojnë dhuna dhe shtypja e vazhdueshme e pushtuesve. Mesxhidi Nebeui, Mesxhidi Haram dhe Mesxhidi Aksa, janë tre amanete të çmuara të ndërtuara prej duarve të profetëve dhe që na kanë mbetur neve trashëgim. Vetëdija ndaj privilegjit që gëzojnë këto vende të veçanta që janë mesxhidet më të shenjta të Islamit dhe mirëmbajtja e tyre në çdo aspekt, qoftë material, qoftë shpirtëror, është përgjegjësia e të gjithëve neve si myslimanë.

Profeti (a.s.), i cili ka thënë se namazet me xhemat që falen në mesxhide janë më të vlefshëm se namazet e falura vetëm në shtëpi<sup>12</sup>, ka thënë edhe se namazet e falura në Mesxhidin Nebeui, Mesxhidin Haram dhe Mesxhidin Aksa, janë edhe më të vlefshëm se sa namazet e falura në shtëpi apo në cilindo mesxhid tjetër të botës.<sup>13</sup> Nisur nga kjo, lutemi që çdo mysliman të ketë fatin e vizitës dhe kryerjes së adhurimeve në këto vende të shenjta dhe të arrijnë shpërblimet e mëdha prej Allahut të Madhëruar.

12. shih. Buhari, Ezan, 30; Muslim, Mesaxhid, 249.

13. shih. Ibn Maxhe, Ikametu's-salavat, 198.



# NJË RAMAZAN SA PËR TË GJITHË JETËN

Falënderimet e pafundme i takojnë Allahut të Madhëruar, që na e zbukuroi përsëri kalendarin e jetës, neve robërve të Tij të dobët, me Ramazanin e Bekuar, në të cilin shpërthen falja dhe mëshira hyjnore. Ai Ramazan i Bekuar brenda të cilit gjendet thesari shpirtëror i Natës së Kadrit, e cila ka vlerën e një jete të tërë...

Mirëpo, pjesën më të madhe të ditëve dhe netëve të këtij muaji të çmuar e lamë pas. Tashmë, na ka mbetur veçse pak kohë. Lum ata besimtarë që në këto ditë të bekuara përpiqen:

- Të falin namazet me një kujdes më të veçantë me xhemat dhe me përkushtim të thellë,
- Të marrin pjesë në leximet e përbashkëta të Kur'anit me frymëzim shpirtëror,
- Të ngrihen shpirtërisht me agjërim dhe të arrijnë devotshmërinë,
- Të fitojnë përshpirshmërinë e muzgut të mëngjesit me syfyr,
- Të afrohen me Allahun me anë të zekatit, sadakasë së fitrit dhe dhurimeve,
- Dhe në fund të dalin të pastruar shpirtërisht nga ky muaj i faljes!

Sado që të falënderojmë Zotin tonë, i Cili na fali këtë muaj të bekuar, është shumë pak!..

Allahu i Madhëruar urdhëron:

**“...Nëse tregoheni mirënjohës, Unë do t’jua shtoj edhe më shumë begatitë e Mia!..”** (Ibrahim, 7.) Duke u nisur nga ky ajet fisnik, falënderimi/mirënjohja bëhet shkak i begatimit të mirësive. Për rrjedhojë, për të arritur edhe begatinë e mirësisë së Ramazanit, nuk duhet të neglizhojmë asnjë lloj falënderimi, qoftë me fjalë, e qoftë me vepra.

Për këtë arsye, vlerat shpirtërore që fitojmë në atmosferën frymëzuese të Ramazanit të bekuar dhe që na edukojnë shpirtat, nuk duhet t’i humbasim pas Ramazanit. Nëse arrijmë që ato që kemi fituar

prej Ramazanit t’i shpërndajmë në jetën tonë për gjatë gjithë vitit, kjo do të jetë shprehja më e bukur e falënderimit ndaj Zotit tonë.

## DEVOTSHMËRI DERI NË FRYMËN E FUNDIT

Të mos harrojmë se, jeta Islame, fetaria dhe devotshmëria, nuk janë të posaçme vetëm për muajin e Ramazanit apo për një sezon të përkohshëm. Këto, janë vlera jashtëzakonisht jetike, të cilat një besimtar duhet t’i mbaj mbi krye gjatë gjithë jetës.

Allahu i Madhëruar, na urdhëron që ta adhurojmë Atë jo vetëm në Ramazan, por gjatë gjithë jetës. Në ajetin fisnik urdhërohet:

**“Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!”** (Hixhr, 99.)

Vendimi hyjnor në lidhje me njeriun, merr për bazë frymën e fundit. Dhe, për ta dhënë frymën e fundit me besim, është e domosdoshme që gjithë jetën tonë të jetojmë me një pjekuri shpirtërore të tillë, që të jemi përherë midis frikës, që të mos meritojmë zemërimin hyjnor dhe shpresës për të fituar mëshirën hyjnore.

Zoti ynë urdhëron:

**“O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!”** (Al-i Imran, 102.)

Për të arritur të japim frymën si mysliman, nuk ka zgjidhje tjetër përveçse të vazhdojmë adhurimin ndaj Allahut pa u kapluar për asnjë çast nga indiferenca dhe vesveset e egos. Lidhur me këtë, me qëllim që të na bëhet shembull, i Dërguari i Allahut (a.s.), e ka lutur Allahun e Madhëruar me këto fjalë:

**“O Zot! Mos më lërë në dorë të vetes sime, qoftë edhe sa hap e mbyll sytë!”** (Sujuti, Xhamiu’s-Sagîr, v. I, fq. 58.)



Allahu i Madhëruar, ashtu siç e ka fshehur Natën e Kadrit brenda një viti, ashtu e ka fshehur në kohë edhe se kur do ta shfaqë kënaqësisë apo zemërimin e Tij. Me këtë, Ai ka dashur që ne të përpiqemi gjithmonë për punë të mira dhe të ruhemi nga gjynahet. Kjo, sepse ka momente që mund të bëhen shkak i fitimeve të mëdha, por ka edhe momente që bëhen shkak për humbje të mëdha.

Për këtë arsye, Islami ka rregulluar çdo çast të jetës njerëzore. Respektimi i disa kohëve të caktuara të urdhrave fetarë dhe veprimi me indiferentizëm ndaj disa të tjerave, ose zbatimi i një pjese të urdhrave hyjnore dhe neglizhimi i disa të tjerave, e dobëson besimin. Nisur nga kjo, ne duhet të jetojmë me kujdesin dhe përpjekjen për të mos e harruar Allahun në asnjë çast të jetës. Kjo, sepse Allahu i Madhëruar, në një ajet fisnik urdhëron:

**“Mos u bëni si ata që e harruan Allahun, kështu që Ai i bëri të harronin vetveten! Pikërisht ata janë të pabindurit (ndaj Allahut).”**  
(Hashr, 19.)

Në të vërtetë, askush nuk mund t'i vërë shkopinj nën rrota vëllait duke bërë bismillah. Një njeri, zemra e të cilit thotë “Allah”, nuk mund të ngul gjemba në zemrat e të tjerëve. Ai nuk u hyn në hak atyre me vetëdije dhe nuk zhytet në gjynahe. Gjynahet kryhen atëherë kur je indiferent ndaj Allahut. Dhe, të veprosh në kundërshtim me urdhrat hyjnore, në çfarëdo çështje qoftë, do të thotë se je indiferent ndaj Allahut.

Nisur nga kjo, besnikërinë tonë ndaj fesë së Allahut duhet ta mbajmë të gjallë në çdo kohë dhe në çdo vend deri në frymën e fundit. Duke u mbështetur në parimin profetik, *“është mashtruar ai që i ka dy ditë njëlloj!”*, ne duhet të përpiqemi

të jetojmë çdo çast të jetës sonë të mbushur me dashurinë për besimin i cili shtohet çdo ditë e më tepër dhe nuk pakësohet. Në çdo çast duhet të bëjmë përpjekje në rrugën e fesë, t'i lutemi dhe t'i përgjerohej Allahut, me qëllim që të afrohej me të shumë me Të.

### ATMOSFERA E TAKIMIT

Sa bukur e shprehin horizontin e devotshmërisë së të dashuruarve me Allahun këto këshilla të Mevlanës së nderuar:

*“Merr abdes në atë mënyrë, që të mos prishet kurrë! Fal një namaz të tillë, që të mos mbarojë kurrë! Të dashuruarit nuk i mjaftojnë pesë kohë namaz. Ai dëshiron pesëqind mijë kohë. A mund të dëshirojë i dashuruari i vërtetë mbarimin e takimit!?”*

*“...Nëse tregoheni mirënjohës, Unë do t'jua shtoj edhe më shumë begatitë e Mia!..”  
(Ibrahim, 7.) Duke u nisur nga ky ajet fisnik, falënderimi/ mirënjohja bëhet shkak i begatimit të mirësive. Për rrjedhojë, për të arritur edhe begatinë e mirësisë së Ramazanit, nuk duhet të neglizhojmë asnjë lloj falënderimi, qoftë me fjalë, e qoftë me vepra.*

Adhurimet kryhen dhe plotësohen në kohë të caktuara. Mirëpo, devotshmëria është e përhershme. Besim, është lidhja e zemrës në mënyrë të përhershme me Allahun e Madhëruar. Për këtë arsye, edhe të dashuruarit me Allahun, të cilët e jetojnë besimin me dashuri/pasion, frymëzimin shpirtëror që marrin prej adhurimit, e vazhdojnë në çdo frymëmarrje. Ata nuk janë indiferentë ndaj Allahut në asnjë kohë dhe në asnjë vend. Dhe, për shkak se e ndjejnë veten gjithmonë në prezencën hyjnore, abdesi, namazi dhe e gjithë devotshmëria e tyre është e përhershme.

Treguesi i kënaqësive të egos, është shuarja e dëshirës për to kur i shijon. Ndërsa kënaqësitë shpirtërore dëshirohen edhe me më shumë pasion kur shijohen. Për shembull, një person që agjëron gjithë ditën, ngopet me pak ushqim në iftar. Edhe nëse ushqimi është i shijshëm, ai nuk ka oreks

të hajë më shumë. Mirëpo, kënaqësitë shpirtërore nuk janë të tilla. Kur ato shijohen, ia shtojnë edhe më shumë oreksin shpirtëror besimtarit, sepse në kënaqësitë shpirtërore gjendet një ëmbëlsi që s'ka fund.

Për këtë arsye, Ibrahim bin Et'hemi, i cili e la mënjanë madhështinë e kësaj bote dhe u zhyt në oqeanin e dashurisë hyjnore, ka thënë:

*“Nëse kënaqësia që ndjejmë në dashurinë hyjnore do të ishte diçka konkrete/materiale, mbretërit do të sakrifikonin të gjitha thesaret dhe mbretërinë e tyre për ta marrë prej nesh.”*

Robërit e afërt me Zotin, për shkak se tashmë arrijnë të ndjejnë flladet e kënaqësive të përhershme, në sytë e tyre ka marrë fund vlera e kënaqësive të kësaj bote. Për këtë arsye, edhe nëse janë në atë gjendje që kanë nevojë për vete, në vend që ta përdorin për vete çdo mirësi që arrijnë të gjejnë, ata ndiejnë një kënaqësi të madhe kur ia falin ato nevojtarëve të tjerë për hir të Allahut.

Kjo ishte edhe arsyeja që i Dërguari i Allahut (a.s.), nuk gjente qetësi dhe paqe pa ia ngopur barkun të uriturve të umetit dhe pa ua shuar vuatjet atyre. Kënaqësia shpirtërore që i sillte mëshira dhe dhembshuria ndaj krijesave për hir të Krijuesit, e bënte të Dërguarin e Allahut (a.s.), të harronte urinë e vet. Allahu na bëftë të mundur kënaqësi të tilla të përhershme që do t'i nënshtrojnë kënaqësitë e mirësive të përkohshme të kësaj bote!

Kjo, do të thotë se, kënaqësia shpirtërore e adhurimeve që kryhen me përkushtim të thellë, pra në atmosferën e takimit me zemër me Allahun, nuk mund të krahasohet me asnjë kënaqësi të përkohshme të kësaj bote. Të dashuruarit pas Allahut, të cilët kanë arritur të shijojnë qetësinë shpirtërore të të qenit bashkë me Allahun, nuk i lodhin asnjëherë adhurimet, bindja ndaj Allahut, sakrificat dhe shërbimet në rrugën e Tij.

Përkundrazi, ato janë kthyer në një kënaqësi dhe dëshirë me të cilat është e pamundur të ngopesh. Për këtë arsye, ata kanë dëshiruar që gjendja e takimit me Allahun të mos përfundojë kurrë.

Në të njëjtën mënyrë, edhe besimtarët që arrijnë ta kuptojnë siç duhet vlerën e Ramazanit të Bekuar duke përfutur sa më shumë prej tij, dëshirojnë që kjo atmosferë mëshire dhe rrjedha e frymëzimit shpirtëror që gjendet në të, të mos ndërpritet kurrë. Lidhur me këtë në një hadith fisnik urdhërohet:

*“Nëse robërit do t'i dinin mirësitë e Ramazanit, do të dëshironin që i gjithë viti të ishte Ramazan...”*  
(Hejthemi, v. III, fq. 141.)

Ndërsa Mualla bin Fadl, (rahmetullahi alejh), manifestimin e kësaj të vërtete tek besimtarët, e ka shprehur me këto fjalë:

*“Të parë tanë të mirë, i luteshin Allahut gjashtë muaj rresht që të arrinin Ramazanin. Ndërsa gjashtë muajt e tjerë, luteshin që Allahu t'u pranonte Ramazanin që ata përjetuan.”* (Kiuamu's-Sunne, et-Tergib ue't-Terhib, II, 354.)

## RAMAZANI, ZEMRA E VITIT

Ne nuk duhet të harrojmë se Ramazani i Bekuar, është si zemra e gjithë vitit. Prandaj, pjekuria e devotshmërisë që kemi fituar në Ramazan, nuk duhet të firojë. Përkundrazi, ne duhet të përpiqemi që Ramazani i shkuar, të na lidhë me një dashuri shpirtërore edhe më madhe me Ramazanin e ardhshëm. Padyshim se besimtari që ia arrin kësaj, do ta kalojë gjithë vitin të mbushur me frymën shpirtërore të Ramazanit.

Mirë, por çfarë duhet të bëjmë dhe çfarë duhet të kemi kujdes, që ta përjetojmë gjatë gjithë vitit frymën shpirtërore të Ramazanit të Bekuar?

Në radhë të parë, durimin dhe edukimin e egos në agjërim, duhet ta bartim gjatë gjithë kohës. Nëse e ruajmë egon/veten tonë prej grykësisë, shpërdorimit, lakmisë, zemërimit dhe të këqijave, do të arrijmë të vazhdojmë mirësitë e Ramazanit. Në



fakt, edhe konsiderimi si i pëlqyeshëm i agjërimit të gjashtë ditëve të muajit Sheuual, menjëherë pas Bajramit të Ramazanit, nga një anë ndihmon në normalizimin e trupit shkallë shkallë me rregullin e mëparshëm dhe nga ana tjetër, nxit vazhdimësinë e shpirtit të agjërimit të Ramazanit me anë të agjërimit vullnetar. Po ashtu, edhe agjërimi i ditëve në datat 13, 14 dhe 15 të çdo muaji hënor dhe ditëve të hëna dhe të enjte të çdo jave, kanë të njëjtën vlerë për ata që kanë mundësi.

Agjërimi është një trajnim durimi. Dhe durimi është i domosdoshëm për besimtarin në çdo kohë dhe në çdo vend. Durimi, duhet për të qenë i vazhdueshëm në adhurim... Për të mos u treguar i pabindur ndaj Allahut... Për t'iu kundërvënë dëshirave të egos... Për të përballuar fatkeqësitë, duke mos cenuar falënderimin në zemër, mirënjohjen dhe gjendjen e kënaqësisë... Për të mos u zhytur në indiferencë dhe për të mos shkarë këmba atëherë kur je i kamur dhe kur mundësitë për të anuar nga dëshirat e egos janë të mëdha... Për të harruar ankesën, për të mos u lëkundur besimi dhe për të mos anuar nga haramet atëherë kur je në skamje dhe kur varfëria i afrohet mohimit... Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar urdhëron: **"...Përgëzoji të duruarit!"** (Bekare, 155.)

Nga ana tjetër, dy janë gjëra që ndikojnë më shumë tek njeriu: Njëra nga këto është gjendja shpirtërore e atyre me të cilët shoqërohesh dhe tjetra është gjendja e ushqimit në aspektin e hallallit dhe haramit. Kështu që, nëse arrijmë që kujdesin të cilin e tregojmë në çështjen e ushqimit hallall në kohën e agjërimit të Ramazanit, ta tregojmë për të gjitha haramet, mekruhet dhe të dyshimtat në kohët e tjera, atëherë do të jetë e mundur të vazhdohet edhe shpirti i Ramazanit.

Ashtu siç e penguem veten prej ngrënies dhe pirjes gjatë agjërimit, edhe pas Ramazanit duhet të jemi agjërueshëm shpirtërisht ndaj të gjitha haramëve dhe gjynaheve. Ne duhet të bëjmë kujdes ndaj çdo kafshate që hynë në gojën tonë dhe çdo fjale që del

prej saj. Duhet të ruajmë gjuhën tonë veçanërisht prej gënjeshtërisë, thashethemeve, përgojimit dhe fjalëve të padobishme.

Në të njëjtën mënyrë, ashtu siç e mbyllim gojën tonë ndaj ushqimeve gjatë agjërimit, edhe zemrën tonë duhet ta mbajmë gjithmonë të mbyllur ndaj gjynahut, hipokrizisë, krekosjes, mendjemadhësisë, mosmirënjohjes, smirës dhe lakmisë. Sytë tanë duhet t'i mbajmë të mbyllur ndaj gjërave që Allahu i Madhëruar i ka caktuar si të ndaluara. Po ashtu, edhe veshët tanë duhet t'i mbajmë të mbyllura ndaj të gjitha zërave të shëmtuar dhe fjalëve të këqija të cilat dënohen nga Kur'ani dhe Suneti.

Nëse arrijmë ta zbatojmë në të gjitha mëngjeset zgjimin tonë në syfyrtë gjatë Ramazanit, pra, nëse e bëjmë zakon që ta zbukurojmë muzgun e agimit me namaz, dhikër dhe istigfar, do të arrijmë të ruajmë edhe frymën shpirtërore të Ramazanit.

Nëse do t'ia dinim vlerën çdo nate, ashtu siç e kërkojmë Natën e Kadrit në Ramazan, do të jetojmë gjatë gjithë vitit si në Ramazan.

Nëse arrijmë që vullnetin me të cilin nxitojmë për në namazet e teravive gjatë Ramazanit, ta kthejmë një traditë të vazhdueshme të faljes së namazeve me xhemat gjatë gjithë vitit, do të arrijmë ta mbajmë gjithmonë të freskët atmosferën shpirtërore të Ramazanit të Bekuar në zemrën tonë.

Nëse vazhdojmë të jetojmë në atmosferën e Kur'anit Fisnik edhe në muajt e tjerë, ashtu siç e shtojmë afërsinë tonë me të kur e lexojmë gjatë gjithë Ramazanit, do të arrijmë ta bëjmë të vazhdueshme në zemrën tonë përbërjen shpirtërore të Ramazanit.

Sadakatë dhe dhurimet, janë gjithmonë një derë e hapur për të arritur kënaqësinë e Allahut të Madhëruar. Nëse entuziazmi i zekatit, sadakasë së fitrit dhe dhurimeve të tjera që bëhen në Ramazan shfaqet edhe gjatë muajve të tjerë, nëse ruhem i egoizmit dhe koprracisë, duke dhënë bujarisht dhe duke sakrifikuar në rrugën e Allahut dhe nëse nuk i harrojmë të varfrit, por përkundrazi i shohim ata

*Agjërimi  
është një trajnim durimi.  
Dhe durimi është i  
domosdoshëm për besimtarin  
në çdo kohë dhe në çdo vend.  
Durimi, duhet për të qenë i  
vazhdueshëm në adhurim...  
Për të mos u treguar i  
pabindur ndaj Allahut... Për  
t'iu kundërvënë dëshirave  
të egos... Për të përballuar  
fatkeqësitë, duke mos cenuar  
falënderimin në zemër,  
mirënjohjen dhe gjendjen e  
kënaqësisë...*

sikur të jenë në përgjegjësinë tonë dhe e shtojmë mëshirën dhe dhembshurinë tonë ndaj tyre, do të arrijmë ta bëjmë të vazhdueshme edhe atmosferën e mëshirës së Ramazanit.

Lidhur me këtë çështje, i nderuari Musa Efendi (rahmetullahi alejh), ka thënë:

*“Biri im! Jetoni patjetër duke edukuar veten tuaj (shpirtërisht) dhe dhuroni prej atyre që ju ka dhënë Allahu, po për hir të Allahut! Edukimi juaj shpirtëror të mos jetë i kufizuar veç në tre muajt e shenjtë dhe në Ramazan! Por shpërndajeni atë në çdo pjesë të jetës suaj dhe tepriçën dhurojeni në rrugë të Allahut!..”*

Në Ramazan, shejtanët lidhen me zinxhirë dhe njeriu ngelet vetëm për vetëm me egon/veten e tij. Ndërsa pas Ramazanit, shejtanët që përpiqen ta largojnë robin nga Zoti i tij, zgjidhen përsëri. Mirëpo, nëse ne arrijmë të jemi gjithmonë vigjilent ndaj gjynaheve dhe nxitjeve të egos dhe shejtanit, atëherë do të jetë e mundur që të mos e humbasim butësinë e zemrës që kemi formuar gjatë Ramazanit. Lidhur me këtë, në një ajet fisnik urdhërohet:

**“Nëse shejtani fillon të të joshë, kërko mbështetje te Allahu. Me të vërtetë, Ai i dëgjon të gjitha dhe i di të gjitha.”** (Fussilet, 36)

Shkurtimisht, aq sa ne përpiqemi t'i bëjmë këto virtyte parime të jetës sonë, po aq do të arrijmë që ta mbajmë gjallë Ramazanin në jetën tonë në një nivel të kënaqshëm.

### TREGUESI I VEPRËS SË PRANUAR

Në një hadith fisnik urdhërohet

*“Vepra më e dashur tek Allahu i Madhëruar, është ajo që bëhet vazhdimisht, qoftë edhe e pakët.”* (Muslim, Musafirin, 218; Ahmed, VI, 61.)

Ndërsa Allahu i Madhëruar, në një ajet fisnik urdhëron:

**“Prandaj, kur të çlirohesh (nga një punë), përpiqu fort (në një punë tjetër) dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!”** (Inshirah, 7-8.) Nga kjo, kuptojmë se Allahu na urdhëron që të vazhdojmë punët e mira e të dobishme, pa bërë pushim.

Në të njëjtin kuptim, Mevlana i nderuar është shprehur:

*“Treguesi i adhurimit të pranuar, është fillimi i një adhurimi tjetër menjëherë pas tij, ose të nxitosh në vepra të mira njëra pas tjetrës.”*

Ndërsa treguesi i një veprë të papranuar, është ndjekja e saj nga punë të kota dhe të padobishme. Kurse më e keqe se kjo, është ndjekja e veprës së mirë nga një vepër e keqe, e cila e fshin dhe e zhduk atë.

Siç njoftohemi edhe në Kur'anin Fisnik, Allahu i Madhëruar na paralajmëron të mos bëhemi si ai që i fshin shpërblimet e mirësive të tij me gjynahe:

**“Mos u bëni si ajo gruaja që e shprish dhe e bën fije-fije atë që e ka tjerrë fort!..”** (Nahl, 92.)

Ja pra, ne duhet të bëjmë kujdes ndaj këtij paralajmërimi hyjnor veçanërisht në jetën tonë të adhurimeve dhe të ruhemi nga çuarja dëm e veprave tona të mira. Të biesh përsëri në gabime, gjynahe dhe indiferencë pas Ramazanit, i ngjan braktisjes së thesit të mbushur pa e lidhur atë. Çfarëdo që kemi fituar dhe kemi mbledhur, do të derdhet dhe nuk do të na mbetet asgjë tjetër përveç hidhërimit.

Për këtë arsye, Aliu (r.a.), thotë:

*“Rëndësinë që i jepni bërjes së veprave të mira, jepjani edhe më tepër pranimit dhe ruajtjes së tyre!”*

Për shembull: Të krenohesh dhe të mburresh me adhurimet që kryen, duke thënë “unë bëra kështu e ashtu!”, duke ia atribuuar vetes gjithçka, bëhet shkak i humbjes së vlerës së punëve të mira që janë bërë.

Gjithashtu, edhe kur një njeri që është ende gjallë, i vë emrin e vet një xhamie, një shkollë apo një institucioni bamirësie që ka ndërtuar, e përzien këtë mirësi me egon e vet. Mirëpo, besimi monoteist, nuk pranon ortakëri. Por, pasi ky person të ndërrojë jetë, trashëgimtarët mund t'ia vënë emrin e tij ndonjë veprë mirësie. Kjo nuk

*“Treguesi i adhurimit të pranuar, është fillimi i një adhurimi tjetër menjëherë pas tij, ose të nxitosh në vepra të mira njëra pas tjetrës.”*



përbën asnjë problem, sepse kjo synon që njerëzit e mirë që kanë shkuar, të kujtohen me mëshirë nga brezat e ardhshëm.

Pra, aq sa është e rëndësishme kryerja e adhurimeve dhe mirësive, aq është i rëndësishëm edhe kujdesi që duhet të tregohet në ruajtjen dhe pranimin e tyre.

Në përgjithësi, në Ramazan përpiqemi më shumë që të përparojmë në rrugën e afrimit me Zotin tonë duke agjëruar, duke falur namazet e teravive, duke lexuar shumë Kur'an, duke dhënë zekat, fitre dhe duke bërë bamirësi. Ndërkohë që po përjetojmë këto ditë të fundit të këtij muaji të bekuar, pyetja më e rëndësishme në zemrën tonë duhet të jetë kjo:

*“Vallë a janë pranuar tek Allahu përpjekjet tona për të gjallëruar Ramazanin?..”*

Në lidhje me këtë çështje, Mirza Maz'har Khan-i Xhanan (rahmetullahi alejh), shprehet kështu duke dëshiruar të na japë këto kritere:

*“Nëse Ramazani i Bekuar kalohet zgjuar duke bërë dhikër, kjo gjendje do të vazhdojë edhe në pjesën tjetër të vitit. Nëse në këtë muaj vërehet ndonjë mangësi ose dobësi, gjurma e saj do të shihet edhe gjatë gjithë vitit.”*

Domethënë se, atmosfera e dendur e adhurimit dhe pjekuria e veçantë e devotshmërisë që përjetohet gjatë Ramazanit, është si një farë që mbillet. Se sa do zërë kjo farë, do të shihet në muajt e tjerë të vitit.

Shkurtimisht, gjendja dhe drejtimi ynë pas Ramazanit, janë një tregues i pranimit apo jo i adhurimeve tona gjatë Ramazanit. Ruajtja e pjekurisë së devotshmërisë që kemi fituar në Ramazan, është tregues i sasisë së përfitimit që kemi arritur në këtë muaj të bekuar.

## KOHA E LLOGARISË

Pas Ramazanit të Bekuar, duhet të bëjmë një vetëllogari dhe ta kontrollojmë mirë veten. Duhet të mendojmë se:

Kaloi edhe një Ramazan tjetër prej kalendarit të jetës sonë. Çfarë na lanë këto ditë të bekuara? A mundëm ta bënim Ramazanin shkak për përmirësuar të metat dhe gabimet tona, për të shtuar virtytet tona dhe për të lartësuar moralet tona?

Prej cila gabimeve jemi penduar? Sa prej veseve të këqija kemi braktisur?

Me sa persona jemi hallalluar?

Sa të mërzitur kemi pajtuar?

Me sa prej vëllezërve tanë me të cilët jemi ftohur, jemi përqaftuar për hir të Allahut?

Sa zemra të thyera kemi ngushëlluar? Sa fytyra të vuajtura kemi bërë të buzëqeshim?

Sa prej të metave të adhurimeve tona kemi përmirësuar?

Sa shërbime dhe përpjekje kemi bërë të cilat do të na ndriçojnë errësitat e varrit, që do të na lehtësojnë llogarinë në ditën e gjykimit dhe që do të na bëjnë të fitojmë lumturinë e përjetshme?

Cilat prej mangësive tona në lidhje me përgjegjësitë ndaj familjes, fqinjëve, të afërmeve, shoqërisë dhe krijesave të tjera kemi përmirësuar? Çfarë vendimesh të dobishme kemi marrë në këtë drejtim?

Nëse kemi përjetuar ndonjë përmirësim, a ka mbetur kjo vetëm për këtë Ramazan, apo e kemi vazhduar këtë edhe pas Ramazanit?

Të mos harrojmë se mëshira hyjnore, do të realizohet për ata që i vazhdojnë virtytet e mira që kanë fituar në Ramazan, gjatë gjithë jetës së tyre. Mëshira hyjnore është në një manifestim të vazhdueshëm. E rëndësishme, është që të kërkojmë mënyrat që do të na shpien tek ajo mëshirë dhe t'i vlerësojmë siç duhet mundësitë që na jepen. Të tregohemi neglizhentë ndaj përfitimit prej ditëve dhe netëve të bekuara të Ramazanit, është një humbje e madhe.

Jemi duke përjetuar ditët e fundit të këtij Ramazani. Mirëpo, a do ta arrijmë Ramazanin tjetër!? Kjo nuk dihet! Sado e gjatë të duket, jeta kalimtare e kësaj bote është sa një muaj Ramazani në krahasim me jetën e përjetshme. Për këtë arsye, ne duhet të përpiqemi ta vlerësojmë atë në mënyrë që arrijmë faljen hyjnore.

Ne duhet të shpërndajmë në të gjithë jetën tonë entuziazmin e adhurimeve, veprave të mira, dhurimeve dhe fitimin e zemrave që përpiqemi t'i bëjmë në Ramazan, me qëllim që në frymën tonë të fundit të zgjohemi në mëngjesin e një bajrami të përjetshëm.

**Allahu i Madhëruar na bëftë prej robërve fatlumë që arrijnë të dalin prej Ramazanit të Bekuar me diplomën e një Bajrami të vërtetë. Allahu na bëftë që ta jetojmë çdo ditë tonën me frymëzimin shpirtëror të Ramazanit. Po ashtu e bëftë botën e përjetshme një lumturi bajrami të përherëshme.**

**Amin!**



# Ishehtësia e itikafit

— Rabia Christine Brodbeck —

Dhjetë ditët e fundit, që janë kulmi i muajit të madhërueshëm të Ramazanit, përbëjnë edhe kohën e itikafit. Allahu i Madhëruar ua mundëson besimtarëve agjërues ta kurorëzojnë agjërimin, të plotësojnë pastrimin e tyre shpirtëror, të plotësojnë përgjërimet për kërkimin e faljes e të mëshirës nga Allahu (xh.sh.) dhe të përfundojnë hatmen e Kuranit. Është koha kur besimtari arrin kulmin e lutjeve ndaj Zotit të botëve dhe Arafatin shpirtëror. Veçanërisht, transmetohet se Kurani Fisnik ka zbritur në dhjetë ditët e fundit të muajit të Ramazanit. Nata e Kadrit, në të cilën ka zbritur Kurani, është më e mirë se njëmijë muaj. Për këtë arsye, thesari i itikafit, që kurorëzohet me namazin e natës dhe natën e Kadrit, është i pashoq nga aspekti i mundësisë për lartësimin shpirtëror.

Mbi të gjitha, në dhjetë ditët e fundit të itikafit, i cili është kulmi i muajit të Ramazanit, falet namaz nate. Namazet që i Dërguari i Allahut, (a.s.), i ka falur përgjatë natës, janë quajtur namaz nate. Namazi i natës përfaqëson “makamu’l-mahmud”, që është pozita e Pejgamberit (a.s.). Esenca e namazit të natës është e njëjtë me esencën e fesë islame. Namazi i natës simbolizon ditën e tubimit në Kiamet. Esenca e namazit të natës, mbart bërthamën e halvetit. Namazi i natës dhe halveti, do të thotë të heqësh dorë nga të ngrënët e nga gjumi dhe të pish nga lumi i urtësisë së Nurit të Zotit (xh.sh.). Namazi i natës është gjendja e halvetit, në të cilën bëhen pëshpërimat e dashurisë reciproke në mënyrën më të sigurtë dhe në të cilën realizohet një takim shumë i fshehtë e privat. Zemra e robit ringjallet në vendin ku takohet me Atë që e ka më afër se veten e tij. Namazi i natës është kuvendim me Zotin e botëve në errësirën e natës. Namazi i natës është frymëmarrje për pjesën tjetër të jetës. Namazi i natës është vetëdijësimi i njeriut për përhershmërinë e shpirtit. Namazi i natës është fitimi

i fuqisë së përhershme të shpirtit të njeriut. Namazi i natës është perceptim i të fshehtëve hyjnore të el-Hajju’l-Kajjunit. Namazi i natës gjithmonë e mban gjallë njeriun. Namazi i natës është vetëdijësim i ringjallur. Netët në të cilat nuk kemi falur namaz nate, janë humbja jonë më e madhe. Është humbur thesari i nënshtrimit ndaj Zotit (xh.sh.). Është humbur thesari i sexhdes, kijamit, Fatihasë dhe Esmau’l-husnas. Është humbur morali më i lartë, morali i Muhamedit (a.s.). Është humbur thesari i teuhidit. Është humbur lidhja me ehlibejtin e Mustafait (a.s.) dhe sahabët e Tij. Me një thënie tjetër, nëse duam të përjetojmë dashurinë Muhamedane, duhet të falim namaz nate.

Qëllimi i muajit të Ramazanit është përjetimi i fesë. Domethënë, reflektimi i fesë në jetën e përditshme. Dhjetë ditët e fundit të Ramazanit janë përjetimi i esencës së Islamit. Esenca e fesë islame është përjetimi i fesë së teuhidit. Halveti synon që t’i përkasim Atij. Përse agjërojmë? Për ta përsosur namazin dhe për të përjetuar miraxhin. Përse hyjmë në halvet? Për t’u kthyer në miraxhin dhe shtëpinë e përhershme të zemrës e të shpirtit. Për të përjetuar eksperiencën e Ahiretit.

Itikafi nuk është vetëm simboli i mbarimit të Ramazanit, por edhe i dorëzimit të plotë të vetes te Allahu i Madhëruar. Hyrja në halvet nuk është vetëm zgjerim e thellim i dimensionit shpirtëror të identitetit të njeriut dhe përpjekje për pastrim shpirtëror. Po ashtu, nuk është vetëm edukim nefs, pastrim shpirtëror e fizik dhe as vetëm arritje e qetësisë shpirtërore për mendjen dhe zemrën. Urtësia e tërheqjes nga kjo botë është zhytja në oqeanin e mëshirës së Allahut të Madhëruar, domethënë, synimi dhe esenca e halvetit është bashkimi i njeriut me Zotin (xh.sh.), i cili është i Dashuri i vërtetë i tij.

Allahu i Lartësuar i ka thënë Musait, alejhi’s-



selam: **“Ata që dëshirojnë të më afrohen Mua, nuk mund të gjejnë ndonjë rrugë më të mirë se halvetin.”** Rruga që shkon te Allahu Teala, është rruga e sakrificës. Rruga që shkon te Allahu Teala, është rruga e halvetit. Për këtë arsye, çdo gjë duhet ta sakrifikojmë për dashurinë e Allahut të Lartësuar. Nëse njeriu e sakrifikon veten për Zotin e botëve, si kundërvlerë për këtë fiton jetën e përhershme. Njeriu duhet t’ia nënshtrojë vullnetin e tij të pjeshëm, vullnetit absolut të Allahut (xh.sh.). Në këtë mënyrë, bashkohet synimi përfundimtar i jetës me synimin përfundimtar të halvetit dhe bëhen një pjesë e vullnetit të Atij.

E fshehta e muajit të Ramazanit është arritja e eksperiencës së heshtjes së gjuhës së zemrës. Ky është një agjërim i vërtetë, me anë të të cilit njeriu largohet nga çdo gjë përveç Allahut Teala dhe qëndron bashkë me Zotin e botëve, i Cili është i Dashuri i tij. Në agjërim jemi në halvet. Në halvet ka heshtje dhe qetësi. Ibnu’l-Arabiu i përkufizon kështu tre aspektet zinxhir të heshtjes: “Varfëria është heshtje e vullnetit, injoranca është heshtje e mendjes. Ndërsa adhurimi është heshtje e ekzistencës.” Rrumiu thotë: “Mbylle derën e fjalës dhe hap dritaren e zemrës! Hëna do të të puthë ty nga dritarja.” Agjërimi na bën të heshtim. Agjërimi na fton të dëgjojmë dhe të bëjmë mukabele. Agjërimi na është dhuruar për t’i shtuar ndjesitë tona shpirtërore, për t’u bërë më të hapur ndaj ajeteve kuranore dhe për t’u bërë një pjesë e shpalljes. Vetëm një zemër e pastër mund të zhytet në nurin e ajeteve, duke hyrë në oqeanin e mëshirës hyjnore dhe mund të ndjejë shijen e kuptimeve të thella. Buzët e goja, veshët e sytë dhe të gjitha gjymtyrët e trupit, duhet të jenë të gatshme për të marrë jetë nga ajetet, për të kuptuar urtësinë e tyre dhe për të arritur udhëzimin hyjnor. Allahu i Madhëruar në Kuranin Fisnik thotë: **“Le të gëzohen ata që shmangen nga adhurimi i idhujve e kthehen nga Allahu! Pra, jepu lajme të gëzueshme robërve të Mi, të cilët, pasi i dëgjojnë fjalët (që u thuhet), ndjekin atë që është më e mira prej tyre. Këta janë ata që Allahu i ka udhëzuar në rrugë të drejtë; këta janë të mençurit.”** (Zumer, 17-18.)

Vetmia është metoda më efikase për të arritur përsosmërinë shpirtërore. Në këtë mënyrë, njeriu arrin kulmin e halvetit dhe devotshmërisë. Para se të arrijmë urtësinë, duhet të hyjmë në halvet dhe para se të fitojmë jetën e përhershme, duhet të sakrifikojmë. Para se të arrijmë të njohim Zotin dhe dashurinë, duhet ta pastrojmë zemrën nga shirku. Vetëm pasi të pastrohet mirë pasqyra e zemrës, del në pah mëshira. Vetëm kur të përvetësojmë cilësinë më të vlefshme të modestisë, shfaqet mëshira. Vetëm kur të jemi të kënaqur nga Allahu Teala në çdo gjendje, del në pah urtësia dhe njohja e Zotit.

Nuk ka dashuri pa halvet. Feriduddin Attari thotë: “Ai që kërkon dashurinë dhe miqësinë e Allahut pa përjetuar zuhdin dhe halvetin (asketizmin), ka një dashuri fallso në kuazën e tij. Kush ndjek rrugën e halvetit (asketizmit) me sinqeritet, çdo gjë e bën është për hir të kënaqësisë hyjnore.” Halveti është shpëtim nga nefsi dhe nxjerrje nga zemra e të gjitha dëshirave, pasioneve dhe synimeve të kësaj bote. Halvet do të thotë të mos lidhesh me këtë botë, të mos qëndrosh në burgun e trupit dhe të mos ndjesh vuajtje tjetër përveç vuajtjes që jep ndarja nga Zoti. Halvet do të thotë të mos kesh frikë dhe të mos brengosesh. Halvet do të thotë që të mos kesh asnjë shqetësim tjetër përveç shqetësimit për të arrirë te Ai, të mos i drejtohesh asgjëje përveç Atij, të mos lidhesh me askënd përveç Atij dhe të mos kesh nevojë për askënd përveç Atij. Halvet do të thotë të bëhesh njeri i vërtetë. Halvet do të thotë ta sakrifikosh çdo dashuri që nuk është për Allahun, të dëshirosh skamjen dhe të duash varfërinë, të njohësh nevojën e përhershme dhe lidhjen me Allahun Teala, t’i shesësh veten Zotit (xh.sh.), të të digjet zemra nga zjarri i mallit dhe përgjërimit, të digjesh nga mallëngjimi, të të kaplojë malli i kërkimit të Zotit dhe të stolisesh me shpresën më të lartë. Halvet do të thotë të mbledhësh frytet e perceptimit, të marrësh frymën e Rrahmanit dhe të mos ndjesh aspak interes për personalitetin fallso që është mbuluar me nefsin. Halvet do të thotë të zhytesh në detin e Muhamedit (a.s.). Halvet do të thotë të ndjesh frikë nga madhështia dhe bukuria e Allahut Teala, të derdhësh lot gëzimi në audiencën e Er-Rrahmani’rr-Rrahimit, të arrish lumturinë dhe të përjetosh kënaqësinë shpirtërore që kërkohet me insistim në namaz. Halvet do të thotë të festosh arritjen në sarajin e Rrahmanit, i cili thotë se “është më afër nesh se damarët e qafës”.

Në fakt, halveti i vërtetë është të vetmuarit e njeriut me të Dashurin e tij në çdo kohë dhe në çdo vend. Besimtari i vërtetë gjithmonë është me ihram, gjithmonë është në halvet dhe gjithmonë është në sexhde. Në jetën tonë, gjithmonë duhet të përpiqemi t’ia kthejmë shpinën kësaj bote, të hamë pak, të flemë pak dhe të flasim pak. Asnjëherë nuk duhet ta prishim agjërimin e zemrës.

### ÇFARË E PRISH AGJËRIMIN E ZEMRËS?

Dr. Haluk Nurbaki thotë: “Zemra e një njeriu që është larg të varfrit, larg jetimit dhe larg nevojtarit, nuk funksionon, nuk punon dhe është e prishur. Atij njeriu, që ka para në xhep, ka ushqim në shtëpi, dhe nuk ndjen ndonjë shqetësim nga brenda e nuk mendon të gjejë ndonjë të uritur apo të varfër për ta ushqyer, i është prishur agjërimi i zemrës. Nëse ai ha e pi pa ndërje keqardhje për ta, atëherë të mos pretendojë agjërimin.”



# Ramazani nga gjuha e Profetit



— Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan —

Profeti Muhamed (a.s.), mëshirë për botët, na e ka sqaruar muajin e ramazanit me të gjitha dimensionet që ka. Këtë muaj e kishte bërë shprehi ta quante edhe “muaji i myslimanëve”. Literatura e hadithit është e mbushur përplot me shumë thënie që rrëfohen prej profetit Muhamed dhe me raportimet e ndryshme të tyre. Do të qe e pamundur të mund t’i radhisim dhe t’i trajtojmë të gjithë ato hadithe brenda një artikulli. Për këtë arsye edhe ne, zgjodhëm një ligjëratë profetike (hutbe) në të cilën profeti Muhamed (a.s.) e ka sqaruar më gjerësisht muajin e Ramazanit. Ligjëratat profetike në fjalë është shkëputur nga një ndër veprat më eminente të literaturës së hadithit, më saktësisht nga vepra Sahih e dijetarit të hadithit Muhamed b. Ishak Ibn Huzejme (311 H / 923).

Në kapitullin në lidhje me vlerat fetare dhe shpirtërore të muajit të Ramazanit, që gjendet në veprën e Ibn Huzejmes, pasi jepet zinxhiri i raportuesve që shkon pas deri tek Selman Farisiu thuhet: “I dërguari i Allahut, Muhamedi (a.s.), mbajti një ligjëratë në ditën e fundit të muajit Shaban në të cilën tha:

“O myslimanë!

“Mbi ju ka rënë hija e një muaji madhështor dhe të bekuar. Ky është muaji në të cilin gjendet edhe nata e Kadrit, natë që është më e mirë se një mijë muaj së bashku.

Ky është muaji në të cilin Allahu u obligoi të agjëroni ditën dhe u begatoi me faljen e namazit (të teravisë) mbrëmjeve.

Kush punon ndonjë vepër të mirë në këtë muaj, fiton po aq sevape sa fiton personi që kryen një

detyre fetare të detyruar (farz) në një kohë tjetër përjashta këtij muaji. Ai që përbush një farz në këtë muaj fiton sevapin e kryerjes së shtatëdhjetë farzeve në muajt e tjerë.

Ky është muaji i durimit, shpërblimi për të cilin është xheneti.

Ky muaj është muaji i bamirësisë, ndihmës dhe barazisë.

Ky është muaji në të cilin besimtarit i shtohet begatia hyjnore materiale.

Kush i shtron iftare një personi që ka agjëruar, ky veprim bëhet shkas që t’i falen mëkatet që ka vepruar dhe të shpëtojë nga zjarri i xhehenemit. Ai me këtë rast do të fitojë po aq sevape sa fiton ai që ka agjëruar, por pa marrë nga sevapet e këtij të fundit.”

Të pranishmit e pyetën:

- “Jo të gjithë ne i kemi mundësitë financiare që të mund të ushqejmë për iftar ata që kanë agjëruar...”.

Këtyre profeti Muhamed (a.s.) iu përgjigj duke u thënë se:

“Allahu (xh.sh.), këtë sevap ia dhuron edhe atij personi që e gostit një person që ka agjëruar qoftë edhe me një hurmë apo disa gllënjka ujë apo qumësht “dhe vazhdoi ligjëratën me këto fjalë:

“Bëjini sa më shpesh katër gjëra në muajin e ramazanit. Me dy prej tyre fitoni kënaqësinë e Allahut, ndërsa prej dy të tjerave nuk mund të rri- ni larg edhe po të doni. Dy gjërat me të cilat do të fitoni kënaqësinë e Allahut (xh.sh.) janë të dëshmoni për njësinë e Allahut duke thënë shpesh

**La ilahe illallah dhe të kërkoni sa më shpesh nga Zoti juaj që tua falë mëkatet. Sa i takon dy gjërave të tjera nga të cilat nuk mund të qëndroni larg ato janë të kërkoni nga Zoti xhenetin dhe t'i luteni që t'u shpëtojë nga xhehenemi."**

Hytbja e profetit Muhamed, sikurse shihet, është shumë e qartë dhe e prerë, por gjithsesi ne jemi të mendimit se ka vlerë të ndalemi në disa pika të saja që na tërheqin vëmendjen.

### **ARDHMËRIA E VËRTETË**

Muhamedi (a.s.), e ka prezantuar në këtë ligjëratë muajin e ramazanit nga aspekti i rezultateve pozitive që u dhuron ai besimtarëve si në jetën personale, ashtu edhe në atë të botës së përtejme, sepse çdo mysliman pret diçka të re nga muaji i ramazanit që ai ka mbërritur. Këto aspirata të tijat sa kanë lidhje me jetën e kësaj bote, po aq, madje edhe më shumë, kanë lidhje me jetën në botën e përtejme, sepse e ardhmja e vërtetë për besimtarin është bota e përjetshme.

Nga ana tjetër, është një e vërtetë e njohur fakti që përmirësimi një e nga një i njerëzve shpie në një përmirësim të caktuar të shoqërisë, sepse bashkësitë njerëzore formohen nga individët. Kur ndahen me të tjerët momentet e gëzimit dhe hareshë, kanë ndikim edhe më të madh, prandaj edhe hareja që të fal muaji i ramazanit, do ta rrethojë shoqërinë në atë masë që ajo ndahet me tjerët.

Profeti Muhamed (a.s.) na e ka bërë të qartë se nuk është domosdoshmëri që të kemi të ardhura financiare në mënyrë që të fitojmë sevape nga kryerja e bamirësive në muajin e ramazanit. Me këtë deklaratë të Tijën që ne e cituam në ligjëratën e mësipërme, ai sikur dëshironte të na mësonte se **"Allahu nuk ka nevojë për pasuri të mëdha që të shpërndajë mëshirën e Tij të cilën njeriu mund ta fitojë edhe duke kryer një akt të thjeshtë bamirësie".** Edhe t'i japësh personit që ka agjëruar për të çelur iftarin një glënjë ujë apo qumësht mjafton që ne të përfitojmë nga kjo mëshirë hyjnore. Sa është i rëndësishëm akti bamirës që kryhet, po aq i rëndësishëm është edhe qëllimi me të cilin ai kryhet. Prandaj, askënd nuk duhet ta kaplojë pesimizmi po qe se mendon se të ardhurat materiale që ka nuk do t'i mundësojnë të kryejë akte bamirësie. Në qoftë se ne do të tregojmë kujdesin e duhur në përmbushjen e dy akteve që na këshilloi profeti Muhamed (a.s.) që të kryejmë gjatë muajit të Ramazanit, të cilat qenë shprehja e dëshmisë dhe lutja që të na falen mëkatet, kuptojmë sesa e lehtë është për një besimtar të sinqertë që vetëm duke përdorur gjuhën e tij në ziqër të mund të fitojë shumë sevape.

Ndjesia e besimit në njësinë e Zotit dhe ndërjegjësimi rreth kësaj të vërtete duhet forcuar dhe

i duhen mundësuar të hedh rrënjë sa më thellë me anë të përsëritjeve të dëshmisë islame, sepse **"zemrat gjejnë qetësi vetëm kur e përmendin Allahun".**

### **HUMBJA E RËNDË**

Sqarimi profetik që "nata e Kadrit që është më e mirë se një mijë muaj", qoftë shpërblimi hyjnor (sevap) që fitohet kur kryhen vepra të mira dhe bëhen bamirësi në këtë muaj, shpërblim që është shumëfish më i lartë kur të njëjtat akte dhe vepra kryhen në muajt e tjerë përjashta Ramazanit, tregojnë se muaji i ramazanit në vetvete është një "mundësi e jashtëzakonshme që na dhurohet". E vërteta që njihet nga të gjithë është se, momentet e jashtëzakonshme sjellin me vete edhe përgjegjësi të jashtëzakonshme. Teksa na tregon rreth vlerës së veprave të mira që bëhen në muajin e ramazanit, profeti ynë i dashur, na ka sqaruar njëkohësisht se personat që do të mbeten indiferentë ndaj këtyre mundësive do të përjetojnë humbje dhe dështime shumëfish më të rënda se ato që do të përjetonin në muajt e tjerë për shkak të indiferencës së tyre.

### **TË JESH POZITIV**

Meqë ra fjala në këtë temë, e konsiderojmë me vlerë të theksojmë se çdo veprim dhe akt që do të kryejmë duke u nisur nga respekti që ushqejmë për muajin e ramazanit, do të ketë pa tjetër një vlerë të veçantë. Shpresojmë që këto lloj aktesh bamirësie do të jenë plotësim për gabimet që njerëzit mund të kenë kryer gjatë jetës së tyre. Mirëpritja me nderim dhe respekt e çdo mjeti apo metode që mundëson të ndërjegjësojë shoqërinë rreth temave fetare dhe domosdoshmërisë së jetës fetare, janë të përshtatshme që të arrijnë të masivizojnë nismat e këtilla. Qoftë edhe një muaj gjatë gjithë vitit, çdo ndërmarrje që do të ndihmonte në përthithjen më të shpejtë të atmosferës fetare brenda shoqërisë, do të ishte shumë më e efektshme që të mirëpritet duke u parë si një ftesë e shpërndarë në emër të veprave të mira.

Ata që meritojnë me të vërtetë për të ndërjerë keqardhje, janë individët tek të cilët nuk dallohet as ndryshimi më i vogël për sa i përket ndjesive dhe mënyrës së vjetër të jetesës, të cilët nuk ndikohen qoftë edhe një grimë nga atmosfera e muajit të ramazanit. Më mjeranë se personat në fjalë janë ata individë që nuk e durojnë dot formën e re të bukur që sjell atmosfera e jetës së përditshme gjatë këtij muaji dhe përhapjen e saj në shtresat e ndryshme të shoqërisë, madje përpiqen të vënë në dukje shqetësimin që ndjejnë nga kjo atmosferë e përshpirtshme.



# VEPRAT QË TË SHPIEN NË XHENET

— Dr. Murat Kaja —

## TË MOS I BËSH SHIRK ALLAHUT

*“Ai që vdes pa i bërë shirk Allahut, hyn në xhenet. Ndërsa ai që vdes duke i bërë shirk Allahut, hyn në xhehenem.”* (Muslim, Iman, 151)

Transmetohet se Ata Ibn Ebi Rebah, (r.a.)u, ka thënë:

“Abdullah ibn Abbasi, (a.s.)a, më tha:

-A të të tregoj një grua që është prej banorëve të xhenetit?

Unë i thashë:

-Po, ma tregoj!

-E shikon këtë grua? Ja, kjo grua erdhi një ditë te i Dërguari i Allahut, (a.s.), dhe i tha:

-Unë jam e sëmurë me epilepsi dhe më hapen rrobat kur më zënë krizat. Lutjuni Allahut të më shërojë!

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha:

*-Nëse duron, do të hysh në xhenet. Por sidoqoftë, nëse ti do, unë mund t'i lutem Allahut të të japë shërim.*

Pastaj gruaja i tha:

-Unë e duroj sëmundjen, por lutu që të mos më hapen rrobat kur të më zënë krizat!

I Dërguari i Allahut, (a.s.), bëri dua për të. (Buhari, Merda 6; Muslim, Birr 54.)

## TË MOS NXEHESH

*“Mos u nxeh dhe do të hysh në xhenet!”* (Buhari, Edeb, 76.)

## NDERSHMËRIA

*“Ndershmëria në fjalë dhe në punë, të drejton drejt hajrit dhe mirësisë. Ndërsa mirësia të shpie në xhenet. Njeriu regjistrohet si i sinqertë te Allahu, duke thënë gjithmonë të vërtetën. Mashtrimi të zvarrit drejt devijimit. Ndërsa devijimi të shpie në xhehenem. Kur njeriu e përvetëson mashtrimin, te Allahu shkruhet si mashtrues.”* (Buhari, Edeb 69)

## PESË BAZAT

*“Kini frikë nga Allahu! Falni pesë kohët e namazit! Agjëroni muajin e Ramazanit! Jepni zekatin e pasurisë tuaj! Bindjuni prijësve tuaj! (Në këtë mënyrë) do të hyni në xhenetin e Zotit tuaj.”* (Tirmidhi, Xhuma 80)

*“Më janë treguar popujt (e mëparshëm). Kam parë një peygamber që kishte pranë një grup të vogël prej tre deri në pesë vetash. Kam parë një peygamber tjetër, pranë të cilit gjendeshin një deri në dy veta. Kam parë një peygamber, që nuk kishte pranë asnjë. Në ato momente, më doli përpara një kallaballëk i madh. Pandeha se ishte umeti im. Mua më thanë: ‘Ky është umeti i Musait. Ti shiko në horizont!’ Pashë, ishte një siluetë (shumë) e madhe. Më thanë:*

*‘Ja, ky është umeti yt. Ndërmjet tyre ka shtatëdh-*

jetë mijë vetë, që do të hyjnë në xhenet pa llogari dhe pa u ndëshkuar. Ata janë njerëzit që nuk bëjnë magji, që nuk urdhërojnë për magji, që nuk i besojnë fatit të keq dhe që i besojnë Zotit.” (Muslim, Iman 374)

### ZEMRA E BUTË

“Ka disa prej njerëzve që do të hyjnë në xhenet, zemrat e tyre janë të buta (dhe i mbështeten Allahut).” (Muslim, Xhenet, 27.)

Rebia Ibni Ka’b el-Eslemi, (r.a.), ka thënë:

“E kaloja natën bashkë me të Dërguarin e Allahut, (a.s.). Ujin e abdesit dhe nevojat e tjera ia plotësoja unë. Si shpërblim për këtë, një herë më tha:

-Kërko (nga unë çfarë të duash)!”

Unë i thashë:

-Dua të jem me Ty në xhenet.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), më tha:

-A nuk dëshiron diçka tjetër?

Unë i thashë:

-Kjo është dëshira ime.

Pejgamberi, (a.s.), më tha:

“Atëherë më ndihmo për veten tënde duke falur shumë namaze dhe duke bërë shumë sexhde!” (Muslim, Salat, 226.)

### SHKUARJA NË XHAMI

“Për atë që shkon në xhami në mëngjes apo në mbrëmje, për çdo rrugë Allahu përgatit për të një gosti në xhenet.” (Buhari, Ezan 37; Muslim, Mesaxhid 285.)

“Atë që pret një pemë mbi rrugë, e cila shqetëson myslimanët, e kam parë duke notuar në mirësitë e xhenetit.” (Muslim, Birr 129.)

“Një burrë pa një pemë mbi rrugë dhe tha: ‘Beto hem në Allahun se do ta heq nga këtu, në mënyrë që të mos shqetësojë myslimanët.’ E hoqi atë dhe për këtë arsye u fut në xhenet.” (Muslim, Birr 128.)

“Një burrë po ecte në rrugë dhe pa një degë ferre. E largoi atë nga rruga. Për këtë arsye, Allahu u kënaq nga ai dhe e fali.” (Buhari, Ezan 32)

“Ka dyzet sevape, më i larti prej të cilëve është t’i japësh dikujt amanet një dhi me qumësht për ta mjelë. Kush bën ndonjërrën prej këtyre dyzet mirësive, duke shpresuar se vapin dhe duke u besuar premtimeve për to, Allahu e fut në xhenet.” (Buhari, Hibe 35)

### TË DOBËTIT, MENDJEMËDHENJTË

“A t’ju tregoj se kush janë prej banorëve të xhenetit? Janë ata njerëz që nuk u jep vlerë askush, për shkak se janë të dobët dhe se shihen si të tillë nga

njerëzit, por nëse ata betohen se do të bëhet kështu, Allahu ua plotëson atë që thonë.

A t’ju tregoj se kush janë prej banorëve të xhehenimit? Janë ata njerëz me zemër të ngurtë, të ashpër dhe mendjemëdhenj, që ecin duke u mburrur.” (Buhari, Ejman 9)

### JETIMI

I Dërguari i Allahut, (a.s.), nxori gishtin tregues dhe gishtin gjatë, i hapi pak dhe tha:

“Unë dhe ai që përkujdeset për jetimin, do të jemi kështu në xhenet.” (Buhari, Talak 25, Edeb 24.)

“Nëse dikush merr një jetim, që gjendet ndërmjet myslimanëve dhe e çon në shtëpinë e tij për ta ushqyer, përdërisa të mos bëjë ndonjë mëkat të pafalshëm, Allahu Teala e fut atë në xhenet.” (Tirmidhi, Birr 14.)

### TRI VAJZA

“Kush përkujdeset dhe rrit tre fëmijë vajza, i edukon mirë ato, i marton dhe e vazhdon mirësinë e tij ndaj tyre, ai është prej banorëve të xhenetit.” (Ebu Davud, Edeb 121)

“Gruaja që vdes, duke qenë bashkëshorti i kënaqur prej saj, është prej banoreve të xhenetit.” (Tirmidhi, Rada 10.)

“Prindërit bëhen shkak, për të hyrë në xhenet nga dera kryesore.” (Tirmidhi, Birr 3)

“Nëse një njeri shkon për të pyetur një të sëmurë për gjendjen e tij apo shkon për të vizituar dikë për hir të Allahut, një engjëll i thotë kështu:

“Lum ti! Ke bërë një udhëtim të mirë. Vetes i ke përgatitur një vend strehimi në xhenet!” (Tirmidhi, Birr 64)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Kur një mysliman shkon për të vizituar një vëlla të sëmurë mysliman, ai është afër një hurfe të xhenetit derisa të kthehet.”

E pyetën:

-O i Dërguari i Allahut! Çfarë është hurfeja e xhenetit?

I Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

“Është një frut i xhenetit.” (Muslim, Birr 40-42)

### VIZITA E TË SËMURIT

“Nëse një mysliman shkon në mëngjes dhe viziton një vëlla mysliman të sëmurë, shtatëdhjetë mijë engjëj i kërkojnë Zotit mëshirë për të deri në mbrëmje. Nëse e viziton në mbrëmje, shtatëdhjetë mijë engjëj kërkojnë falje për të deri në mëngjes. Dhe për atë njeri ka fruta të mbledhura në xhenet.” (Tirmidhi, Xhenaiz 2. Veçanërisht shih Ebu Davud, Xhenaiz 3; Ibn Maxhe, Xhenaiz 2.)

## DASHURIA E NDËRSJELLTË

“Betohem në Allahun, në dorën e të cilit është shpirti im se nuk do të hyni në xhenet, përderisa të mos besoni. Ju nuk do të besoni, përderisa të mos doni njëri-tjetrin. A t’ju tregoj diçka që, nëse e bëni, do ta doni njëri-tjetrin? Përhapni selamin ndërmjet jush!” (Muslim, Iman, 93-94.)

Sevbani, (r.a.)u, ka thënë:

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Kush më jep fjalën se nuk do të kërkojë gjë nga njerëzit, unë i garantoj xhenetin.”

I thashë:

-Unë ta jap fjalën.

Transmetuesi thotë se Sevbani nuk kërkonte gjë prej askujt. (Ebu Davud, Zekat 27)

## XHENETI

E pyetën të Dërguarin e Allahut, (a.s.):

-Cila është ajo gjë që i shpie më shumë njerëzit në xhenet?

I Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

“Respekti ndaj Allahut dhe morali i lartë.”

## XHEHENEMI

Ndërsa kur e pyetën:

-Cila është ajo gjë që i shpie më shumë njerëzit në xhehenem,- i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

“Goja dhe organi gjenital.” (Tirmidhi, Birr 62)

## TRI CILËSI

“Unë i jam garant se atij që e lë debatin, edhe pse është në të drejtë, do t’i jepet një shtëpi në qoshe të xhenetit. Unë i jam garant se atij që nuk gënjen qoftë edhe me shaka, do t’i jepet një shtëpi në mes të xhenetit. Unë i jam garant se atij që është i dashur, do t’i jepet një shtëpi në vendin më të lartë të xhenetit.” (Ebu Davud, Edeb 7)

## TRE GRUPE

“Banorët e xhenetit janë tre grupe:

Kryetari i shtetit, që është i drejtë dhe i suksesshëm.

Ai që është i mëshirshëm dhe zemërbutë kundrejt të afërmeve dhe myslimanëve.

Ai që largohet nga fitimi haram dhe nuk kërkon gjë prej askujt, edhe pse familja e tij është e madhe.” (Muslim, Xhenet 63.)

“Nëse dikush dëshiron të shpëtojë nga xhehenemi dhe të hyjë në xhenet, duhet të vdesë duke i besuar Allahut dhe Ditës së Gjykimit. Gjërat që kërkon t’i bëhen atij, edhe ai duhet t’ua bëjë të tjerëve...” (Muslim, Imare, 46)

“O njerëz! Përhapeni selamin, ushqeni të tjerët dhe vazhdojeni lidhjen e ndihmën me të afërmit tuaj. Falni namaz kur flenë njerëzit, në mënyrë që të hyni në xhenet me paqë.” (Tirmidhi, Kijamet 42)

## SUREJA IHLAS

Një burrë tha:

-Unë e dua suren “kul huvallahu ehad”.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha:

“Dashuria ndaj saj, do të të fusë në xhenet.” (Buhari, Ezan 106)

“Nëse dikush prej jush merr abdest bukur duke e plotësuar atë dhe pastaj thotë: Esh’hedu en la ilahe illallahu vahdehu la sherike leh ve esh’hedu enne Muhammeden abduhu ve rasuluh, atij i hapen tetë dyert e xhenetit. Ai mund të hyjë nga cila derë të dëshirojë.” (Muslim, Taharet 17)

“Kush shkon në xhami në mëngjes e mbrëmje, për çdo rrugë Allahu i përgatit atij një gosti në xhenet.” (Buhari, Ezan 37)

“Nëse një mysliman fal çdo ditë dymbëdhjetë rekate nafile për hir të Allahut përveç farzeve, Allahu Teala i bën një shtëpi në xhenet” ose “atij i bëhet një shtëpi në xhenet.” (Muslim, Musafirin 103)

## PESË ÇËSHTJE

Një burrë i tha të Dërguarit të Allahut, (a.s.):

-Më thuaj një punë që do të më fusë në xhenet!

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha:

“Adhuroje Allahun dhe mos i bëj shirk asgjë. Fale namazin, jepe zekatin dhe kujdesu për të afërmit!” (Buhari, Zekat 1, Edeb 10)

## FSHATARI ARAB

Një fshatar arab erdhi te i Dërguari i Allahut, (a.s.) dhe i tha:

-O i Dërguari i Allahut! Më trego një vepër me të cilën mund të hyj në xhenet .

I Dërguari i Allahut (s.a.s.), i tha:

“Adhuroje Allahun pa i bërë shirk asgjë! Fali namazet farz! Jepe zekatin që është farz dhe agjëro Ramadanin!”

Beduini i tha:

-Betohem në Allahun, në dorën e të cilit është jeta ime, se këtyre që më the nuk do t’u shtoj asgjë.

Kur fshatari u largua, Pejgamberi alejhis-selam, tha:

“Kushdo që kënaqet duke parë një banor të xhenetit, le të shikojë këtë burrë!” (Buhari, Zekat 1)

“Umreja është kefaret për mëkatet që bëhen deri në umren tjetër. Ndërsa, shpërblimi i haxhit të pranuar, është vetëm xheneti.” (Buhari, Umre 1; Muslim, Haxh 437.)

“Kush thotë: “Subhanallahi ve bihamdihî (Unë e lartësoj Allahun nga cilësitë që nuk i kanë hije pozitës së Tij si Zot dhe e falënderoj Atë), për të mbillet në xhenet një pemë hurme.” (Tirmidhi, Davat 60.)

Ebu Musa, (r.a.)u, ka thënë:

“I Dërguari i Allahut, (a.s.), më ka thënë:

-A të të tregoj për njërin nga thesaret e xhenetit?  
Unë i thashë:

-Po, o i Dërguari i Allahut. Më trego!

Ai (s.a.s.), më tha:

“La havle ve la kuvete illa billah” (Nuk ka vullnet dhe as fuqi përveç se me Allahun ). (Buhari, Megazi 38)

### **GJUHA DHE TURPI**

“Kush më jep fjalën se do ta mbrojë gjuhën dhe nderin, unë i premtoj xhenetin.” (Buhari, Rikak 23)

“Kush dëshiron të largohet nga xhehenemi dhe të futet në xhenet, le ta presë vdekjen duke i besuar Allahut dhe Ahiretit. Po ashtu, le të sillet ndaj të tjerëve siç dëshiron të sillen të tjerët ndaj tij.” (Muslim, Imare 46.)

Një ditë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), u tha atyre që kishte pranë:

-Kush prej jush është agjërueshëm sot?

Ebu Bekri, (r.a.)u, tha:

-Unë jam agjërueshëm, o i Dërguari i Allahut.

Pejgamberi, alejhis-selam, tha:

-Kush ka marrë pjesë sot në një namaz xhena-zeje?

Ebu Bekri, (r.a.)u, tha:

-Unë, o i Dërguari i Allahut.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i pyeti:

-Kush ka ushqyer sot ndonjë jetim?

Ebu Bekri, (r.a.)u, tha:

-Unë, o i Dërguari i Allahut.

Krenaria e Gjithësisë, (a.s.), i pyeti:

-A ka ndonjë prej jush që ka vizituar ndonjë të sëmurë?

Përsëri Ebu Bekri, (r.a.)u, tha:

-Unë, o i Dërguari i Allahut.

Pastaj i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

“Kush i bën në të njëjtën kohë këto vepra të mira, patjetër do të hyjë në xhenet.” (Muslim, Fedailu’s-Sahabe, 12.)

“Besimtari nuk ngopet me asnjë mirësi derisa të hyjë në xhenet.” (Tirmidhi, Ilm 19.)

### **MËSIMI I DIJES**

“Kush merr rrugën për të mësuar dije, Allahu Te-ala ia lehtëson atij rrugën për në xhenet. Engjëjt për shkak se i pëlqejnë, i mbulojnë ata me krahët e tyre. Krijesat që janë në qiej dhe në tokë, madje edhe peshqit në ujë, i përgjërohen Allahut për t’i falur dijetarët. Epërsia e një dijetari kundrejt dikujt që merret vetëm me ibadet, është si epërsia e hënës katërbëdhjetëshe ndaj yjeve të tjerë. Dijetarët janë trashëgimtarët e pejgamberëve. Pejgamberët nuk kanë lënë flori e argjend si trashëgimi, por dije. Ja pra, ai që e trashëgon këtë dije, ka fituar një kështetë shumë të madh.” (Ebu Davud, Ilm 1; Tirmidhi, Ilm 19.)

### **SEXHDJA**

Sevbanit, (r.a.)u, i kishin kërkuar t’u tregonte një vepër që e shpie njeriun në xhenet dhe këtë kërkesë ia kishin shprehur tri herë. Pastaj Sevbanit, (r.a.)u, transmetoi këtë hadith:

“Mundohu të bësh shumë sexhde, sepse Allahu të ngre një gradë dhe të fshin një gabim si shpërbim për sexhden që ke bërë.” (Muslim, Salat 225)

### **ATA QË DUAN DHE QË NUK DUAN TË HYJNË NË XHENET**

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Umeti im do të hyjë në xhenet, përveç atyre që nuk duan.”

Sahabët e pyetën:

-O i Dërguari i Allahut! Kush nuk do të hyjë në xhenet?

Pejgamberi, (a.s.), tha:

“Ata që më binden mua, do të hyjnë në xhenet, ndërsa ata që më kundërshtojnë, do të thotë se nuk e duan xhenetin.” (Buhari, I’tisam 2.)

### **SHEHADETI**

“Kush thotë si fjalë të fundit “La ilahe illallah (Nuk ka zot tjetër përveç Allahut), do të hyjë në xhenet.” (Ebu Davud, Xhenaiz 20)



# Shehadet do të thotë Aksion

— Zubejir Jetik —

Shehadeti është një aksion individual, i cili sjell përgjegjësi që përfshijnë të gjithë jetën. Secili prej nesh, “si një individ” beson se “nuk ka zot tjetër përveç Allahut të Madhëruar” dhe dëshminë tonë e shprehim me “një theks individual”. Përsëri dëshmojmë si një individ edhe të vërtetën se i Nderuari ynë, alejhis-salatu ves-selam, Muhamedi, i cili kish-te emër të bukur dhe vetë ishte i bukur, është “rob dhe i Dërguar” i Allahut të Madhëruar.

Pas kësaj dëshmie individuale, në axhendën tonë hyn “besimi në Allahun” dhe “pranimi i të Dërguarit të Tij”. Ne besojmë me këtë dëshmi individuale. Pastaj ndërtojmë veten dhe jetën tonë mbi këtë bazë besimi. Pas kësaj faze, bashkë me Allahun e Lartësuar, i Cili është dëshmitar për secilin dhe për çdo gjë, edhe i Dërguari i Tij i Nderuar, (a.s.), do të jetë dëshmitar për ne.

Nëse ngjarja studiohet në kontekstin e përgjithshëm, vihet re se në fillim të këtij procesi zhvillimi ka një “individ” i cili vepron dhe zgjedh si një “person”. Ndërsa para dëshmisë së tij nuk ka person në aspektin e procesit.

Individi nuk e fillon punën duke thënë se “unë kam besuar kështu e ashtu sipas filanit”. Zgjedhjen e bën vetë drejtpërsëdrejti, i vetëm dhe vetvetiu. Kështu që përcakton Qenien që do të adhurojë, e zgjedh atë dhe dëshmon për këtë zgjedhje që ka bërë.

Edhe nëse në rrjedhën e ngjarjes është dikush që e këshillon, në të vërtetë nuk ka ndonjë që i prin apo që i tregon rrugën. Ai e zgjedh vetë atë, e përcakton dhe këtë e shpreh me një lloj dëshmie si një dëshmitar. Pastaj çdokush që mund të ketë zgjedhur, bëhet prijës për të dhe fillon t’i tregojë rrugën.

“Aksionisti” apo më drejt, përcaktuesi i procesit nuk është ai që këshillon, por ai që përvetëson, i cili përfaqëson, atë gjë që i sugjerohet, -ose përkundër të gjithave- refuzon. Zgjedhjen nuk e bën sugjeruesi, por ai që pranon sugjerimin si pozitiv ose që e refuzon atë. Pra, “individ”.

Çështja është kështu: Këtu nuk zgjedh prijësi pasuesit e tij, por pasuesit zgjedhin prijësin e tyre. Ajo që mund të bëjë prijësi është vetëm një propozim i hapur për pranimin dhe refuzimin. Vetëm kaq.

Për këtë arsye, individi nuk mund të fajësojë askënd për zgjedhjen që ka bërë dhe përgjegjësinë e zgjedhjes nuk mund t’ia hedhë askujt. Në rast të kundërt, ai lidhet me personin që ka zgjedhur duke menduar se është konsekuent në zgjedhjen që edhe ai ka bërë. Për shkak të kësaj lidhjeje ndjen respekt ndaj “tij”. Ndërsa nga ana tjetër fillon të besojë, të sillet dhe të jetojë sipas këshillave dhe kënaqësisë së atij që ka zgjedhur.

Në Ditën e Gjykimit, në atë ditë të madhe, kur njerëzit do të merren në llogari, disa do të mundohen të justifikohen duke thënë: “Ne kemi pasuar prijësit tanë...” Për këtë arsye, ata të cilët kanë bërë një zgjedhje të pavlefshme dhe të gabuar do të hidhen në zjarrin e xhehenemit bashkë me prijësat që kanë zgjedhur.

Shprehja e dëshmisë së myslimanëve me “fjalën e shehadetit” në të njëjtën kohë është edhe një akt. Një akt që bëhet me Krijuesin. Zbatimi i dispozitave të aktit nga ana e myslimanit bën që edhe Allahu i Madhëruar të krijojë realitete sipas kërkesës së aktit.

Dëshmia bëhet duke theksuar dy pikat e shehadetit, i cili formalisht shprehet : Ekzistimi i Allahut të Lartësuar, e jo i zotave të tjerë dhe fakti se i Nderuari ynë, (a.s.), është i Dërguari i Tij...

Pranimi i të Nderuarit tonë, alejhis-salatu ves-selam, si “Lajmëtar”, automatikisht lind përfundimin se duhen pranuar edhe ato që sjell Lajmëtari, pra Lajmin. Ja në këtë pikë “Libri” hyn në axhendën tonë. “Libri” do të jetë mes nesh deri në Kiamet si një Dritë nga i cili mund të shikojmë, mësojmë dhe ndjekim mesazhin e të “Dërguarit” pasi ai të ndahet nga mesi ynë.

Tashmë ne jemi dëshmitarët e Librit. Kështu edhe Libri do të jetë dëshmitari ynë. Dëshmia e të Dër-



guarit për ne do të vazhdojë në kontekstin e librit. Me Librin... Sepse ai Libër është amaneti i vetëm që na është lënë nga i Dërguari. Libri është lënë në sigurinë tonë. Siguria jonë dhe siguria e besimit tonë arrihet me anë të librit.

Tashmë “prijësi”, domethënë imami, do të jetë Libri Fisnik.

Ky është një amanet i dyanshëm.

Në njërën anë ndodhet shtrirja e përcaktimit të shkaqeve të rezultateve. Shtrirja ku myslimani në kontekstin individual dhe masiv heton nga dhe pse burojnë “fatkeqësitë” me të cilat përballet... Domethënë një orientim që e drejton atë për t'u penduar, për të kërkuar falje dhe për të rregulluar veten...

Ndërsa në anën tjetër është “irshadi”, ndriçimi, përcaktimi i drejtimit dhe mësimi i dispozitave të dëshmisë... Kjo është shtrirja që ne mund ta quajmë harta e fetarisë së myslimanit.

“Irshad”, domethënë orientim në rrugën e drejtë, pjekuri, arritje e përsosmërisë, edukim i njeriut, realizim i veçorive, domosdoshmërive për të qenë njeri i vërtetë.

Për këtë arsye, rrugët e jetës pa probleme gjenden në atë Libër. Po ashtu edhe mënyrat e zgjidhjes së problemeve... Historitë në lidhje me kohët e shkua-ra, veçanërisht, hedhin dritë mbi kontekstin e dytë, ndërsa për kontekstin e parë mbartin të dhënat paralajmëruese.

Për këtë arsye, myslimani që ka lidhje amaneti me “Librin Fisnik”, nën dëshminë e Allahut të Madhëruar, të Dërguarit dhe të Librit, e ka për detyrë t'u dëshmojë popujve të tjerë. Pra, ai ka një përgjegjësi specifike të tillë.

Ky pozicion apo obligim nuk është thjesht një problem që i përket një aksh personi nga umeti, por është çështja dominuese e çdo myslimani në kontekstin individual. Për këtë, myslimani nuk ka të drejtë apo arsye që të thotë: “A nuk ka njeri?” Sepse ai është vetë.

Të jesh dëshmitar e bën të domosdoshme këtë. Pra, të gjendesh në shoqërinë për të cilën do të dëshmosh, t'i kryesh si një “dëshmitar” aksionet në lidhje me parimet që do të dëshmosh dhe t'ia dalësh t'i realizosh ato.

Sikundër hapjes së derës së thirrjes së të shtypurve “A ka njeri?”, gjëja që duhet të bëjë myslimani në nuancën e dëshmisë është që të thotë: “Po, urdhëro, unë jam këtu!..”.

Të jesh shpëtimtar dhe jo të presësh shpëtimtarin...

Kur ta praktikojmë në jetë parimin, “Ai që vret një njeri është sikur të ketë vvarë të gjithë njerëzit dhe ai që shpëton një njeri është sikur të ketë shpëtuar të gjithë njerëzit”, me të vërtetë do ta kuptojmë se vetë ne jemi shpëtimtari, se mbi të gjitha kemi këtë detyrë dhe do të shpëtojmë së kërkuari e së prituri për shpëtimtarin.

Shpëtimi i myslimanëve do të realizohet vetëm me këtë mënyrë.

Myslmani nuk pret, por është një njeri që e përjeton dëshminë si një dëshmitar.

Dëshmia në fillim është një aksion “individual”. Kur të shtohen dhe shumohen aksionet individuale, popullarizohet edhe dëshmia.

Myslmanët nuk duhet të presin dikë për t'u prirë njerëzve, por duhet të nxjerrin prijësa nga mesi i tyre që t'u prijnë ngjarjeve me aksionet e tyre.

“Domethënë se urdhëri: “Unë jam i pari i myslimanëve!” mendoj se është i mjaftueshëm që të kuptojmë nevojën dhe obligimin e këtij qëndrimi. Çdo mysliman është i detyruar që të jetë i pari dhe të sillet si i tillë.





# Modeli

## MË I BUKUR NJERËZOR

— Ahmet Zijlan —

Njeriu është krijuar për të qenë halife dhe dëshmues i Allahut mbi tokë, për të mbajtur në këmbë të vërtetën dhe për të mbajtur mbi supe amanetin. Mirëpo, për t'i mbartur në kuptimin e vërtetë të fjalës të gjitha këto cilësi, ai ka nevojë për një proces maturimi që zgjat gjithë jetës dhe për një njeri model, i cili i mbart të gjitha këto cilësi.

Përparimi i njeriut në rrugën e përsosmërisë, nuk është i mundur vetëm me njohjen e të vërtetave. Të vërtetat që nuk gjejnë jetë në sjelljet njerëzore, jetojnë si teori vetëm nëpër libra dhe mendje. Në krye të njerëzve që i vënë në jetë të vërtetat dhe parimet, vijnë profetët. Ata janë zgjedhur prej Allahut dhe janë ngarkuar me detyrën e zbatimit dhe mësimit të mënyrës së jetesës së vërtetë njerëzore. Dhe i fundit prej profetëve është Muhamedi (a.s.).

Muhamedi (a.s.), i cili u dërgua për të edukuar të gjithë njerëzimin dhe për të plotësuar moralin dhe bukurinë, u përgatit për këtë detyrë prej Allahut Teala. Profeti (a.s.), ka thënë: *“Mua më edukoi Allahu dhe më dha një edukatë të bukur.”* (Keshfu’l hafâ 1/170.) Ndërsa i Lartmadhëruari na e ka prezantuar në këtë mënyrë të dashur e Vet: ***“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.”*** (Ahzab, 21)

Profeti (a.s.), ishte në majat më të larta të moralit dhe jeta e tij zhvillohej në bazë të Kuranit Kerim. Prandaj, ai është edhe shembulli më i bukur për çdo fushë të jetës. Ai është modeli më ideal si mësues, tregtar, komandant, kryefamiljar, kryetar shteti, gjykatës etj. Duke e përmbushur me sukses

detyrën e tij si një profet lehtësues, përgëzues, paralajmërues dhe zbatues, me fjalët dhe veprat e tij u bë udhëzuesi më ideal për njerëzimin.

Ja disa tablo nga jeta e tij shembullore në lidhje me moralin e tij të përsosur:

Prej parisë së sahabëve, Enes bin Malik tregon: “Unë i shërbeva Resulullahut për dhjetë vjet rresht, që prej moshës tetëvjeçare, në Medinë dhe jashtë saj. Ashtu siç nuk më tha qoftë edhe njëherë, “of”, për një punë që e kam bërë ose nuk e kam bërë, nuk më ka thënë kurrë, “përse e bërë kështu, përse nuk e bërë ashtu”. Ai nuk më ka qortuar kurrë për asnjë gabim apo të metë që kam pasur”.

Sipas një transmetimi të Muslimit, Muauije bin Hakem, tregon: “Isha duke falur namazin pas Resulullahut (a.s.). Gjatë namazit, dikush teshtiu. Kurse unë i thashë “Jerhamukellah /Allahu të mëshiroftë!” Të pranishmit m’i ngulën sytë. Përse m’i ngulën ashtu sytë? - thashë me vete. Por kur thashë edhe disa herë “jerhamukellah”, ata filluan të rrihnin edhe gjunjët me dorë. Kur ma bënë me shenjë “pusho”, unë e mbylla gojën. Pasi Resulullahu (a.s.), mbaroi namazin, më thirri. – Ju bëfshin kurban nëna me gjithë babain - unë nuk kam parë mësues më të mirë se ai, as më parë dhe as më pas. Ai as më qëlloi, as më dënoi dhe as më qortoi, por më tha vetëm këto fjalë: “Gjatë namazit nuk flitet asnjë fjalë e kësaj dynjaje, por bëhet vetëm dhikër, tekbir dhe lexohet Kuran”.

Sipas një transmetimi të Ebu Umames: “Një i ri erdhi tek Resulullahu (a.s.) dhe i kërkoi leje për të bërë zina<sup>1</sup>. Të pranishmit ngritën zërin duke i thënë të mos fliste. Kurse Resulullahu (a.s.), e pyeti të riun: ‘A do të dëshiroje që dikush të bënte zina me nënën, me motrën dhe me hallën tënde?’ Kur i riu tha: ‘Jo, kurrë nuk do të dëshiroja!’, atëherë Resulullahu (a.s.), tha: ‘Ashtu si ti, edhe njerëzit e tjerë nuk do të dëshironin që dikush të bënte zina me nënat, me motrat dhe me hallat e tyre. Pra, ato që nuk i dëshiron për veten, mos i dëshiro as për të tjerët. Ato që i dëshiron për vete, dëshiroji edhe për të tjerët.’ Më në fund, i riu u bind dhe u bë njeri i ndershëm.”

Transmetohet nga Xhabiri (r.a.), se: “Një beduin, erdhi tek Resulullahu (a.s.), dhe e pyeti: ‘Në xhenet, a do t’i endim vetë pëlhurat për veshje apo do t’i marrim të gatshme prej xhenetit dhe do t’i qepim?’ Sahabët filluan të qeshnin. Kurse beduini tha: ‘Kujt i qeshni? Të paditurit që pyet për të më-

suar atë që nuk di?’ Pas këtyre fjalëve, Resulullahu (a.s.), tha: ‘O beduin! Ti ke të drejtë të pyesësh. Veshjet e xhenetit do të qepen prej copave të gatshme të xhenetit’. Në këtë mënyrë, ai e shpëtoi edhe beduinin prej situatës së keqe.”

Profeti ynë (a.s.), i vlerësonte dhe i respektonte të gjithë. Kur i jepte dorën dikujt, asnjëherë nuk e tërhiqte dorën i pari. Kur dikush i drejtohej me fytyrë, Profeti (a.s.), nuk e kthente fytyrën e vet, derisa ta kthente ai. Ndërsa, kur ulej në mexhllis (kuvend), nuk i zgjaste këmbët përpara askujt.

Sipas një transmetimi të Buhariut dhe Muslimit, Enesi (r.a.), tregon: “Isha duke ecur me Resulullahun (a.s.). Profeti kishte veshur një rrobë të bërë me cohë jemeni dhe me jakë të ashpër. Erdhi një beduin dhe e tërhoqi fort Profetin (a.s.), prej rrobës. Vura re se kjo tërheqje e fortë la një shenjë në qafën e Resulullahut (a.s.). Mbi të gjitha, ky beduin i paditur dhe i paedukatë, tha: ‘O Muhamed! Jep urdhër të më japin diçka prej këtyre mallrave.’ Pas kësaj, Resulullahu (a.s.), qeshi dhe urdhëroi t’i jepej diçka prej asaj pasurie.”

Ai arriti të qytetëronte edhe njerëzit më të paedukatë, më të paditur, më të vrazhdë dhe më kokëfortë, të cilët ishin larg qytetërimit. Ai ua shndërroi mendjet dhe zemrat. Ky është revolucioni i vërtetë. Edhe sikur të ishin dërguar me mijëra filozofë në shkretëtirë, ata nuk do të kishin realizuar as edhe një të mjtën e reformës që realizoi Profeti (a.s.). Transformimi më i madh dhe më i rëndësishëm është ai i njeriut. Me durim, dituri dhe mëshirë edhe beduinët më të prapambetur u bënë njerëzit më të qytetëruar.

Sipas transmetimeve, në burimet e sigurtat të hadithit, një beduin hyri në xhami, ndërkohë që Resulullahu (a.s.), qëndronte ulur. Beduini fali dy rekat namaz dhe bëri këtë dua: “O Allah! Më mëshiro mua dhe Muhamedin. E mos mëshiro askënd tjetër!” Pas kësaj, Profeti (a.s.), i tha: “O vëlla arab! E ngushtove atë që është e gjerë.” Më vonë, po i njëjti beduin urinoi në një cep të mesxhidit. Kur njerëzit iu vërsulën, Profeti ynë (a.s.), i ndaloi, duke u thënë: “Lëreni të mbarojë punë!” Pasi beduini mbaroi punë, Profeti (a.s.), urdhëroi e tha: “Ju nuk jeni dërguar si vështirësues, por si lehtësues. Mësoni, lehtësoni dhe mos vështirësoni. Tani hidhni ujë mbi vendin e urinuar.” Beduini e kuptoi gabimin e vet. Kurse Resulullahu (a.s.), i tha: “Në mesxhid nuk urinohet. Mesxhidi është ndërtuar për të përkujtuar dhe adhuruar Allahun”.

1. Zina: Marrëdhënie seksuale jashtëmartesore.



Profeti (a.s.), si një edukues i pashoq, i edukonte njerëzit në mënyra të ndryshme. Ja disa shembuj në lidhje me këtë çështje:

Një ditë, një beduin erdhi tek Resulullahu (a.s.), për t'i kërkuar ndihmë dhe i tha: “O Muhamed! Më jep diçka, se nuk ke për të më dhënë prej mallit tënd apo të babait tënd!”. Profeti ynë (a.s.), i dha diçka dhe tha: “A të ndihmova? A u kënaqe?”. Kur beduini tha: “Jo nuk më ndihmove”, - myslimanët u zemëruan dhe iu vërsulën. Ndërsa Resulullahu (a.s.), u bëri me shenjë të tërhiqeshin. Pastaj u ngrit dhe shkoi në shtëpinë e tij. Më vonë i dërgoi haber bedunit dhe e thirri në shtëpi, ku i dha diçka tjetër. “Po tani a u kënaqe?”- i tha Resulullahu (a.s.). Beduini, përsëri tha “Jo”. Profeti i shtoi edhe diçka tjetër dhe e pyeti përsëri: “A u kënaqe?”. Këtë herë, beduini tha se ishte kënaqur. Resulullahu (a.s.), tha: “Ti erdhe këtu, kërrove diçka dhe ne të dhamë. Pastaj fole mbrapsht dhe myslimanët u zemëruan prej kësaj. Nëse do, tani shko e thuaju myslimanëve se je i kënaqur me mua, që zemërimi i tyre të shuhet”. “Mirë!”- tha beduini dhe u kthye përsëri në mbrëmje (ose në mëngjes). Resulullahu (a.s.), u drejtua nga sahabët dhe tha: “Ky shoku juaj ishte i uritur, prandaj kërkoj diçka prej nesh. Kurse ne i dhamë. Tani ai thotë se është i kënaqur prej nesh” dhe duke u kthyer nga beduini e pyeti: “A s’është kështu?”. Beduini ia ktheu: “Po, kështu është. Allahu të shpërbleftë me të mira ty, familjen tënde dhe të gjithë të afërmit e tu”. Pas këtyre fjalëve, Profeti (a.s.), urdhëroi e tha: “Sjellja ime me sjelljen tuaj i ngjan gjendjes së një njeriu që kishte një deve, e cila ishte e pabindur ndaj tij dhe ikte. Njerëzit i shkonin pas për ta kapur. Mirëpo kjo bënte që deveja të largohej edhe më shumë. I zoti i devesë u thotë atyre që ishin duke e ndjekur: ‘Mos e ndiqni devenë. Ma lini mua, sepse unë sillem më butë ndaj saj.’ I zoti i devesë eci drejt saj, mblodhi pak bar dhe iu afrua. Deveja e pa barin, qëndroi në vend dhe u ul. I zoti ngarkoi ngarkesën dhe i hipi sipër. Pra, pikërisht si ky. Nëse nuk do t’ju

kisha ndaluar në fillim, kur ju iu vërsulët, mbase do ta kishit vrarë të shkretin dhe do të bëhej prej banorëve të xhehenemit. Kurse unë, bëra çfarë kisha mundësi për ta kënaqur”.

Edhe Profeti (a.s.), ishte njeri dhe ndoqi gjithmonë vijën njerëzore, duke mos dalë kurrë nga kufijtë e devotshmërisë. Ai nuk i lejoi kurrë ata që kërkonin ta nxirrnin nga këta kufij dhe ta bënin idhull. Ai jetoi me modesti si një individ i thjeshtë i shoqërisë. Nuk bëri dallime as për veten dhe as për të tjerët. Të gjithë i pa me syrin, se “janë njerëz”, si të pasurit e të varfrit, si robërit e pronarët, si ata që ishin të ndryshëm në racë dhe në gjuhë. Ai i jepte vlerë çdo gjëje të gjallë ose jo të gjallë dhe veçanërisht njeriut. Nëse nuk e shihte tri ditë rresht ndonjë prej sahabëve, pyeste, interesohej dhe, nëse nuk jetonte më, bënte dua për të, nëse jetonte ose ishte i sëmurë, i shkonte në shtëpi për vizitë.

Pjekuria dhe stolisja e njerëzve me cilësi të bukura dhe mbizotërimi i këtyre bukurive në botën tonë, është i mundur vetëm me marrjen shembull të profetëve në përgjithësi, profetit tonë në veçanti dhe robërve të dashur të Allahut.

Sot, kur vlerat materiale dalin në plan të parë dhe vlerat morale hidhen pas shpine, për të sjellë qetësi dhe paqe në botën tonë nuk kemi zgjidhje tjetër përveçse të motivojmë njerëzit të bëhen të mirë dhe të ndjekim rrugën e të mirëve. Rezultatet e mira arrihen nën udhëheqjen e njerëzve të mirë. Kurse udhëzuesi më i mirë është Profeti ynë (a.s.). Ai është shembulli më i mirë për çdo pjesë të jetës dhe për çdo shtresë. Çobani më i mirë, tregtari më i drejtë, mësuesi më ideal, komandanti më trim, miku më besnik, babai më zemërbutë, bashkëshorti më i dashur, lideri më i mëshirshëm dhe gjykatësi më i paanshëm. Këto cilësi që i përmendëm, ai i ka fituar duke i jetuar dhe zbatuar. Të gjithë duhet të organizohen sipas këtij modeli dhe duke parë veten në pasqyrë, të rregullojnë sjelljet dhe jetën e tyre.



# Kërko zotëruesin e Xhenetit

— M. Sami Ramazanollu —

***“Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit. Ata luftojnë në rrugën e Allahut, vrasin dhe vriten. (Ky është) premtimi i Tij i vërtetë në Teurat, Ungjill dhe Kuran. Kush e mban premtimin më shumë se Allahu? Andaj, gëzojuni kësaj shitjeje! Kjo është fitorja madhështore.”*** (Teube, 111)

Shkaku i zbritjes së këtij ajeti:

Natën e Akabes, kur shtatëdhjetë vetë prej ensarëve të nderuar, i dhanë besën të Dërguarit të Allahut, (a.s.), Abdullah bin Revaha, (r.a.), tha:

-O i Dërguari i Allahut! Vendos kushtin që dëshiron për Zotin dhe për veten tënde! I Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

*-Për Zotin, kushti është, që ta adhuroni Atë dhe të mos i bëni shirk. Ndërsa për veten time, kushti është, që të më mbronin mua ashtu siç mbronin veten dhe pasurinë tuaj.*

Ensarët e nderuar, thanë:

-Nëse e bëjmë këtë, cili është shpërblimi ynë? I Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

*-Xheneti.*

Ensarët e nderuar, (r.a.), thanë:

-Ne ta dhamë besën. Kështu që nuk e prishim dhe nuk shfaqim mangësi në të.

Xhafer Sadik, kuddise sirruh, thotë:

“O biri i Ademit! Njihe vlerën e vetes sate, ashtu siç ka treguar Allahu. Allahu nuk është i kënaqur

që çmimi i vetes tënde të jetë diçka më poshtë se xheneti!

Asnjëherë nuk duhet ta harrojmë se blerësi është Allahu, artikulli në shitje është robi dhe çmimi është xheneti.

Duhet të dimë se xheneti është për atë që e flijon veten duke e kërkuar atë. Ky xhihad, quhet xhihadu’l-asgar.

Ai që e flijon zemrën dhe shpirtin duke kërkuar Allahun, e arrin Zotëruesin e xhenetit. Sakrifica për ta fituar Atë, quhet xhihadu’l-ekber.

Rruga e pastrimit të zemrës dhe ndryshimi i moralit nga i keq në të mirë, janë më të vështirë se lufta me armiqtë e hapur.”

Fahreddin Razi, në Tefsiru’l-Kebir, transmeton:

Shejtani debatoi me Allahun në lidhje me këtë ajet fisnik dhe tha:

-Sipas shariatit, nëse klienti blen nga shitësi një mall me mangësi, duhet t’ia kthejë atë. Ti ke blerë jetën dhe pasurinë e tyre. Jeta dhe pasuria e tyre është mall me mangësi. M’i lër mua ata me gjendjen që kanë!

Allahu Teala iu përgjigj:

-Ti nuk e di shariatin Tim, nuk e kupton drejtësinë Time dhe nuk e vlerëson mirësinë Time.

Në këtë mënyrë, djalli ra përtokë dhe u refuzua si i poshtëruar.

# POROSITË E PROFETIT

- SALALLAHU ALEJHI VE SELEM -

— Ferit Piku —

Zoti ynë na urdhëron në Kuranin famëlartë, duke thënë: **Çfarëdo që t'ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t'ju ndalojë, hiqni dorë prej saj. Frikësojuni Allahut, sepse Allahu, dënon vërtet ashpër.** (Hashr, 7)

Figura e Profetit (a.s.), është madhështore. Sado të flasin gjuhët, sado të shkruajnë librat, ai mbetet madhështor, sepse të tillë e krijoi Zoti i gjithësisë.

Ai nuk ishte vetëm profet, nuk ishte vetëm njeri i madh, por ishte një vëlla i mirë, një shok i mirë, një edukator i jashtëzakonshëm.

Ishte nga ata njerëz, që kur e shikonte një të keqe, i digjej zemra dhe me urtësinë më të madhe e korrigjonte atë. Ishte nga ata njerëz, që kur pyetej për diçka të mirë, me zellin më të madh që mund të ketë ndonjë mësues, ia shpjegonte nxënësit më së miri atë që pyeste. Fjalët e tij ishin të pakta, por kishin kuptim të thellë. Kur dora e

tij e butë vihej mbi supin e njërit prej shokëve të tij, fjalët që dilnin nga goja e Profetit (a.s.), futeshin thellë nëpër zemra e nuk harroheshin asnjëherë. E merrte shokun e tij veçmas dhe i fliste dy – tri fjalë. Ishin fjalë me peshë, sepse dilnin nga zemra e atij personi, që e donte çdo njeri. Këto porosi të vogla i mjaftonin shokut të tij për gjithë jetën. Me dy – tri fjalë ai e mësonte fenë e Zotit. Me dy – tri fjalë ruante besën dhe amanetin e Zotit.

Kam zgjedhur vetëm një nga porositë e Profetit (a.s.), një fjalë që Muhamedi (a.s.), ia tha njërit prej shokëve të tij, që donte shumë. Realisht ai i donte të gjithë shumë, por këtë e donte, sepse ishte nxënës i zgjuar dhe pyeste vazhdimisht. Ai ishte Muadh Ibn Xhebel (r.a.).

Muadh Ibn Xhebel (r.a.), e donte xhenetin dhe e kishte frikë xhehenemin. Ai tregon: “Kur e pashë një ditë Profetin (a.s.), vetëm, larg të tjerëve iu afrova dhe i thashë:

-O Profet i Zotit! Kam një pyetje që s’më lë të fle natën dhe më ka shqetësuar shumë. Ma trego një punë që më fut në xhenet dhe më ruan nga zjarri! Vetëm kaq dua.

Profeti (a.s.), i cili shikonte besnikëri dhe sinqeritet tek Muadh iu përgjigj:

-O Muadh, ke pyetur për një gjë të madhe, por që me lejen e Zotit është e lehtë, për ata, që Zoti ua lehtëson. O Muadh, adhuroje Zotin dhe mos i bëj shok Atij! Fale namazin, jepe zekatin, agjëroje Ramazanin dhe bëje haxhin, nëse ke mundësi!”

Pastaj mësuesi e pyeti nxënësin e tij, sepse ishte nxënës besnik dhe i zellshëm:

-O Muadh, a ke dëshirë të t’i tregoj dyert e punëve të mira?

-Patjetër, o profet i Zotit – tha Muadh, - m’i trego.

Profeti (a.s.), vazhdoi:

-O Muadh! Agjërimi është mburojë, sadakaja i fik gjynahet si uji zjarrin. Fale namazin në mesin e natës.

Pastaj lexoi ajetin kuranor, ku Zoti thotë: **“Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne. Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ata (në jetën tjetër), si shpërblim për punët e mira që kanë bërë.”** (Sexhde: 16-17)

Pastaj Profeti (a.s.), vazhdoi përsëri:

-O Muadh, a do ta dish kokën, shtyllën dhe

kulmin e kësaj pune?

Muadh iu përgjigj:

-Patjetër, o Profet i Zotit.

Profeti (a.s.), tha:

-Koka është Islami, shtylla është namazi dhe kulmi është xihadi në rrugën e Zotit.

Pastaj vazhdoi:

-O Muadh, a do ta dish kryesoren e të gjitha këtyre që të kam thënë?

- Patjetër, o Profet i Zotit.

Atëherë profeti (a.s.), kapi gjuhën e tij me dorë dhe tha:

-Mbaje fort këtë, o Muadh!

-O Profet i Zotit! A do të na marrë Zoti në llogari edhe për fjalët që flasim?

-Të pastë nëna, o Muadh, po a ka gjë tjetër që i fut njerëzit në zjarr më shumë se gjuha e tyre?!<sup>1</sup>

Këto ishin fjalët e mësuesit, fjalët e Profetit (a.s.), fjalë të vogla, por që lanë ndikim të madh në zemrën e Muadhut, prandaj ai ia thoshte këto fjalë çdo njeriu që takonte.

Çfarë ishin këto fjalë? E thënë shkurt, shqetësimi i Muadhut (r.a.), ishte shqetësimi i sahabëve. Ata nuk ishin njerëz të fjalëve. Flisnin pak e punonin shumë. Pyesnin pak e zbatonin shumë. Ata nuk i zinte gjumi natën nga shqetësimi: “Do të hyjmë në xhenet apo në zjarr”. E kishin kuptuar situatën dhe ishin të sigurtë se e ardhmja e tyre ishte xheneti ose zjarri. Për këtë e pyeti edhe Muadh (r.a.), Profetin (a.s.), për punën që të çon në xhenet. Profeti (a.s.), nuk i tha thjesht: “Bëj punë të mira”, por i tha: “O Muadh, ti po pyet për një gjë të madhe.”

A të duket e lehtë të hysh në xhenet e të ruhesh prej zjarrit?! A nuk e di se Zoti i ka dërguar fetë për këtë çështje, profetët kanë ardhur për këtë çështje, librat kanë zbritur për këtë çështje. Zoti thotë në Kuranin famëlartë: **“Kush i largohet zjarrit dhe futet në xhenet, ai ka fituar.”** (Al’ Imran, 185.)

Nuk është e lehtë të hysh në xhenet. Vallahi, është aq e vështirë, saqë kur melekët e panë xhenetin se me çfarë vështirësish ishte rrethuar, thanë: “O Zot, askush nuk do të hyjë në xhenet”. Por Zoti tha: “Do të hyjnë ata që i përveshin krahët për këtë dhe Unë do tua lehtësoj”. Kush e do rrugën e mirë, sado e vështirë të jetë ajo,

1. Tirmidhiu, Ahmedi dhe Nesaiu. Tirmidhiu e vlerëson hadithin të pranuar, të vërtetë.

bëhet e lehtë me lejen e Allahut (xh.sh.), sepse e lehtëson Zoti i gjithësisë.

Kush e do rrugën e keqe, ajo është e lehtë dhe Zoti nuk ia vështirëson këtë, por në fund të gjithë do të kthehemi tek Allahu (xh.sh.), e do të japim llogari për atë që kemi punuar, e dijeni se Zoti nuk e do të keqen dhe nuk i bën padrejtësi askujt.

Profeti tha: “O Muadh! Adhuroje Zotin dhe mos i bëj shok Atij.” Zoti të ka krijuar, të ushqen, të furnizon, të ka dhënë jetë. Mos i bëj shok Zotit, se atëherë ke bërë padrejtësinë më të madhe që mund të bëhet. Pastaj Profeti (a.s.), tha: “O Muadh, fale namazin, agjëroje Ramazanin, jepe zekatin dhe bëje edhe haxhin, nëse ke mundësi.” Profeti (a.s.), nuk e la me kaq, por vazhdoi edhe më tej: “A do t’i dish rrugët e punëve të mira?” E tha këtë, sepse donte t’i tregonte nxënësit të tij se ka punë të mira që pak njerëz i bëjnë, por, nëse do që të hysh në xhenet, duhet t’i bësh.

## CILAT JANË KËTO PUNË?

### AGJËRIMI

Profeti (a.s.), tha: “Të agjërosh nafile (vullnetarisht), është mburojë.” Kur ushtari shkon në luftë, merr mburojën me vete. Po kë-shtu, kush agjëron nafile, pra jo vetëm në muajin e Ramazanit, por edhe jashtë tij, ai mbron veten nga fjalët dhe punët e pahijshme. Agjërimi e mbron robin nga zjarri i xhehenemit.

Profeti (a.s.), ka thënë: “Kush agjëron vetëm një ditë për hir të Allahut (xh.sh.), Ai, e largon atë njeri 70 vite nga zjarri i xhehenemit.”<sup>2</sup> Agjërimi është mburojë. Kush ka mundësi, le ta bëjë këtë punë, sepse Zoti do ta ruajë në këtë botë dhe në botën tjetër.

### SADAKAJA

Profeti (a.s.), tha: “Sadakaja i fik gjynahet si uji zjarrin”. Pse tha i fik dhe nuk tha i fshin. E tha kështu, sepse gjynahu është i nxehtë dhe duhet diçka për ta fikur atë. Kush ka mundësi, le të japë

sadaka me pasuri, me fjalë, me ndihmë, me kontribut fizik. Nëse nuk bën keq, dije se edhe kjo është pjesë e sadakasë. Sadakaja e fik zemërimin e Allahut (xh.sh.). Zoti na bëftë nga ata njerëz, tek zemra e të cilëve ka vend sadakaja, sepse kush ka vend në zemrën e tij për sadaka, inshallah do t’ia japë Zoti mundësinë të japë sadaka edhe me dorën e tij.

### NAMAZI I NATËS

Profeti (a.s.), tha: “Të falësh dy rekate namaz në mesin e natës.” Kjo të ruan në këtë jetë dhe në jetën tjetër, sepse është krenaria e besimtarit dhe pak besimtarë e bëjnë një gjë të tillë. Na bëftë Zoti nga ata njerëz, që u del gjumi dhe ngrihen e falin goftë edhe dy rekate namaz nate. Nëse nuk kanë

mundësi të marrin abdest e të falen, të

paktën të thonë njëherë me gjuhë

fjalët LA ILAHE IL ALLAH, MU-

HAMEDUN RESULULLAH, se

Zoti u thotë melekëve: “A e

shihni robin Tim? Po ngri-

het natën e po më kujton

Mua. A keni parë ndo-

njëherë njeri të tillë?”

Me të vërtetë është

dhunti e madhe, pra-

ndaj Zoti na ndihmoftë

ndaj egos sonë.

Pastaj, Profeti (a.s.), vazhdoi: “A do ta dish kokën e kësaj pune, shtyllën dhe kulmin e saj?”

Koka është Islami. Islami

është gjithçka. Kush ka Isla-

min, ka gjithçka, kush ka humbur

Islamin, ka humbur gjithçka. Islam do

të thotë dorëzim me zemër te Zoti i gjithësisë.

Flasim për dorëzim me dëshirë, se me imponim të

gjithë njerëzit dorëzohen tek Allahu (xh.sh.).

Shtylla e kësaj feje është Namazi. A ndërtohet çadra pa shtyllë? Po shtëpi pa kolona e pa mure, keni parë ndonjëherë? Po kështu, nuk ndërtohet feja e Zotit për robin që nuk fal namaz. E di që mund të gjenden 1000 justifikime për të mos e falur namazin, por çfarë t’i themi Zotit, që i di punët dhe hallet tona.

O vëllezër, ky problem është i sqaruar. Kush ka mëshirë për veten e tij, le të punojë. Kush nuk ka mëshirë, ai merr në qafë vetëm veten. Namazi është shtylla e kësaj feje. Kush rrëzon këtë shtyllë, ka rrëzuar fenë e Allahut (xh.sh.).

2. Buhariu dhe Muslimi.



Kulmi i fesë është Xihadi në Rrugën e Zotit. Xihad do të thotë të përpiqesh me gjithçka që ke, me fjalën tënde, me pasurinë tënde, me punën tënde, me penën tënde, me fjalën tënde, me trupin tënd. Të përpiqesh në rrugë të Zotit e t'ua duash njerëzve të mirën. Islami nuk është feja e atyre që duan rehatinë, feja e atyre që e jetojnë jetën si t'u vijë ose mundohen të jetojnë ndryshe nga të tjerët. Islami është feja e njerëzve që duan të derdhnin djersë, që duan të lodhen, është feja e xihadit vetëm për hir Zotit.

Xihadi nuk është vetëm luftë, por është shumë më tepër se kaq. Në fund vjen edhe lufta, me qëllim që të mos tolerohet padrejtësia dhe të ndalet ajo.

Pastaj, Profeti (a.s.), tha atë fjalë, që nuk e priste Muadhi (r.a.), as ne:

*“O Muadh, a do ta dish sekretin e gjithë këtyre punëve? Kape fort këtë (gjuhën).”*

Muadhi (r.a.), me çiltërsi e pyeti Profetin (a.s.):

*“O Profet, a për fjalët që themi do të na marrë Zoti në llogari?” Profeti (a.s.), ia ktheu: “Të pastë nëna ty, o Muadh. Po a nuk e di ti se ajo që i fut njerëzit më shumë në zjarr, është gjuha?!”*

Gjuha i fut njerëzit në zjarr. Kur njerëzit e analizojnë veten e tyre, thonë: “A për këtë gjuhë u futëm në zjarr? Asnjëherë nuk na paska shkuar nëpër mend kjo gjë.”

Prandaj profeti (a.s.), ka thënë: *“Kush më garanton për epshin dhe gjuhën e tij, unë i garantoj xhenetin.”*<sup>3</sup> Garantoni nderin dhe gjuhën tuaj, që Profeti (a.s.) t'ua garantojë, xhenetin.

Pse gjuha? Me gjuhë mohohet Zoti. Me gjuhë akuzohet, me gjuhë gënjehet, me gjuhë bëhen padrejtësi, me të bëhen të gjithë të zezat. Për gjuhën, sahabët kanë thënë: “Kjo (gjuha) është dashur të mbahet në burg më shumë se gjithçka tjetër.”

Zoti na bëftë nga ata njerëz, që u mjaftojnë dy a tri fjalë. Njerëzve të mirë nuk duhet t'u mbash

ligjërata. Njeriu i mirë e kupton dhe e pason të mirën. Ata njerëz i ka drejtuar Allahu (xh.sh.) dhe me të vërtetë janë të mençur. Kjo është gjithçka në këtë jetë.

Profeti (a.s.), e merr njëherë tjetër për dore Muadh (r.a.), ecën pak dhe i thotë: *“O Muadh, po të jap disa porosi, prandaj ki mendjen. O Muadh, kije frikë Zotin, thuaj të vërtetën, mbaje besën, dorëzoje amanetin, braktise tradhtinë, mëshiroje jetimin, ruaje komshiun, mbaje zemërimin, zbutë fjalën, jepen selamin, mos iu ndaj grupit, kuptoje Kuranin, duaje ahiretin, frikësoju llogarisë, mos iu mbështet shumë kësaj jete, se është e shkurtër; punën që të besohet, bëje sa më mirë. O Muadh, unë po të ndaloj për diçka, prandaj ki kujdes.*

*Mos e shaj myslimanin, mos e beso gënjeshtarin, mos e përgënjeshtro të sinqertin, mos e kundërshtoj prijësin e drejtë, mos bëj dëme mbi tokë. O Muadh, kujtoje Zotin në çdo pemë e në çdo gur. Sa herë të bësh një gjynah, pasojë gjynahun me pendim, qoftë kur je vetëm, qoftë edhe kur je me njerëzit e tjerë”.*

Zoti na bëftë nga ata njerëz, që pyesin pak e punojnë shumë. Zoti na bëftë nga ata, që e dëgjojnë fjalën e mirë dhe e pasojnë atë në formën më të mirë.

E lus Allahun (xh.sh.), të fusë në zemrat tona dashurinë për Profetin (a.s.), të na bëjë nxënës të mirë të këtij mësuesi.

E lus Allahun (xh.sh.), t'i falë gabimet tona, të mëdhatë e të voglat, ata që duken e ata që nuk duken.

E lus Zotin e gjithësisë t'i ruajë zemrat tona, gjuhët tona dhe gjymtyrët tona.

E lus Allahun (xh.sh.), të mos sillen ndaj nesh siç ne e meritojmë, por siç i takon madhësisë dhe mëshirës së Allahut (xh.sh.), Ai është falës i madh, Ai e pranon pendimin e robit të Tij.

Lus Zotin të na mëshirojë ne dhe prindërit tanë, ata që janë gjallë e ata që kanë vdekur, të gjithë myslimanët kudo që janë, të gjithë njerëzit që duan mëshirën e Allahut (xh.sh.).

Amin!..

3. Buhariu

# Bajame dhe hurma arabie



## FORMULA PERFEKTE PËR GJUMË TË QETË

Ekspertët rekomandojnë konsumin e rregullt të arrorëve të ndryshëm për të zbutur shqetësimet emocionale gjatë pandemisë por edhe për të përmirësuar humorin

Sipas tyre, njerëzit që konsumojnë arrorë rregullisht, por pa e tepruar janë 23 përqind më pak të rrezikuar nga depresioni.

Kjo i atribuohet amino acidit triptofan që prodhon serotoninën ose hormonin e lumturisë.

Bajamet, arrat dhe farat e pishës janë ndër arrorët më të mirë për t'i rezistuar plogështisë emocionale gjatë karantinës.

Kjo e fundit ka ndikuar gjerësisht në cilësinë e gjumit.

Kjo kurë funksionon ndryshe nga ato tradicionale që merren përpara orës së gjumit.

Ekspertët thonë se njerëzit duhet të hanë tetë arra dhe dy hurma Arabie në mëngjes.

Besojeni ose jo, ngrënia e mëngjesit luan një rol të çmuar për gjumin.

Nëse ju nuk hani mëngjes, trupi beson se po je-

ton në krizë ushqimore dhe prodhon hormonet e stresit.

Sa më gjatë të jeni të stresuar aq më e keqe do të jetë cilësia e gjumit.

Nëse ju hani mëngjes të shëndetshëm rregullisht, trupi kupton që ka ushqim mjaftueshëm dhe nuk ndihet i stresuar dhe nuk prek sistemin e gjumit dhe të energjisë.

Gjumi është i rëndësishëm edhe kundër mbipeshës. Mungesa e tij ju nxit të konsumoni më shumë ushqime që japin kënaqësi të menjëhershme por që janë të dëmshme për shëndetin.

Përveç gjumit, konsumi i tetë bajameve dhe dy hurmave të thata është një hap i duhur drejt rënies nga pesha dhe përshpejtimin të metabolizmit.

Bajamet dhe hurmat, sipas ekspertëve, e përshpejtojnë metabolizmin me të paktën 10 përqind.

Kësisoj, përfitimi nga kjo formulë është i dyfish-të.

Jo vetëm që do të jeni më pak të stresuar por edhe do të ndëmerrni hapa të shëndetshëm drejt peshës ideale dhe do të flini më mirë.

## Veza e Shkurtëzës DHE VLERAT E SAJ

Veza e shkurtëzës është e pasur me vitamina dhe minerale. Shkurtëza si shpend në Shqipëri njihet edhe me emrat cyrle mali ose qikëll.

Konsumi i rregullt i vezëve të saj ndihmon organizmin të shmangë



dhe luftojë disa sëmundje, sidomos ato të stomakut siç është ulçera.

Veza e shkurtzës forcon sistemin imunitar, promovon një kujtesë të mirë, rrit aktivitetin e trurit dhe stabilizon sistemin nervor.

Veza e shkurtzës është e dobishme kundër anemisë, sepse rrit nivelin e hemoglobinës në trup dhe largon toksinat apo metalet e rënda.

Kinezët e përdorin vezën e shkurtzës për të trajtuar tuberkulozin, azmën madje edhe diabetin. Nëse vuani nga mëlçia, veshkat apo gurët në tëmth, atëherë konsumoni vezën e shkurtzës.

Më poshtë do të gjeni disa prej të dhënave shumë interesante mbi vlerat e vezës së shkurtzës të listuara nga AgroWeb.org:

Këto vezë përmbajnë 13% proteina. Kjo është e rëndësishme, sepse organizmi ka nevojë për proteina për të mirëmbajtur muskujt dhe për të pasur energji.

Proteina që gjendet tek veza e shkurtzës është e një cilësie superiore. Por veza e shkurtzës nuk ka vetëm proteina.

Ajo është e pasur me vitaminë B1, e cila quhet ndryshe edhe tiaminë. Mungesa e tiaminës shkakton patologji nervore, rënie në peshë, luhatje humori dhe konfuzion. Tiamina është e dobishme dhe merret lehtësisht nga veza e shkurtzës.

Veza e shkurtzës ofron shumë hekur dhe kalium që janë të rëndësishme për njeriun. Mungesa e hekurit shkakton anemi.

Hekuri është thelbësor në ndërlidhjen me proteinat dhe transmetimin e oksigjenit në gjak.

Femrat përpara menopauzës dhe fëmijët janë më të predispozuar ndaj mungesës së hekurit, një fenomen që ka pikënisjen në aparatit gastrointestinal. Kur ky sistem nuk përthith dot hekur, atëherë nis anemia.

Veza e shkurtzës është e pasur me vitaminë A dhe B2. Vitamina A luan rol të rëndësishëm për zhvillimin e embrioneve, metabolizmin e kockave, shëndetin e lëkurës dhe qelizave, aktivitetin e antioksidantëve, transkriptimin e geneve, shikimin etj.

Kjo vezë është e pasur me fosfor dhe kalcium. Femrat dhe fëmijët janë ata që kanë nevojë për më shumë kalcium në dietën e tyre, sepse ky mineral është i nevojshëm për shëndetin e kockave, por edhe për qelizat dhe disa proçese të tyre.

Kalciumi është një nga mineralet që gjendet me tepriçë në shumë burime shtazore. Fosfori është gjithashtu i domosdoshëm për jetën e njeriut. Ai është përbërës i ADN-së dhe luan rol kryesor në formimin e membranës së qelizave.

Veza e shkurtzës përmban kolesterol të mirë dhe nivelet më të larta të kompleksit të vitaminës B. Ajo bën pjesë në kategorinë së ushqimeve që nuk shkakton inflamacion.

Shkurtza konsumon kryesisht fara, barishte dhe legume, ndaj veza e saj ka një shije të këndshme. Lëvozhga e vezës është e fortë dhe rrjedhimisht bën të pamundur hyrjen e bakteve.

Veza e “egër” e shkurtzës është thjesht fantastike, ndaj duhet ta shijoni jo vetëm për bukurinë dhe shijen por edhe për vlerat shëndetësore.



## "HUBBLE" FESTON 30 VJETORIN

Teleskopi hapësinor "Hubble" i NASA-s festoi këtë javë ditëlindjen e 30-të, ndërsa vazhdon pritja për pasardhësin e tij. Teleskopi hapësinor "James Webb" ishte menduar të nisej për në hapësirë në vitin 2018, por u shty për në vitin 2021. Dhe tani NASA ka ndaluar operacionet e testimit për shkak të pandemisë së koronavirusit.

Pas gati një dekade të plotë përgatitjesh, teleskopi "Hubble" u lëshua në orbitë me anijen hapësinore "Discovery" 30 vjet më parë, më 24 prill 1990.

NASA dëshironte një observator pamjet e të cilit nuk do të shtrembëroheshin nga atmosfera dhe, në disa raste, nga përthithja e dritës.

Yjet, për shembull, nuk duket se pulsojnë kur shihen nga hapësira. Teleskopi mori emrin e astronomit amerikan Edwin Hubble, i cili në vitet 1920 përcaktoi se universi po zgjerohet.

Por, ngazëllimi i madh u shndërrua në agoni pa fund, kur u mësua se pasqyra kryesore e teleskopit ishte fryrë gjatë prodhimit, duke rezultuar në shikimin e paqartë. Douglas Broome, ish-menaxheri i teleskopit hapësinor Hubble lajmëroi mediat në vitin 1992:

"Ekziston një zhvlerësim sferik domethënës në sistemin optik të teleskopit".

Tre vjet më vonë, ndërsa rrezikohej reputacioni dhe e gjithë e ardhmja e NASA-s, një ekip astronautësh arritën të rikthejnë vizionin e premtuar të Hubble-it duke montuar pjesë ndërrimi.

Astronautët kanë vizituar gjithsej pesë herë teleskopin Hubble, nga viti 1993 deri në vitin 2009, për të bërë përmirësime dhe riparime të observatorit, i cili ka përmasat e një autobuzi shkolle.

Në fillimet e tij, "Hubble" vërtetoi ekzistencën e super vrimave të zeza dhe zbuloi se ato janë të vendosura në qendër të shumicës së galaktikave.

Teleskopi ndihmoi gjithashtu në përcaktimin e

moshës së universit 13.8 miliardë vjeçar, duke përcaktuar shkallën aktuale të zgjerimit të universit, me një pasiguri prej vetëm tre përqind.

"U mahnitëm kur pamë për herë të parë këto imazhe. Dua të them se ka gjëra në astronomi për të cilat jeton, dhe ajo që ndjemë kur pamë për herë të parë këto foto të shfaqen në ekran ishte e tillë", tha studiuesi i hapësirës Jeff Hester në 1995.

NASA thotë se Hubble shikon thellë duke kapur nga galaktikat e largëta dritën, të cilës i është dashur më shumë se 13.4 miliardë vjet për të arritur tek ne.

Teleskopi "Hubble" ka bërë mbi 1.4 milion vëzhgime. Astronomët i kanë përdorur ato për të shkruar mbi 17 mijë punime shkencore.

Hubble udhëton me shpejtësi 17 mijë milje në orë dhe lëviz përgjatë një orbite 340 milje mbi sipërfaqen e Tokës. Teleskopi hapësinor përmbush një orbitë rreth Tokës çdo 95 minuta.

Pasardhësi i "Hubble", teleskopi hapësinor "James Webb", që fillimisht do të nisej në vitin 2018, do të shikojë nga një pikë e favorshme një milion milje larg. Pas shtyrjes disa herë, NASA pati vendosur lëshimin e tij për në vitin 2021. Muajin e kaluar, NASA njoftoi se kishte pezulluar operacionet e integritetit dhe testimit në teleskopin hapësinor, për shkak të pandemisë së koronavirusit.

"James Webb" do të jetë i specializuar në gjatësinë e valës infra të kuqe, duke e lejuar atë të futet në disa nga pjesët më të zbehta dhe më të largëta të universit. Kjo duhet të mundësojë që teleskopi, i cili mori emrin e administratorit të ndjerë të NASA-s që drejtoi programet "Mercury" dhe "Gemini", dhe të hidhte bazat për zbarkimet në hënë të misionit "Apollo" - të shikojë edhe më larg në kohë sesa "Hubble" dhe do të zbulojë galaktikat e formuara vetëm 200 milion vjet pas Big Bang-ut.



# WI-FI PO MERR PËRDITËSIMIN MË TË MADH NË 20 VITET E FUNDIT

Pas disa muajsh, do të ketë shumë më tepër Wi-Fi përreth nesh. Të paktën kështu pritet të ndodhë së shpejti, sepse Komisioni Federal i Komunikimit në SHBA votoi sot për të hapur një spektër të ri në brezin 6GHz për përdorim të palicencuar.

Rregullatori i njëjtë më herët lejonte ruterët tanë të transmetonin në brezat 2.4GHz dhe 5GHz.

Kjo do të thotë se ka tani më shumë valë ajrore të hapura – shumë më tepër – që ruterët mund të përdorin për të transmetuar sinjale të rrjetit Wi-Fi.

Pasi spektri i ri hapet zyrtarisht për biznes më

vonë gjatë këtij viti, kjo do të duhej të përkthehej në internet më të shpejtë dhe më të besueshëm nga gjenerata e re e pajisjeve.

Ky është shtesa më e madhe në brez, pasi FCC pastroi rrugën për Wi-Fi, gjë të cilën nuk e kishte bërë që nga 1989, kështu që kjo gjë është një risi e madhe.

Spektri i ri në thelb katërfishon sasinë e hapësirës në dispozicion për ruterat dhe pajisjet e tjera, kështu që do të thotë shumë më shumë bandwidth dhe ndërhyrje shumë më të vogël për çdo pajisje.

## MACBOOK ME NJË MUNDËSI TË RE PËR MBROJTJEN E KOHËZGJATJES SË BATERISË

Në mënyrë që bateria të ketë një kohëzgjatje më të madhe, MacBook është duke punuar në një mundësi të re, që e mbron atë që të mos dëmtohet.

Krijuesit macOS Catalina 10.15.5 janë kujdesur që ta krijojnë edhe sistemin për të ashtuquajturin “menaxhimin e shëndetit” të baterisë së laptopëve.

Bateritë me jone litiumi që përdoren ditëve të sotme në MacBook dhe në smartfonë, nuk i rezistojnë të gjitha kushteve. Kur bateria mbushet në tërësi, apo nxehet më shumë se që duhet, mund të ketë pasoja të mëdha.

Megjithëse nuk janë të dukshme, me kalimin e kohës ato shkaktajnë probleme serioze, ndërsa kur bateria fillon të dobësohet, është vonë për riparim.

Të punuarit me kablllo të kyçur gjatë gjithë kohës së punës, atëherë kjo ia rritë rrezikun për dëmtim të baterisë. Andaj, për të ruajtur baterinë, duhet ta aktivizoni sistemin Battery Health, që ndodhet në opsionin Battery të Settings.

Momentalisht, kjo mundësi është në dispozicion për vetëm disa përdorues, ndërsa do t’ju mundësohet të gjithëve kur të lansohet Catalina 10.15.5.





## *Souvenir Albania*




*tregton me shumicë dhe pakicë  
punime artizanale të cilësisë së lartë.*





## "LUX DEKOR"

Lux Dekor është firmë private e specializuar për prodhimin e kuzhinave si dhe orndive të ndryshme shtëpiake dhe të zyreve. Bën shitjen e materialit: iverëplaka, MDF, folje për vakumpress, dhe të aksesuarëve përcjellëse për mobiljeri. Bën prodhimin e balloreve – mvëshjen me ultrplast – laminat, si dhe plastifikimin vakumpres – ballonpress të balloreve me folje të pvc-se në dimensione të kerkuara nga klienti, gravirimin e fronteve me makinë CNC, kandimin – qitjen e shiritëve pvc dhe abs, prerjen e pllakave, të gjitha keto kryhen me makina të persosur kualitet dhe cilësi të lart.





**VILA DANTE**  
RESTORANT


 ADRESA: TUSHEMISHT, POGRADEÇ

**SHOPPING**  
HOUSE

  
ADRESA:  
RRUGA QEMAL DRAÇINI  
TEK SAHATI, SHKODËR



# ÇAPA<sup>®</sup> musluk



## REYHAN

Kosovë për herë të parë  
me 5 vjet garanci

N.T.SH. REYHAN  
Distributor për KOSOVË

Të gjitha llojet e baterive, rubinetave të CAPA mund  
t'i gjeni tek firma N.T.Sh. REYHAN - Prizren.  
Si dhe mund të gjeni edhe nëpër lokale të tjera  
në KOSOVË

**ELEGANCË, BUKURI, CILËSI  
DHE 5 VJET GARANCI  
ME ÇMIME TË VOLITSHME**



ISO 9001



**5** ★★★★★  
Yil Garanti

[www.capamusluk.com.tr](http://www.capamusluk.com.tr)

[www.reyhan-ran.com](http://www.reyhan-ran.com)

*Armatürde Dünyaya Uurulan Marka*

Rr:UCK, Pn Tel: + 381 29 225 555  
Prizren - KOSOVË Mob: + 377 44 115 238

Shitje me shumicë mund të kontaktoni  
përmes telefonave dhe web faqes.



Ju ofron:

Kushte bashkëkohore,  
ushqim cilësor dhe të kontrolluar,  
staf të kualifikuar.

Ju mirëpresim!



Lagja Perash, Bulevardi Mehmet Pashë Plaku,  
Pranë Xhamisë Perash, Shkodër

+355 67 47 39389

1 Staf arsimor cilësor

2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta

3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive

4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar

5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



**CIKLI FILLOR**  
(djem dhe vajza)

NGA KLASA E **1**-RË  
DERI NË KLASËN E **5**-TË

“Mos u frikësoni  
dhe mos u pikëlloni!  
Dhe gëzojuni Xhenetit  
që ju është premtuar.”

*(Fussilet, 41)*